C1-EU-NPA
CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

DOKUMENT POLITIKASH DHE QËNDRIMESH

"Vështrim ligjor dhe institucional për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në vendin tonë dhe pajtueshmëria e tyre me acquis"

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, "Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përmbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri", zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument politikash dhe qëndrimesh (policy/position paper) janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Përgatitën dokumentin:
Av. Erida Skëndaj, *Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit*
Dr. Jonida Rystemaj, *Eksperte Ligjore e jashtme e KShH-së*

Kontribuan për të dhënat statistikore:
Safete Qato, *Studente në Fakultetin e Drejtësisë*
Senada Aliu, *Studente në Fakultetin e Drejtësisë*

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati "Tekno Projekt" Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Mob: 0694075732
e-mail: office@ahc.org.al
web site: www.ahc.org.al

DOKUMENT POLITIKASH DHE QËNDRIMESH

"Vështrim ligjor dhe institucional për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në vendin tonë dhe pajtueshmëria e tyre me acquis"

Qershor 2022

PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtimeve

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit AKEP - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare BE - Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
GDPR	Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (General Data Protection Regulation)
GjEDNj	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
GjDBE	Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian
GJKKO	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
IP	Internet Protocol
KiE	Këshilli i Europës KE- Komisioni Evropian
KEDNj	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale KShH - Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
	Konventa 108 - Konventën për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale
LMDP	Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale PKIE - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste e Shqipërisë ODP-Oficeri i të Dhënave Personale
SH.B.A	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SMSI	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit VKM-Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbrojta e të dhënave personale është thelbësore në funksion të garantimit të së drejtës së privatësisë së njerëzve. Në kontekstin digjital, kjo mbrojtje është veçanërisht e rëndësishme pasi individët janë në mënyrë të ndjeshme më të ekspozuar se në dimensionin fizik, si konsumatorë apo përdorues, që përfitojnë produkte dhe shërbime. Gjithashtu, përdorimi i teknologjisë së informacionit apo inteligjencës artificiale në përpunimin e të dhënave në shkallë të gjerë dikton nevojën për përmirësimin e standardit të mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të krijohet një mjedis i sigurt për subjektet e të dhënave personale që në të njëjtën kohë nxit edhe qarkullimin e këtyre të dhënave si bazë për ekonominë e të dhënave.

Ky dokument analizon fillimisht, në vështrim politik, mangësitë e kuadrit ligjor vendas për mbrojtjen e të dhënave personale, nën dritën e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i vendit në BE. Kjo analizë pajtueshmërie me legjislacionin e BE-së merr fill edhe nga rrjedhjet masive të të dhënave gjatë vitit që lamë pas, të cilat dëshmuan vulnerabilitetin e subjekteve të të dhënave dhe përpunimin në një shkallë të gjerë të të dhënave personale dhe sensitive, pa masat e nevojshme të sigurisë.

Në vijimësi, ky dokument analizon qëndrimet lidhur me ndëshkueshmërinë administrative dhe penale të rrjedhjeve masive dhe të paprecedenta, të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë por edhe të huaj, si rezultat i këtyre rrjedhjeve (databazave).

1.1 Qasja politike krahasimore e legjislacionit të brendshëm me detyrimet që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE

Në BE ka një legjislacion të plotë dhe gjithëpërfshirës, primar dhe sekondar, që krijon bazën e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas sektorëve të veçantë. Ky legjislacion është plotësuar dhe interpretuar nga jurisprudenca e qëndrueshme e GjDBE-së. Ndaj sot, për shkak edhe të karakteristikave të saj e veçanërisht të zbatimit ekstraterritorial (përtej vendeve të BE-së), Rregullorja shërben si një standard universal për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mbrojtja e të dhënave personale në vendin tonë, përveçse është e drejtë kushtetuese, rregullohet edhe nga ligji i posaçëm "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Ky ligj përbën një bazë të mirë për të mbrojtur individët nga përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale, por i pamjaftueshëm për të përballuar sfidat që ka sjellë zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përpunimi në një masë të gjerë i të dhënave personale. Ligji në fuqi nuk është i përafruar me standardin e ri europian për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj lind nevoja për përafrim, jo vetëm në respektim të detyrimeve të marra përsipër në kuadër të procesit vazhdues të përafrimit, por për të zgjeruar dhe përforcuar edhe më tej të drejtat e subjekteve të të dhënave si dhe për të rritur përgjegjësitë për kontrolluesit. Gjithashtu, një tjetër arsye që dikton nevojën për përafrim lidhet me nevojën për t'iu përshtatur një standardi global në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale, veçanërisht lidhur me transferimin apo qarkullimin e të dhënave personale nga, dhe, drejt BE-së, si veprimtari thelbësore në funksion të jetëzimit të ekonomisë së të dhënave.

Përafrimi kërkon detyrimisht edhe miratimin e një instrumenti të posaçëm për të integruar në sistemin juridik edhe direktivën e Policisë, në mënyrë që të ketë një standard edhe për mbrojtjen e të dhënave në këtë sektor specifik dhe të përcaktohen qartë detyrat e autoriteteve publike.

Vlerësimi i legjislacionit tonë ka nxjerrë në pah si mangësi, faktin që subjektet e të dhënave nuk kanë kontroll të mjaftueshëm mbi të dhënat e tyre, pasi nuk ka detyrime të qarta për kontrolluesit/përpunuesit për të informuar subjektet e të dhënave në një gjuhë të qartë, të thjeshtë, në mënyrë konçize dhe transparente mbi kontrolluesin, identitetin ose kontaktet e tij, qëllimin e përpunimit të të dhënave, etj. Gjithashtu, subjektet e të dhënave nuk mund të përdorin të drejta si: e drejta për t'u harruar (apo për t'u fshirë nga motorët e kërkimit) apo e drejta për portabilitet të të dhënave personale. Në këtë kontekst, ligji shqiptar nuk garanton mjaftueshëm të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, si në aspektin material ashtu edhe atë procedural, siç do të parashtrohet përmbledhtas në vijim.

Nga ana tjetër ligji "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ngarkon një barrë të madhe mbi Komisionerin, duke i lënë detyrën për të kontrolluar përputhshmërinë e veprimtarisë së kontrolluesve/përpunuesve me kërkesat e ligjit. Praktikisht, kjo kompetencë është e pamundur për t'u realizuar për shkak të numrit të madh të kontrolluesve/përpunuesve në sektorin publik e privat si dhe mungesave të ndjeshme në burime njerëzore e teknike të zyrës së Komisionerit.

Në lidhje me pozitën e kontrolluesve është konstatuar se kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon një spektër të plotë dhe të qartë detyrimesh si për shembull detyrimi për të dokumentuar të gjitha proceset e përpunimit të të dhënave personale, detyrimi për të njoftuar rrjedhjen e të dhënave personale, si tek Komisioneri ashtu edhe tek subjektet në rast se këta mund të dëmtohen nga kjo rrjedhje, detyrimi për të hartuar politikat e privatësisë, etj.

Gjithashtu, njëherësh, vërehet se në ligj mungon detyrimi që kontrolluesi të përfshijë në projektimin teknik të shërbimeve, mbrojtjen e të dhënave përmes privatësisë "me projektim" dhe "mbrojtjes së paracaktuar" të privatësisë (privacy by design dhe privacy by default) në mënyrë që të ofrohet mbrojtja më e mirë për subjektet e të dhënave personale.

Reflektimi i këtyre ndryshimeve në kuadrin tonë ligjor do të sillte një përmirësim të ndjeshëm të të drejtave të subjekteve si dhe të rriste përgjegjësitë dhe detyrimet për kontrolluesit/përpunuesit. Këto ndryshime do të rrisnin vigjilencën e kontrolluesve ndaj proceseve të përpunimit të të dhënave personale. Në këtë mënyrë, ligji do të ndikojë pozitivisht në ndryshimin e kulturës dhe sjelljes së aktorëve në mbrojtjen e të dhënave personale.

Mbrojtja e të dhënave personale nuk është një e drejtë absolute, veçanërisht në funksion të lirisë së shprehjes apo për çështje që mbartin interes publik. Për këtë arsye, neni 11 i ligjit ngarkon Komisionerin për nxjerrjen e udhëzimeve ku përcaktohen kushtet dhe kriteret për shmangien e normave të ligjit, për veprimtari të veçanta (si për shembull gazetareske apo akademike). Por, ky parashikim nuk është në linjë me parashikimet kushtetuese, të cilat imponojnë një test të caktuar për kufizimin e këtyre të drejtave. Duke u referuar edhe në praktikën e ndjeshme të Gjykatave Europiane (GjEDNj dhe GjDBE) kufizimi duhet të respektojë standardet kushtetuese (dhe konventore). Ndaj, kërkohet vëmendje nga ana e ligjvënësit për të balancuar këto të drejta me ligj dhe sipas testeve të konsoliduara që burojnë nga jurisprudenca vendase dhe e huaj.

Përpos aspektit substancial, problematika janë vënë re edhe në aspektin procedural lidhur me zbatimin e ligjit. Në trajtesa janë konstatuar mangësi sa i përket kompetencave të Komisionerit si dhe të mjeteve efektive të subjekteve për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale. Ligji nuk parashikon detyrimin e Komisionerit për të rritur ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe të subjekteve për rëndësinë që kanë të dhënat personale dhe veçanërisht mbrojtja e tyre. Ky detyrim së bashku me një kuadër të qartë e të plotë të drejtash dhe detyrimesh respektive, do të shërbejë si bazë për krijimin e kulturës së mbrojtjes së të

dhënave personale.

Ligji gjithashtu nuk parashikon sanksione të tjera përveç gjobës që mund të kenë efekt parandalues apo këshillues, si këshillimi, paralajmërimi, vërejtje, ose qortimi, të cilat të zbatohen në varësi të llojit dhe seriozitetit të shkeljes.

Nga analiza e kryer rezulton gjithashtu që ka paqartësi formulimi i dispozitave lidhur me mundësinë e ankimit nga ana e subjekteve të të dhënave personale. Nuk është e qartë për subjektin e të dhënave personale se cilat janë rrugët procedurale që mund të ndjekë nëse të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paligjshme. A duhet t'i drejtohet Komisionerit ose shkelësit, përpara se t'i drejtohet gjykatës, apo mund që t'i shfrytëzojë paralelisht dhe në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra këto mjete? Ligji duhet të sqarojë se cilat janë instrumentet proceduralë që mund të shfrytëzojë subjekti i cënuar.

Në drejtim të krijimit të mekanizmave efikasë për zbatimin e ligjit, vlerësojmë se një faktor që ndikon efektivisht është regjimi i sanksioneve administrative. Regjimi i gjobave që parashikon ligji aktual nuk rezulton të jetë efektiv. Në këtë kontekst, nevojitet të zbatohet një regjim më i ashpër që të mund të rrisë (edhe pse përmes "ndëshkimit") ndërgjegjësimin për rëndësinë që ka mbrojtja e të dhënave personale. Ndëshkimet administrative duhet të jenë proporcionale me rëndësinë e shkeljeve dhe të tilla që të shkurajojnë sjelljet e ardhshme të paligjshme në sferën e të dhënave personale.

1.2 Qëndrime mbi ndëshkueshmërinë, përgjegjshmërinë e llogaridhënien, me fokus hetimin administrativ dhe penal të rrjedhjeve masive të të dhënave personale të shtetasve gjatë vitit 2021

Publikimi i tre databazave në formatin "Excel", me të dhëna masive personale dhe sensitive të një totali prej 2,070,000 individësh në vendin tonë[1], sa i takon elementëve që bëjnë të mundur identifikimin e tyre, bindjet politike, preferencat e votës e cila në fakt duhet të jetë e fshehtë, të dhënat e pagave, vendit të punës, automjeteve që kanë në pronësi, etj, tronditën mbarë opinionin publik, në një hark tepër të shkurtër kohor gjatë vitit 2021.

Lajmi për ekzistencën e databazës së parë, e ashtuquajtur databaza e "patronazhistëve" ose e "zgjedhësve" u bë publike fillimisht në portalin e lajmeve "Lapsi.al", në dt.11 Prill të vitit të kaluar, gjatë periudhës parazgjedhore për zgjedhjet parlamentare në vend[2]. Kjo databazë përmbante të dhëna personale dhe sensitive të afro 910,000 votuesve; sipas medias, e administruar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste".

Në datën 22 Dhjetor të 2021-it, një rrjedhje tjetër masive e të dhënave u komunikua gjithashtu gjerësisht në media[3], për ekzistencën e një baze të dhënash të rreth 630,000 punonjësve në sektorin publik dhe privat. Dy databazat e ashtëquajtura të pagave, të administruara në formatin "excel", kishin të dhëna në lidhje me emrin dhe mbiemrin, numrin e identifikimit dhe të kartave të identitetit, punëdhënësit (qendra e punës pranë të cilës punojnë) dhe pagat që kanë marrë, për muajin Janar dhe Prill 2021[4].

Dy ditë më vonë nga rrjedhja masive e informacionit për pagat, përkatësisht në dt.24 Dhjetor të 2021-it, u publikua lajmi për ekzistencën e një tjetër bazë të dhënash, me të dhëna për pronarët e automjeteve për

1 Kjo e dhënë reflekton shumatoren e numrit të individëve që rezultuan në tre databazat e pubikuara gjatë vitit 2021. Kjo e dhënë nuk nënkupton që këta individë janë të ndryshëm, pasi KShH nuk mund të disponojë dhe rrjedhimisht as të krahasojë përputhshmërinë e të dhënave për të bërë të mundur arritjen e këtij konkluzioni ose jo.

2 Ekskluzive/ Si na monitoron Rilindja nr e telefonit, nr ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues të Tiranës – Lapsi.al

3 https://lapsi.al/2021/12/22/superskandali-dalin-sheshit-emer-per-emer-rrogat-e-mbi-600-mije-shqiptareve/

4 https://news-31.com/news/thellohet-sandali-publikohet-databaza-me-targat-e-makinave-i22293

më shumë se 530 mijë qytetarë[5]. Databaza përmbante të dhëna si marka, modeli i automjetit, targa, posedues dhe numri i kartës së identitetit. Lista e punuar në programin "Exel" ishte e ndarë në dy kategori, makinat dhe targat për 530,452 qytetarët si dhe automjetet e kompanive, 61,513 të tilla. Në kategorinë e dytë, përfshiheshin edhe targat e ambasadave përkatëse në vendin tonë, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 14 muaj, publiku nuk e di si u arrit të merreshin, përpunoheshin, administroheshin dhe shpërndaheshin këto të dhëna, pa miratimin apo autorizimin paraprak të tyre. Shqetësues është fakti se një numër i papërcaktuar njerëzish kanë patur dhe mund të vijojnë të kenë akses në to për shkak të shpërndarjes së tyre me anë të aplikacionit "whatsappp".

Përveç reagimeve të medias apo organizatave jofitimprurëse në vend, shqetësimet lidhur me shpërndarjen masive të të dhënave personale u raportuan edhe nga Komisioni Evropian[6], Departamenti Amerikan i Shtetit (në raportin vjetor për situatën e të drejtave të njeriut në vendin tonë)[7], Misionit të Kufizuar të ODIHR[8] për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare në vendin tonë të dt.25 Prill 2021, si dhe organizata ndërkombëtare si Amnesty International[9] apo Freedom House[10].

KShH vëren se mungesa e përgjegjshmërisë dhe pandëshkueshmëria kur veprimet apo mosveprimet përbëjnë vepër penale dhe cënojnë haptazi interesin publik dhe të drejtat e njeriut, ndikon në uljen e besimit të qytetareve tek shteti i së drejtës, rrjedhimisht tek institucionet publike, duke dobësuar demokracinë. Pavarësisht se organet kompetente kanë filluar procedimin administrativ dhe penal lidhur me përgjegjësit e këtyre rrjedhjeve masive të të dhënave, deri më tani askush nuk është ndëshkuar administrativisht apo penalisht.

1.2.1 Hetimi Administrativ

Sa i takon databazës së zgjedhësve, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vërejtur një përhapje masive dhe të paligjshme të saj, nëpërmjet dy faqeve të internetit[11] për të cilat, në datë 16.04.2021 dhe datë 19.04.2021, i është drejtuar AKEP-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bllokimin e menjëhershëm të tyre, si dhe fillimin e procedimit ligjor të personave që zotërojnë/posedojnë këto faqe. Nga dokumentacioni që është vendosur në dispozicion të KShH-së, është e paqartë se kur janë krijuar këto faqe, kur ka ndodhur bllokimi i tyre dhe nëse ka patur bashkëpunim në kuadër të procedimit administrativ ose penal midis këtyre institucioneve përgjegjëse (AKEP, DPPShH dhe KMIDP) për marrjen dhe shkëmbimin e informacionit në interes të efikasitetit të hetimeve.

Edhe pse lajmi në median online për ekzistencën e databazës së zgjedhësve daton në 11 Prill, urdhërimi i hetimi administrativ nga KDIMDP, ndaj institucioneve përgjegjëse që kishin akses në disa prej këtyre të dhënave, ka nisur 8 ditë me vonesë, përkatësisht në dt.19 Prill 2021. KShH vëren se ky hetim ka filluar një një raport të zhdrejtë nga pikëpamja kronologjike, duke dëmtuar efikasitetin e hetimit në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. KDIMDP ka urdhëruar fillimin e hetimit administrativ ndaj subjektit mediatik

5 https://news-31.com/news/thellohet-sandali-publikohet-databaza-me-targat-e-makinave-i22293
6 file:///C:/Users/user/Downloads/Albania-Report-2021%20(6).pdf fq.28-29
7 ALBANIA 2021 HUMAN RIGHTS REPORT (state.gov) fq.10
8 https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf fq.19
9 Everything you need to know about human rights in Albania - Amnesty International Amnesty International fq.68
10 https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022
11 www.patronazhisti.com dhe https://adfrehasdgfh.web.app/

"Lapsi.al", ndërkohë që burimet e informacionit të medias duhet të jenë të mbrojtura, në funksion të lirisë së medias dhe misionit të saj madhor në një shoqëri demokratike. Prioritare për hetimin administrativ ishte kontrolli ndaj subjektit zgjedhor "PS" dhe institucioneve përgjegjëse që kishin akses në bazën e të dhënave që ishin pjesërisht pjesë e databazës së zgjedhësve.

Vlen të theksohet se mbrojtja e burimit gazetaresk vlen për çdo procedurë administrative apo gjyqësore (qoftë civile, penale apo administrative) dhe në çdo rast, mund të jetë mjeti i fundit i kërkimit të provës nëse përmbush testin e proporcionalitetit dhe në përputhje me kufizimet e parashikuara në nenin 10, paragrafi 2 i KEDNJ-së.

Tërheq vëmendjen fakti se subjekti zgjedhor "PS", ndaj të cilit rëndojnë dyshimet e bëra publike në media, është renditur nga KDIMDP i fundit në radhën e subjekteve të hetuara administrativisht, ndërkohë që përfaqësues të subjektit deklaruan publikisht se kanë një databazë të cilën e kanë krijuar prej vitesh të tëra organizimi, duke kontaktuar zgjedhësit derë më derë[12].

Zyra e Komisionerit referon se ka marrë 81 ankesa gjatë periudhës Prill — Gusht 2021, të cilat lidhen me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve. Gjysma e këtyre ankesave janë paraqitur ndaj subjektit zgjedhor "Partia Socialiste" dhe në një shumicë dërrmuese, por më pak se gjysma, i atribuohen AKSHI-t. Ky përbën një tregues të perceptimit të individëve ankues ndaj përgjegjësve të kësaj databaze.

Në lidhje me përhapjen e paligjshme të kategorisë së të dhënave personale për "nëpunës/punonjës" në sektorin publik dhe privat dhe përhapjen e paligjshme të kategorisë së të dhënave personale për "pronarë automjetesh", pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar 47 ankesa, prej të cilave 22 ndaj AKSHI-t dhe 25 ndaj DPT-së. Në ndryshim nga fillimi i vonuar i hetimit, kryesisht për databazën e patronazhistëve, fillimi i procedimit administrativ për databazën e pagave ka filluar menjëherë pas publikimit.

Për databazën e pagave dhe atë të automjeteve, Zyra e Komisionerit nuk ka urdhëruar hetim administrativ pranë subjekteve mediatike që kanë bërë publik lajmin.

Urdhërat e zyrës së Komisionerit për hetimin administrativ për tri databazat, në vlerësimin tonë nuk janë të plotë, pasi mungojnë orientimet për veprimet procedurale dhe mjetet që do të përdoren për kërkimin e provave nga inspektorët, si dhe deri ku do të shtrihen hetimet konkrete për secilin kontrollor. Konkretizimi dhe individualizimi i veprimtarisë hetimore do të ishte i domosdoshëm, pasi duhej vlerësuar nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes, e cila përcaktohet që në nisje të hetimit administrativ (neni 77, pika 2 e Kodit).

Publikimi i relacionit të hetimit administrativ për databazën e zgjedhësve përbën një hap shumë pozitiv në drejtim të transparencës së KDIMDP-së, ndërkohë që përmbajtja e këtij relacioni reflekton disa mangësi sa i takon konceptit të një hetimi administrativ që duhet të jetë i plotë, i gjithëanshëm, objektiv dhe efektiv.

Hetimi administrativ për databazën e zgjedhësve ndaj subjektit zgjedhor "PS" dhe institucioneve publike të kontrolluara rezulton të jetë zhvilluar pjesërisht dhe në mënyrë të cekët. Në vlerësimin tonë, Zyra e Komisionerit dispononte mjetet ligjore të cilat nuk i përdori, duke mos kërkuar një larmishmëri më të gjerë provash që mundësonin zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin konkret të përgjegjësisë së kontrolluesve. Informacioni i vendosur në dispozicion ndaj KShH-së nuk mundëson një panoramë të verifikimeve konkrete që janë kryer nga Zyra e Komisionerit pranë secilit subjekt të kontrolluar, cilat janë drejtoritë

12 https://lapsi.al/2021/04/11/alibia-e-taulant-balles-per-pergjimin-qe-ps-u-ben-te-dhenave-personale-te- qytetareve/
https://lapsi.al/2021/04/13/rama-pranon-patronazhistet-kemi-vite-qe-i-kemi-shperndare-ne-terren/

dhe dikasteret që i janë nënshtruar verifikimeve, cilët funksionarë, nëpunës apo punonjës janë marrë në pyetje, serverat që janë kontrolluar, aksesi më i gjerë në sistemet kompjuterike, etj.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar pranë subjekteve, Komisioneri ka paraqitur një listë me pyetje dhe kërkesa në lidhje me veprimtaritë përpunuese të të dhënave personale nga kontrolluesi në fjalë. Me përjashtim të DPGJC-së, tërheq vëmendjen fakti se 3 kontrolluesit e tjerë (AKSHI, PS dhe DPT) kanë treguar një nivel të ulët bashkëpunimi në dhënien e informacionit dhe pranimin e përgjegjësive. Gjithashtu, KShH vëren se ky informacion nuk i është nënshtruar verifikimit me mjete të tjera të kërkimit të provës gjatë hetimit administrativ, duke lënë të nënkuptohet në relacionin përkatës, se inspektorët e KDIMDP-së nuk kanë patur akses në serverat dhe sistemin kompjuterik të subjekteve të kontrolluara. Mungesa e aksesit pranohet nga KDIMDP, në shkresën zyrtare drejtuar KShH-së për vendosjen në dispozicion të informacionit, me shpjegimin se prokuroria ka vendosur sekuestro mbi to. Megjithatë, në terma më konkretë, në relacionin administrativ por edhe në korrespondencën me KShH, nuk ka informacion të mëtejshëm mbi bashkërendimin e punës pa krijuar pengesa, për secilin institucion (KDIMDP dhe Prokurorinë). Është e paqartë nëse sekuestro e prokurorisë ishte me afat apo jo (pasi serverat janë të domosdoshme në punën e institucioneve), dhe a mundej KDIMDP të realizonte verifikime në ato pajisje apo sisteme që nuk kanë qenë në sekuestro. Një mënyrë tjetër për të shmangur këtë pengesë ishte të pezullohej përkohësisht procedimi administrativ deri në rënien e shkakut që krijonte pengesë konform dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative[13].

Zyra e Komisionerit reflekton një qasje me dy standarte sa i takon sanksioneve administrative me gjobë, ndaj subjekteve që nuk kanë bashkëpunuar plotësisht gjatë hetimit administrativ për databazën e zgjedhësve. Për mungesë bashkëpunimi, KDIMDP ka dhënë sanksion administrativ të vonuar në kohë, vetëm ndaj DPT-së, katër muaj pasi ka filluar hetimi administrativ. Ndërkohë, ndaj AKSHI-t dhe subjektit zgjedhor PS, nuk janë aplikuar sanksione të tilla, edhe pse një pjesë e informacionit ka rezultuar i munguar prej këtyre dy subjekteve, gjatë procedimit administrativ. Përballë faktit të një bashkëpunimi të cunguar, si dhe qasjes së nëpunësve publikë të subjekteve të kontrolluara për të shmangur përgjegjësinë, duke ia ngarkuar këtë njëra- tjetrës, KDIMDP mund të kishte përshkallëzuar mjetet ligjore, me kallëzim penal drejtuar prokurorisë për elementë të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal[14]).

Tërheq gjithashtu vëmendjen fakti që një pjesë e përgjigjeve që shmangin dhënien e informacionit nga DPT janë formuluar në mënyrë të njëjtë me përgjigjet e AKSHI-t, duke ngritur dyshime të arsyeshme, për shkëmbimin e informacionit midis këtyre dy institucioneve gjatë hetimit administrativ të kryer nga KDIMDP.

Pavarësisht detyrimit për të krijuar, administruar dhe mirëmbajtur Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), KDIMDP ka vërejtur se SMSI ka munguar në thuajse të gjitha organet publike që janë hetuar administrativisht përfshi edhe subjektin zgjedhor PS. Për autoritetet publike që janë kontrolluar

13 Sipas nenit 23 të Kodit të Procedurave Administrative, në qoftë se vendimi përfundimtar në një procedim administrativ varet nga marrja e një vendimi paraprak, i cili është në kompetencën e një organi tjetër administrativ apo të gjykatës, organi që ka kompetencë për marrjen e vendimit përfundimtar e pezullon procedimin përkatës, deri kur organi tjetër administrativ ose gjykata e kanë marrë vendimin paraprak. Përjashtimi nga ky rregull lejohet vetem në rastet kur mosmarrja e menjëhershme e vendimit i shkakton dëm të pariparueshëm të drejtave themelore kushtetuese të palëve.

14 Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

para se të publikohej lajmi për databazën e zgjedhësve, këto mangësi janë reflektuar në raportet vjetore të KDIMDP pranë Kuvendit. Megjithatë, ky sinjalizim i KDIMDP nuk i shërbeu parandalimit të ngjarjes, ndërkohë që ri-konstatimi i mungesës së këtij sistemi gjatë hetimit administrativ për databazën e zgjedhësve, nuk ka shërbyer si shkak i nevojshëm për tu dënuar administrativisht.

Gjatë hetimit administrativ, tërheq gjithashtu vëmendjen fakti se DPT dhe PS, kanë vendosur në dispozicion pjesërisht informacionin e kërkuar në një afat të vonuar, përkatësisht 20 dhe 40 ditë nga data e fillimit të procedimit administrativ. Kjo vonesë krijon premisa potenciale për tjetërsimin apo fshehjen e provave të nevojshme, për të cilat Zyra e Komisionerit nuk ka kërkuar konform Kodit të Procedurave Administrative, sigurimin e tyre që në krye të hetimit administrativ (sikurse mund të ishin serverat apo burime të tjera të provës).

Në përfundim të hetimit administrativ ndaj tre subjekteve (kontrolluesve publikë), zyra e KDIMDP -arrin në konkluzione hipotetike, se nuk përjashtohet mundësia që të dhënat e databazës së patronazhistëve të jenë marrë nga baza e të dhënave që kontrollohen dhe/ose përpunohen prej këtyre institucioneve apo subjekteve të kontraktuara/nënkontraktuara prej tyre. Këto konkluzione nuk i shërbejnë aspak interesit publik dhe dobësojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien e subjekteve të hetuara administrativisht.

Konkluzioni i KDIMDP-së ndaj subjektit zgjedhor "PS", se databaza e gati 910,000 zgjedhësve mund të jetë krijuar nga struktura të caktuara partiake dhe organizative në nivele lokale, kandidatë apo subjekte të kontraktuar a nënkontraktuar ndaj tyre, në kundërshtim me rregullat e brendshëm të organizimit të këtij kontrolluesi, nuk është bindëse në sytë e opinionit publik dhe mbart elementë të njëanshëm subjektiv, duke minimizuar përgjegjësinë e vetë subjektit si një organizatë e vetme politike.

Është e paqartë se përse në kushtet e mosrespektimit të detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, KDIMDP nuk ka dhënë për asnjë nga subjektet e kontrolluara dënim administrativ me gjobë, konform nenit 39 të ligjit nr.9887/2008[15]. Në përfundim të hetimit, KDIMDP ka dalë vetëm me rekomandime të përgjithshme ndaj subjekteve, të cilat nuk parashikojnë afate brenda të cilave duhet të përmbushen. Këto rekomandime do të ishin të përshtatshme në kuadër të një inspektimi tematik dhe jo në një çështje të tillë me ndjeshmëri të lartë publike, ku prioritare ishte identifikimi i përgjegjësve të rrjedhjes, përpunimit dhe administrimit të paautorizuar të të dhënave personale dhe sensitive në databazën e 910,000 zgjedhësve.

1.2.2 Hetimi Penal

Menjëherë pas publikimit të lajmit në media për ekzistencën e databazës së zgjedhësve, Prokuroria e Posaçme ka filluar hetimin penal kryesisht, duke bërë bashkimin e çështjes me kallëzimin penal të bërë nga subjekti zgjedhor "PD", për veprën penale të "Korrupsionit Aktiv në Zgjedhje". Pas regjistrimit të procedimit, SPAK kërkoi menjëherë sekuestron ndaj kompjuterave dhe mjetet e punës së portalit mediatik "Lapsi.al", që publikoi për herë të parë lajmin e ekzistencës së tij. Kërkesa e SPAK u pranua nga GJKKO e shkallës së parë me vendimin nr.131, dt.18 Prill 2021[16]. Tre ditë më vonë, në dt.21 Prill, GJEDNJ urdhëroi

15 Pavarësisht se shkeljet nuk lidhen drejtpërsëdrejti me objektin e hetimit administrative, por sërisht ato janë konstatuar dhe analizuar gjerësisht në relacionin e hetimit administrativ ndaj këtyre subjekteve

16 Në bazë të rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo e fundit mund të vendosëmasat të përkohshme të cilat janë detyruese për shtetin e interesuar. Masat e përkohshme aplikohen vetëm në raste përjashtimore. Gjykata mund të lëshojë masa të përkohshme kundër një shteti anëtar, vetëm pasi ka shqyrtuar të gjithë informacionin përkatës dhe kërkuesi përballet me një rrezik serioz apo dëm të pakthyeshëm nëse këto masa nuk aplikohen.

shtetin Shqiptar të ndalojë zbatimin e vendimit të sekuestros të çdo pajisje për ruajtjen e të dhënave si dhe të dhënave kompjuterike apo elektronike, duke vendosur në favor të drejtuesve të portalit me një masë të ndërmjetme, sipas rregullit 39 të Rregullores së GJEDNJ[17].

Pesë muaj pas nisjes së hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka pushuar çështjen penale për mungesë kompetence, duke ja përcjellë atë Prokurorisë së juridiksionit të zakonshëm (pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë). Me shqetësim vërehet se për databazën e zgjedhësve nuk ka asnjë person që të jetë marrë në cilësinë e të pandehurit edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga regjistrimi fillestar i procedimit penal prej Prokurorisë së Posaçme.

Sa i takon databazës së pagave, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur kryesisht procedimin penal, menjëherë pas publikimit të lajmit. Lidhur me të, nuk ka patur kallëzim penal. Gjatë hetimeve, vepra penale i është atribuar dy specialistëve të AKSHI-t dhe 2 punonjësve të sektorit privat. Në një konferencë për shtyp të mbajtur nga ish-drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së Parë dhe Policia e Shtetit në datë 7 janar 2022 , rezulton se hetimet për publikimin e pagave dhe targave janë zhvilluar njëkohësisht pasi për të dyja çështjet janë akuzuar të njëjtët autorë[18]. Ndërkohë në njoftimin e bërë nga kjo prokurori për përfundimin e hetimeve lidhur me publikimin e pagave 4 muaj më vonë, nuk ka asnjë informacion sa i përket çështjes së targave ose automjeteve. Gjithashtu, në referencë të informacionit që na është vendosur pjesërisht në dispozicion nga kjo prokurori, vihet re që të dhënat i referohen hetimeve penale për databazën e pagave dhe jo asaj të automjeteve.

Në kuadër të hetimeve penale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për databazën e pagave, në hard diskun objekt ekspertimi që i përket një prej të pandehurve, u konstatua gjithashtu edhe një numër i konsiderueshëm dokumentash të tjerë me të dhëna bankare për klientë të ndryshëm. Ky element është shqetuësues në drejtim të sigurisë së të dhënave të tjera. Është e paqartë se si janë marrë këto të dhëna dhe nëse ka patur nga prokuroria referim për hetimin administrativ të subjekteve (kontrollues në sektorin bankar apo më gjerë) që janë në kontakt me këto të dhëna.

Hetimi nga Prokuroria, përveç se duhet të jetë i plotë, objektiv dhe gjithëpërfshirës, gjithashtu duhet të jetë efikas dhe të realizohet në kohë të arsyeshme. Në të kundërt, ekziston rreziku që provat mund të dëmtohen, manipulohen apo edhe asgjësohen. Kohëzgjatja e hetimit penal sa i takon të dhënave personale të pagave të punonjësve rezulton 5 muaj. Hetimi është kryer nga prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë në një afat të arsyeshëm për sa i takon kompleksitetit të çështjes.

Nga njoftimi zyrtar për përfundimin e hetimeve penale lidhur me databazën e pagave, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer hetimet ndaj 2 punonjësve të AKSHI-t lidhur me akuzat për "Shpërdorim detyre", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe për 2 të pandehurit e tjerë, punonjës në sektorin privat lidhur me veprën penale "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike". Referuar nenit 75/a, gërma "a" dhe nenit 80, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, tërheq vëmendjen fakti se dy prej këtyre veprave penale (neni 244 dhe 259 i Kodit Penal) janë në kompetencë lëndore Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Është e paqartë se në ç'kushte dhe rrethana e rrjedhimisht edhe mbi ç'bazë ligjore janë hetuar këta shtetas nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vepra penale që janë posaçërisht në kompetencën lëndore të SPAK-ut dhe GJKKO-së.

Ndaj Prokurorisë së Posaçme janë kërkuar kopje të vendimmarrjeve të fillimit të procedimit penal dhe

17 COURT-7003525-v2-20204_21_LE2_2a_R39_Granted_Only.pdf (reporter.al)

18 https://a2news.com/2022/01/07/skandali-i-publikimit-te-pagave-4-te-arrestuar-prokuroria-zbardh-skemen-do-ti-shkohet-deri-ne-fund-cdolloj-subjekti-te-perfshire/

pushimit të tij për databazën e zgjedhësve si dhe për ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të çështjeve prej Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë. Ky informacion nuk është vendosur në dispozicion të KShH-së. Prokuroria e Posaçme ka shmangur dhënien e përgjigjes, duke referuar për më tepër informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Parë Tiranë. Në fokus të kërkesës për informacion të KShH-së, ka qenë nëse SPAK ka hetuar funksionarët e nivelit të lartë të institucioneve, prej të cilave dyshohet se kanë rrjedhur këto të dhëna (AKSHI, Ministria e Ekonimisë dhe Financave), bashkëpunimi mes prokurorive dhe organeve të tjera ligjzbatuese dhe publike në funksion të hetimeve, nëse ka patur vështirësi në marrjen dhe grumbullimin e provave, etj. Ky informacion me interes të lartë publik, edhe pse çështje penale është pushuar nga Prokuroria e Posaçme për shkak të moskompetencës nuk është bërë ende publik.

Bazuar në dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit nr.119/2014, KShH ka bërë ankim në zyrën e KDIMDP-së, e cila i është drejtuar dy prokurorive me kërkesë për dhënien e informacionit. Por sërisht, prokuroritë kanë shmangur vendosjen e plotë të tij, në dispozicion të KShH-së. Pavarësisht se vendi është në një fazë të rëndësishme të reformimit të sistemit të drejtësisë, vihet re një qasje ende e mbyllur e organit të prokurorisë për të vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar nga KShH, që do të mundësonte një analizë objektive dhe më tërësore të ecurisë dhe efektivitetit të hetimeve, afateve të hetimit, bashkëpunimin midis institucioneve, vendimmarrjet e prokurorisë, etj

HYRJE

Ekonomia dhe shoqëria në tërësi kanë pësuar ndryshime të ndjeshme për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informacionit. Në qendër të këtyre ndryshimeve janë të dhënat (jo vetëm personale), pasi pjesa kryesore të ekonomisë funksionon në bazë të të dhënave, inovacioni dhe shkenca bazohen tek të dhënat për përparimin e mëtejshëm.[19] Përpunimi dhe përdorimi në mënyrën e duhur i të dhënave ndihmon në nxitjen e konkurrueshmërisë së tregjeve, përmirësimin e shëndetit, mjedisit dhe qeverisjes në përgjithësi[20]. Për këtë arsye është e nevojshme që të dhënat t'i shërbejnë këtyre qëllimeve, por pa cenuar privatësinë e subjekteve të të dhënave. Pra, në ekonominë dhe shoqërinë digjitale të dhënat janë lënda e parë për të rritur përfitimet për individët, por këto procese duhet t'i përmbahen kufizimeve ligjore. Ndaj janë përcaktuar norma për mbrojtjen e të dhënave personale që synojnë ravijëzimin e kufijve të përpunimit të tyre. Përgjithësisht këto norma kanë një qëllim të dyfishtë, pasi njëherësh mbrojnë të dhënat personale të individëve si dhe lejojnë qarkullimin e të dhënave, sipas kushteve të caktuara.

Edhe në vendin tonë, mbrojtja e të dhënave personale, përveç parashikimit në nivel kushtetues, ka edhe një rregullim të posaçëm ligjor i cili përcakton kushtet dhe kufijtë e përpunimit të të dhënave nga autoritetet publike dhe privatët. Ligji në fuqi është hartuar duke patur si model Direktivën 95/46/EC mbi mbrojtjen e të dhënave të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të tyre. Megjithatë, në Bashkimin Europian u ndërmor një reformë gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale që u finalizua me miratimin në 2016 të një pakete aktesh me këtë fokus, ku veçojmë specifikisht Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo rregullore shërben si kuadri bazë për mbrojtjen e të dhënave personale e cila ka përforcuar të drejtat esubjekteve, ka rritur transparencën, ka rritur përgjegjësinë e subjekteve që administrojnë të dhënat si dhe ka ridimensionuar rolin e Autoriteteve mbikëqyrëse.

Duke marrë shkas nga kjo reformë në Bashkimin Europian dhe nga kërkesat e vazhdueshme të Komisionit për harmonizimin e legjislacionit vendas me acquis, ky dokument politikash synon të evidentojë nivelin e përputhshmërisë së ligjit tonë "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Gjithashtu, dokumenti synon njëherësh të nxjerrë në pah pikat e dobëta të ligjit që ndikuan në rrjedhjet masive të të dhënave dhe se si standardi i ri europian ndihmon në parandalimin e fenomeneve të tilla në të ardhmen. Në përfundim të analizës dhe duke vlerësuar edhe sjelljen e autoriteteve vendase ndaj tre rrjedhjeve masive të të dhënave (disa edhe me karakter sensitiv) dokumenti përcjell disa rekomandime të vlefshme për përmirësimin e ligjit në fuqi.

1.1. Konteksti

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, referon se vijojnë përpjekjet për të përafruar legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 dhe me Direktivën e Policisë 2016/680. Shqipëria ka miratuar në parim Protokollin për ndryshimin e Konventës për Mbrojtjen e të Individëve sa i takon përpunimit automatik të të dhënave

19 Strategjia Europiane për të Dhënat, 19.2.2020, e aksesueshme në (https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0066&from=EN)

20 Strategjia Europiane për të Dhënat, 19.2.2020, e aksesueshme në (https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0066&from=EN

personale, duke i hapur rrugë nënshkrimit të tij. Në tërësi, Komisioni Evropian i rekomandon Shqipërisë përditësimin ose azhornimin e sistemit të sigurisë, duke kufizuar aksesin në, dhe përdorimin e databazave të administruara nga shteti ku ruhen të dhënat personale.

Prej afro një dekade e gjysëm, përkatësisht në 10 Mars të vitit 2008, Shqipëria ka miratuar ligjin nr.9887 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale", i cili ka pësuar ndryshime përkatësisht dy herë, në vitin 2012 dhe 2014, me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, i cili realizohet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private[21]. Sipas këtij ligji, KDIMDP është autoriteti përgjegjës dhe i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin. KDMIDP gëzon ndër të tjerash, kompetencën për të kryer hetime administrative dhe për të patur akses në përpunimet e të dhënave personale, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes; kompetencën për të urdhëruar bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullimin e përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale. Në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme, Komisioneri sanksionon kundravajtjet administrative, mund të japë dënime me gjobë, të bëjë kallëzim në prokurori dhe të denoncojë publikisht ose raportojë çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Mbrojtja që shteti i ofron individit në drejtim të privatësisë është jo vetëm në kuadër të së drejtës publike por gëzon gjithashtu mbrojtje të posaçme në legjislacionin penal. Neni 121 i Kodit Penal sanksionon si kundravajtje penale, ndërhyrjen e padrejtë në jetën private, e cila ndër të tjerash realizohet edhe me ruajtje për publikim apo publikim të dhënash që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij. Kjo vepër penale dënohet me gjobë ose burgim gjer në dy vjet. Nga mënyra se si realizohet kjo vepër penale, mund të ndodhemi para faktit që ajo mund të konkurrojë efektivisht (konkurrimi real) me vepra të tjera penale të cilat sanksionohen gjithashtu në Kodin Penal, si Shpërdorimi i Detyrës (neni 248 i Kodit Penal), Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike (Neni 244 i K.Penal), Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë (neni 245), Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259), Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260), Ndërhyrja në sistemet kompjuterike (neni 293/c), etj. Në raste të tilla, kjo rëndon pozitën e personave të akuzuar, sjellja e të cilëve dënohet njëkohësisht nga dy norma të ndryshme, duke sjellë edhe rëndim të masës së dënimit, pasi kemi të bëjmë me shumë se një shkelje të normës që përbën vepër penale[22].

Nëse shkeljet e dispozitave të legjislacionit që mbron të dhënat personale përbëjnë kundravajtje administrative dhe/ose penale, kuadri ynë parashikon garancitë e nevojshme dhe të mjaftueshme procedurale që hetimi administrativ që kryen KMDIMP dhe hetimi penal që kryhet nga organi i prokurorisë, të jetë i plotë, i gjithëanshëm, objektiv dhe efektiv. Respektimi i afateve të procedurës administrative dhe të hetimit penal janë kërkesa të parashikuara përkatësisht në Kodin tonë të Procedurave Administrative si dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Rrjedhjet masive të të dhënave personale dhe sensitive gjatë vitit 2021, evidentuan nevojën e menjëhershme për mbrojtjen e qytetarëve nga cenimi i të dhënave të tyre, si dhe domosdoshmërinë për llogaridhënie, përgjegjshmëri dhe transparencë, të autorëve të këtyre databazave por dhe institucioneve që ligji ngarkon me detyrën për të zbardhur dhe ndëshkuar autorët përgjegjës. Publikimi i lajmit për këto databaza tërhoqi

21 https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Ligj_Nr.9887_dat%C3%AB_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf
22 Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.3, dt. 02.11.2015

gjithashtu vëmendjen e organizatave dhe aktorëve ndërkombëtarë, të cilët evidentuan shqetësimin lidhur me sigurinë e këtyre të dhënave. Konkretisht:

- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 nënvizoi se, KDIMDP ka nisur kryesisht një hetim administrativ për rrjedhjen e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë preferencat politike të dala në kuadër të fushatës për zgjedhjet parlamentare të dt.25 Prill. KDMIDP j'u drejtoi rekomandime autoriteteve përkatëse për përditësimin e protokolleve të sigurisë dhe kufizimin e aksesit dhe përdorimit të të dhënave personale të ruajtura në bazat e të dhënave shtetërore. Ky institucion ka dhënë një vendim për vendosjen e sanksionit ndaj organeve tatimore për mosbashkëpunim. Komisioni Evropian kërkon ndjekjen me shpejtësi të këtyre rekomandimeve, pa paragjykuar procedurat e tjera nga autoritetet kompetente që synojnë vlerësimin e integritetit të procesit zgjedhor.
- Referuar raportit përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të dt.25 Prill 2021, të Misionit të kufizuar të ODIHR-it për vëzhgimin e tyre, evidentohet se ndarja ose kombinimi i paautorizuar i të dhënave personale të votuesve për qëllimet e supozuara të angazhimit demokratik mund të konsiderohet shkelje e angazhimit për mbrojtjen e të drejtës për jetën private dhe familjare. Kjo mund të dëmtojë besimin e elektoratit, duke përfshirë edhe besimin te fshehtësia e votës së tyre[23].
- Sipas raportit të Freedom House për Lirinë në Botë, të vitit 2022, evidentohet se në Shqipëri, kritikët, duke përfshirë anëtarë të opozitës, kanë akuzuar Partinë Socialiste se ka vjedhur të dhëna nga faqet zyrtare të qeverisë dhe i kanë përdorur ato për të "frikësuar" votuesit. Partia Socialiste ka mohuar në mënyrë të vazhdueshme se kjo databazë është krijuar apo përdorur ilegalisht.

1.2. Qëllimi i Dokumentit

Dokumenti analizon në mënyrë strategjike, kuadrin ligjor dhe institucional në vendin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale, duke synuar të identifikojë mangësitë, papajtueshmëritë apo boshllëqet më prioritare që nevojitet të harmonizohen me legjislacionin e BE-së.

Me qëllim që ky vlerësim të mos jetë vetëm në rrafshin teorik por të ndërthuret edhe me aspekte praktike, në një pjesë të veçantë të tij, dokumenti parashtron dhe analizon qëndrimet lidhur me ndëshkueshmërinë e rrjedhjeve masive dhe të paprecedenta, të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë por edhe të huaj, në Prill dhe Dhjetor të vitit që lamë pas (2021). Konkretisht, në dokument është analizuar veprimtaria e KDIMDP dhe organit të prokurorisë, sa i takon hetimeve të kryera (në përputhje me fushën e komptencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK-ut) për këto raste.

1.3. Metodologjia

Dy krerët e parë të dokumentit, me qasje politike, kanë në fokus të analizës, pajtueshmërinë e ligjit shqiptar "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR). Nënvijëzojmë se në këtë analizë nuk u mor në konsideratë projektligji "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i cili, në kohën e shkrimit të këtij dokumenti, ishte ende në proces rishikimi në Ministrinë e Drejtësisë. Në vlerësimin e kuadrit ligjor Europian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale janë përdorur akte të natyrave të ndryshme, si rregullore, direktiva, raporte vlerësimi si dhe artikuj shkencorë dhe jurisprudencë e Gjykatave Europiane (GjEDNj dhe GjDBE). Duke qenë se

23 https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf fq.19

është shfrytëzuar një listë e gjatë burimore, analiza dhe vlerësimi i këtij kuadri është më i plotë krahasuar me ligjin vendas. Nga ana tjetër, në kontekstin kombëtar analiza u përqëndrua në përmbajtjen e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi si dhe intervistat e realizuara me përfaqësues të KDIMDP dhe të Ministrisë së Drejtësisë, duke qenë se u konstatua një mungesë e ndjeshme e punimeve me karakter shkencor si dhe jurisprudencës në këtë fushë.

Ky dokument ndjek këtë strukturë: Në kreun e parë jepet një vështrim i përgjithshëm i rregullimit europian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pjesë e trajtesës është edhe kuadri rregullativ i Këshillit të Europës, duke qenë se Konventa për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale është i vetmi akt ndërkombëtar me fuqi detyruese për mbrojtjen e të dhënave personale përtej territorit të BE. Në kreun vijues, është vlerësuar përputhshmëria e ligjit me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kre janë adresuar disa nga aspektet kryesore të ligjit si të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, detyrimet e kontrolluesve dhe mekanizmat për zbatimin efektiv të ligjit.

Në kreun e tretë, dokumenti analizon dhe parashtron qëndrimet në terma sasiorë dhe cilësorë, mbi efikasitetin e organeve përgjegjëse sa i takon ndëshkueshmërisë së tre precedentëve të rrjedhjeve masive të të dhënave personale dhe sensitive, përkatësisht në prill dhe dhjetor, të vitit 2021.

Në funksion të kësaj analize, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka kërkuar informacion me kërkesa zyrtare ndaj KDIMDP-së[24], Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë[25].

Konkretisht informacioni i kërkuar nga organet përkatëse të prokurorisë ka të bëjë me numrin e rasteve të kallëzimeve dhe subjektet të cilat kanë vendosur në lëvizje këto prokurori dhe vënia në lëvizje kryesisht (ex-officio ose me nismë të vetë prokurorisë), vendimmarrjet e fillimit të procedimeve, si ka qenë ecuria e ndjekjes së mëtejshme të çështjeve dhe saktësimin e kategorisë së autorëve, veprat penale për të cilat janë akuzuar si dhe kohëzgjatjen e hetimeve. Në fokus të veçantë të kërkesës për informacion ka qenë nëse SPAK ka hetuar funksionarët e nivelit të lartë të institucioneve, prej të cilëve dyshohet se kanë rrjedhur këto të dhëna (AKSHI, Ministria e Ekonimisë dhe Financave), nëse është ngritur akuzë në Gjykatën kompetente, si dhe mbi ecurinë e gjykimit të këtyre çështjeve, bashkëpunimi mes prokurorive dhe organeve të tjera ligjzbatuese dhe publike në funksion të hetimeve, nëse ka patur vështirësi në marrjen dhe grumbullimin e provave si dhe rastet e ankimit ndaj vendimeve të prokurorive.

Në përgjigjet zyrtare, informacioni i vënë në dispozicion nga ana e prokurorive ka qenë i pjesshëm. Kështu në to është dhënë një informacion i përgjithshëm lidhur me hetimet sa i përket regjistrimit të kallëzimeve kryesisht apo me kallëzim nga subjekte të tjera, objektin e kallëzimeve dhe veprat penale të konsumuara, pa sqarime lidhur me procesin dhe kryerjen e hetimeve nga ana e tyre. Sa i përket kësaj pjese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar referon në kërkim të informacionit në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës

24 Kërkesa për informacion me Nr. Prot 279 i është dërguar KDIMDP-së datë 12 Prill 2022, me objekt vendosjen nëdispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në pikat e kërkesës.
Shkresë kthim përgjigje e ardhur nga KDIMDP-ja datë 22 Prill 2022, me Nr.Prot 793/1.

25 Kërkesë me nr. Prot 277 datë 11 Prill 2022, me objekt 'kërkesë për informacion dhe vendosje në dispozicion të kopjes së dokumentacionit të anonimizuar'drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
Shkresë nr. 5471/1 Prot/ S.M datë 14.04.2022 Kthim përgjigje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Shkresë nr. 2990/1 Prot datë 15.04.2022 Kthim përgjigje Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

së Parë Tiranë në kthim përgjigjen e saj është shpehur se lidhur me ecurinë e procesit hetimor nuk mund të jepej informacion i hollësishëm në fazën në të cilën ndodheshin hetimet.

Gjendur në një situatë ku informacioni i vënë në dispozicion nga ana e prokurorive ka qënë i pjesshëm, jo i plotë, KShH i është drejtuar me 2 ankime KDIMDP-së me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Autoritetit Publik/ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar[26].

Pas ndërhyrjes së Komisionerit, në kthim përgjigjet e prokurorive ka pasur sërish mungesë informacioni lidhur me procesin e zhvillimeve të hetimeve duke sjellë të njëjtën përgjigje si në korrespondencën e parë. Ndërkohë në datë 09.05.2022 nga ana e medias është publikuar vendimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për përfundimin e hetimeve për çështjen e publikimit të databazave me pagat e shtetasve shqiptarë të punësuar në institucione private dhe shtetërore.[27]

Monitorimi i veprimtarisë së KDIMDP, është realizuar jo vetëm për të siguruar transparencën dhe informimin e nevojshëm të publikut për çështje të tilla me interes të lartë publik, por edhe për të identifikuar mangësi dhe nevoja të tjera që kanë të bëjnë me kapacitetet dhe nevojën për përmirësimin e politikave, në suazën e detyrimeve dhe kërkesave që diktohen në kuadër të integrimit të vendit në familjen evropiane. Në fokus të veçantë të analizës së efikasitetit të hetimit administrativ të kryer nga KDIMDP-ja për databazën e zgjedhësve, apo siç njihet ndryshe databaza e patronazhistëve, ka qenë relacioni i zyrës së Komisionerit për hetimin administrativ të realizuar ndaj disa subjekteve. Në këtë drejtim, në pjesën e tretë i kushtohet një vëmendje të veçantë mjaftueshmërisë së hetimit administrativ sa i takon mjeteve të kërkimit të provës, afateve, si dhe elementë të tjerë të procedurës administrative.

Në pjesën e katërt dokumenti përcjell disa rekomandime të vlefshme për përmirësimin e standardit të mbrojtjes së të dhënave personale në legjislacionin dhe përafrimin e tij plotësisht me GDPR si dhe ndaj institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale kur ato cënohen në kundërshtim me ligjin dhe rrjedhimisht sanksionohen administrativisht dhe/ose penalisht.

26 Ankim nr. 908 Prot datë 04.05.2022 me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Autoritetit Publik/Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar drejtuar Komisionerit për të drejtën e Informimit
Ankim nr. 908/1 Prot datë 04.05.2022 me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
Shkresë nr. 6708/1 Prot/ M.XH datë 11.05.2022 Kthim përgjigje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë TiranëShkresë nr. 2990/3 Prot datë 10.05.2022 Kthim përgjigje Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

27 https://shqiptarja.com//uploads/ckeditor/62840c6b88a45CamScanner%2005-16-2022%2023.14%20(1)_001.pdf .

KREU I

A. Kuadri Rregullativ Europian në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

1. Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë themelore e përfshirë në Kartën Europiane të të Drejtave Themelore. Në nenin 8 të saj përcaktohet se kushdo ka të drejtë për mbrojtjen e të dhënave personale që lidhen me të.[28] Në të vërtetë, e drejta themelore për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të konsiderohet si një *Habeas Corpus* e re, në drejtim të pacënueshmërisë së personit në dimensionin elektronik.[29] Për të ofruar një mbrojtje të plotë dhe efektive të të dhënave personale në Bashkimin Europian, është miratuar legjislacion i posaçëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Në 2016 u miratua Rregullorja për Mbrojtjen e Përgjithshme të të Dhënave Personale, (e njohur edhe si GDPR).[30] Ndonëse e miratuar që në 2016, ajo i filloi efektet në 2018, moment i cili u shoqërua me vëmendje të shtuar të prakticienëve dhe teoricienëve. Rregullorja e sipërpërmendur vijon, ndonëse në një kontekst të përmirësuar, traditën e mbrojtjes së të dhënave personale të krijuar nga Direktiva 95/46/EC mbi mbrojtjen e të dhënave të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të tyre. Kjo direktivë shërbeu si shtrati mbi të cilin u ngrit dhe u ndërtua GDPR, duke integruar edhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian si dhe koncepte të reja të lidhura me zhvillimin teknologjik dhe realitetin virtual.[31] Në të vërtetë, Direktiva shërbeu edhe si bazë për Kartën Europiane të të Drejtave Themelore, në të cilën u njoh në mënyrë autonome e drejta themelore për mbrojtjen e të dhënave, sigurisht e lidhur me të drejtën për jetë private (privacy). Direktiva 95/46/EC ka nisur si një përpjekje për të harmonizuar legjislacionet paraekzistuese të Shteteve Anëtare.[32] Ndërkohë që miratimi i rregullores u diktua nga nevoja për të harmonizuar edhe më tej mbrojtjen e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare si dhe për të përditësuar këtë kuadër ekzistues me zhvillimet e reja teknologjike.

Në vijim do të përmenden shkurtimisht, ndonëse nuk janë fokusi kryesor i këtij dokumenti, edhe akte të tjera të miratuara në Bashkimin Europian që janë me rëndësi për mbrojtjen e të dhënave personale. Qëllimi i përfshirjes së tyre lidhet me ofrimin e një kuadri të plotë lidhur me standardin e mbrojtjes së të dhënave personale që ofron BE-ja.

2. Direktiva e Policisë

Përveç rregullores së sipërpërmendur, në kuadrin rregullativ të BE-së mbi mbrojtjen e të dhënave personale, Është miratuar edhe Direktiva 2016/680 mbi mbrojtjen e personave fizikë nga përpunimi i të dhënave nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose

28 Neni 8, Karta Europiane e të Drejtave Themelore https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT

29 Shih S. Rodota, "Data Protection as fundamental Right", in S. Gutwirth et al, (Eds) Reinventing Data Protection?, Springer 2009

30 Regulation (EU) 2016/679 (General Data Protection Regulation) in the current version of the OJ L 119, 04.05.2016

31 Th. Streinz, The Evolution of European Data Law, published in P. Craig dhe G. de Burca (eds), The Evolution of EU Law, Oxford University Press, 2021, f. 902-936.

32 Th. Streinz, The Evolution of European Data Law, published in P. Craig dhe G. de Burca (eds),The Evolution of EU Law, Oxford University Press, 2021, f. 902-936.

ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbi qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave.[33] Kjo direktivë ka një fokus të përcaktuar që lidhet vetëm me përpunimin e të dhënave personale në sferën penale, duke krijuar kushtet e përshtatshme për përpunimin e të dhënave nga organet e rendit, por duke mos cënuar të drejtat themelore të individëve. Direktiva është miratuar njëherësh me Rregulloren dhe ka reflektuar të njëjtat standarde të rregullores, por duke e përshtatur me natyrën e veprimtarisë së autoriteteve në fushën penale. Miratimi i këtyre dy akteve së bashku, si një paketë, synoi prezantimin e njëhershëm të standardeve të reja për mbrojtjen e të dhënave personale në secilin sektor.

Direktiva krijoi një kuadër më gjithëpërfshirës në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale, të cilat janë në të njëjtën linjë me detyrimet që burojnë nga Rregullorja, dhe që përmbajnë përjashtime, ku është e nevojshme.[34]

3. Direktiva e privatësisë në komunikimet elektronike (a.k.a e-Privacy Directive)

Direktiva e privatësisë elektronike[35] është një tjetër instrument me rëndësi që plotëson dhe shpesh herë tejkalon Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për shkak se kjo direktivë i referohet ekskluzivisht përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjes së privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike. Midis këtyre dy instrumenteve ka një lidhje organike, pasi parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale burojnë nga Rregullorja, ndërsa direktiva plotëson me kërkesat specifike që diktohen nga sektori i veçantë që ajo mbulon, duke shërbyer si lex specialis. Pra, në këtë mënyrë, ka një fushë zbatimi shumë më të kufizuar. Direktiva zbatohet për sektorin e telekomunikacionit për shkak të specifikave që pasqyron si dhe për shkak të zhvillimeve të shoqërisë së informacionit. Direktiva përcakton detyrimin për të njoftuar dhe për të marrë miratimin e përdoruesve të internetit përpara se këta të fundit të përdorin gjurmuesit (tracking cookies) apo teknologji të ngjashme.[36] Në frymën e Rregullores për Mbrojtjen e Përgjithshme të të Dhënave Personale, që miratimi për përpunim të konsiderohet i vlefshëm, duhet të jetë tregues i qartë i vullnetit të lirë, specifik, të informuar të subjektit të të dhënave personale për përpunimin e të dhënave lidhur me të.[37] Gjithësesi, përcaktohen raste përjashtimore kur miratimi nuk është i nevojshëm, të cilat lidhen kryesisht me gjurmuesit e nevojshëm për ofrimin e shërbimit dhe realizimin e komunikimit.[38] Për shkak të përditësimit të akteve kryesore të BE mbi mbrojtjen e të dhënave personale, ka lindur nevoja për përditësimin e kësaj direktive. Ky projekt është në proces dhe pritet shumë shpejt miratimi i Rregullores së Privatësisë Elektronike[39] që do të zëvendësojë direktivën në fjalë.

33 Directive (EU) 2016/680 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data, and repealing Council Framework Decision 2008/977/JHA.

34 European Data Protection Supervisor, Opinion 6/2015, A Further Step Towards Comprehensive EU Data Protection, 28 Tetor 2015, f. 4.

35 Directive 2002/58/EC of the European Parliament and of the Council of 12 July 2002 concerning the processing of personal data and the protection of privacy in the electronic communications sector (Directive on privacy and electronic communications), as amended.

36 Neni 5(3), Direktiva e Privatësisë Elektronike.

37 Shih Neni 4(11), GDPR

38 Ibid.

39 Shih propozimin për Rregulloren: https://eur-lex.europa.eu/legal- content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52017PC0010, aksesuar në datë 26.4.2022

4. Rregullorja 2018/1725

Për shkak të formës së veçantë të organizmit, në BE është miratuar një akt i posaçëm që mbulon mbrojtjen e të dhënave personale të individëve nga veprimtaria e organeve të vet Bashkimit Europian. Për këtë arsye, Rregullorja (EU) 2018/1725[40] përcakton detyrimin e institucioneve të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale duke e përditësuar rregulloren pararendëse[41] me standardet e reja të përfshira në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian

Një rol të veçantë të avancimin e koncepteve të direktivës 94/46/EC për mbrojtjen e të dhënave personale ka luajtur edhe jurisprudenca e GJDBE. Përmes praktikës së saj, gjykata ka qartësuar, avancuar dhe prezantuar të drejta të tjera të subjekteve të të dhënave personale. Për hir të së vërtetës ka një praktikë të pasur të GJDBE mbi mbrojtjen e të dhënave personale, kryesisht në interpretim të dispozitave të direktivës së sipërcituar. Ndërsa për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të Rregullores ka mungesë të praktikës për shkak se është një akt relativisht i ri. Gjithësesi, dy nga rastet më me vlerë për t'u përmendur janë i ashtuquajturi Schrems II dhe Google Spain.[42]

Në rastin e parë, z. Schrems ankohet për transferimin e të dhënave të tij personale, nga Facebook Ireleand (me seli në BE) tek Facebook Inc. (me seli në U.S.A.), pasi shteti në të cilin transferohen këto të dhëna, nuk ofron të njëjtat garanci sikurse dhe Irlanda. Në fakt, kjo është çështja e dytë nga z. Schrems, që ngre të njëjtin shqetësim, por tashmë në kuadrin e Rregullores mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Në rastin e parë[43], GjDBE shfuqizoi vendimin e Komisionit 2000/520/EC të datës 26 korrik 2000 (e njohur si Safe Harbour) pasi nuk ofronte të njëjtin nivel mbrojtjeje sikurse kuadri rregullativ në BE.

Për këtë arsye, u negociua një marrëveshje e re BE-Sh.B.A që u pagëzua me emrin Privacy-Shield, pasi Komisioni vlerësoi legjislacionin e Sh.B.A.-ve.

Në këtë rast, Gjykata vlerëson se "… garancitë e përshtatshme, të drejtat e zbatueshme dhe mjetet ligjore efektive, që kërkojnë këto dispozita, duhet të sigurojnë që subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve transferohen në një vend të tretë, në përputhje me klauzolat standard të mbrojtjes së të dhënave, t'u ofrohet një mbrojtje thelbësisht e njëjtë me atë të garantuar brenda Bashkimit Europian nga kjo rregullore, lexuar nën dritën e Kartës. Për këtë qëllim, vlerësimi i nivelit të mbrojtjes së ofruar në kontekstin e një transferimi të tillë duhet, në veçanti, të marrë në konsideratë si klauzolat kontraktuale të rëna dakord ndërmjet kontrolluesit ose përpunuesit të vendosur në Bashkimin Evropian dhe marrësit të transferimit të vendosur në vendin e tretë në fjalë dhe, në lidhje me çdo akses nga autoritetet publike të një vendi të tretë në të dhënat personale të transferuara, aspektet përkatëse të sistemit ligjor të atij vendi të tretë, veçanërisht ato të përcaktuara, në mënyrë jo shteruese, në Nenin 45(2) të kësaj Rregulloreje.[44]

40 Regulation (EU) 2018/1725 of the European Parliament and of the Council of 23 October 2018 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by the Union institutions, bodies, offices and agencies and on the free movement of such data, and repealing Regulation (EC) No 45/2001 and Decision No 1247/2002/EC (Text with EEA relevance.)

41 Rregullorja (EC) 45/2001

42 Google Spain SL and Google Inc. v Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) and Mario Costeja González, ECLI:EU:C:2014:317.

43 Maximillian Schrems v Data Protection Commissioner, C-362/14,ECLI:EU:C:2015:650

44 Pg. 105, Maximillian Schrems v Data Protection Commissioner, C-362/14,ECLI:EU:C:2015:650

Gjykata ngre shqetësimin se në vendimin e Komisionit, referuar si Privacy Shield, "kjo ndërhyrje mund të lindë si nga aksesi në, dhe përdorimi i të dhënave personale të transferuara nga Bashkimi Europian në Shtetet e Bashkuara nga autoritete publike amerikane…".[45]

Gjykata vlerësoi se "njoftimi/komunikimi i të dhënave personale tek persona të tretë, si p.sh. autoritete publike, përbën ndërhyrje ndaj të drejtave themelore të rregulluara nga Nenet 7 dhe 8 të Kartës, sidoqoftë përdorimi vijues i informacionit të komunikuar."[46]

Në rastin e dytë, gjykata i ka paraprirë Rregullores, pasi ka evoluar edhe më tej të drejtën e subjektit të të dhënave për të fshirë të dhënat e tij. Në fakt, fatkeqësisht, kjo e drejtë e "krijuar" prej gjykatës quhet e "e drejta për t'u harruar" në të cilën gjykata mbajti qëndrimin se".. subjekti i të dhënave, në dritën e të drejtave të tij themelore sipas neneve 7 dhe 8 të Kartës, ka të drejtë të kërkojë që informacioni në fjalë të mos vihet më në dispozicion të publikut të gjerë përmes përfshirjes në një listë të tillë të rezultateve dhe duhet mbajtur qëndrimi, siç vijon në veçanti nga paragrafi 81 i vendimit aktual, se këto të drejta mbizotërojnë, si rregull, jo vetëm mbi interesin ekonomik të operatorit të motorit të kërkimit por edhe mbi interesin e publikut të gjerë për të gjetur atë informacion mbi një kërkim në lidhje me emrin e subjektit të të dhënave."[47]

6. Risitë e Rregullores për Mbrojtjen së Përgjithshme të të Dhënave Personale (GDPR)

Miratimi i Rregullores u pa në Bashkimin Europian si një moment me rëndësi në drejtim të forcimit të regjimit për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht në një periudhë në të cilën zhvillimet teknologjike ekspozojnë ndjeshëm të dhënat tona personale. Pothuaj në çdo shërbim të përfituar, qytetari jep në mënyrë të vazhdueshme të dhëna personale. Akoma më i ndjeshëm është ky ekspozim në raport me veprimtaritë që kryhen në dimensionin elektronik. Ndaj, përzgjedhja e një instrumenti të tillë, Rregullores, synoi që të shmangte fragmentizimin e mbrojtjes për qytetarët e Bashkimit Europian (BE). Qëllim i cili do të përmbushej edhe përmes interpretimit të njëjtë që

Gjykata Europiane e Drejtësisë do i bënte këtij akti.[48] Në këtë mënyrë ofrohet një nivel i lartë i sigurisë juridike mbi mbrojtjen e të dhënave personale kudo në BE.

Në terma të përgjithshëm, Rregullorja ka përforcuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe ka përcaktuar më shumë detyrime për kontrolluesit dhe përpunuesit.[49] Sa i përket të drejtave të individëve, Rregullorja ka njohur të drejta të reja, duke rritur transparencën si dhe duke rritur kontrollin e subjekteve mbi të dhënat e tyre.[50] Ndërsa për kontrolluesit, rregullorja ka përcaktuar më shumë përgjegjësi ndër të tjera, duke ndryshuar regjimin e gjobave, duke përcaktuar detyrimin për njoftimin e subjektit të të dhënave personale, si dhe duke përcaktuar krijimin e oficerit për të dhënat personale.

Duke analizuar të gjitha ndryshimet pozitive që Rregullorja solli në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale, mund të konkludohet se ky kuadër rregullues ka pothuaj të njëjtin vend dhe duhet të vlerësohet

45 Pg. 165, Maximillian Schrems v Data Protection Commissioner, C-362/14,ECLI:EU:C:2015:650
46 Pg. 171, Maximillian Schrems v Data Protection Commissioner, C-362/14, ECLI:EU:C:2015:650
47 Google Spain SL and Google Inc. v Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) and Mario Costeja González, ECLI:EU:C:2014:317, pg. 97.
48 Ch. Kuner, et al, The EU General Data Protection Regulation: A Commentary, Oxford University Press, 2021, f.9.
49 T. Mulder, Health Apps, Their Privacy Policies and the GDPR, European Journal of Law and Technology, Vol 10, no.1, 2019,
50 Communication From the Commission to the Parliament and the Council, Data Protection as a Pillar of Citizens' Empowerment and the EU's Approach to the digital transition- two years of application of the General Data Protection Regulation, SWD(2020)115 final, f.1.

me po aq kujdes nga shoqëritë tregtare (që veprojnë si kontrollues ose përpunues) sikurse edhe normat e së drejtës së konkurrencës. Kjo për shkak të mekanizmit të ri zbatues si dhe të kërkesave të shtuara procedurale për të njoftuar devijimet nga zbatimi i normave si dhe njoftimi i incidenteve lidhur me sigurinë e të dhënave.[51]

6.1. Kuptimi i të Dhënave Personale

Rregullorja ka një qëllim të dyfishtë, pasi njëherësh synon të nxisë qarkullimin e lirë të të dhënave personale brenda BE-së (për të ndihmuar bizneset) si dhe të mbrojë të dhënat personale të shtetasve europianë. [52] Qartazi qëllimi i dytë është mbizotërues, nisur nga formulimi i dispozitës së cituar më lart. Në funksion të realizimit të këtyre qëllimeve Rregullorja identifikon dy kategori të të dhënave personale: të dhëna personale dhe një kategori e veçantë e të dhënave personale (të njohura si të dhëna sensitive). 'E dhëna personale' konsiderohet 'çdo *informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm; një individ i identifikueshëm është individi që mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë*'.[53] Në këtë kontekst, koncepti i të dhënave personale është shumë i gjerë, duke përfshirë çdo të dhënë që mund të identifikojë një individ, përveç emrit dhe mbiemrit të tij. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe të dhënat identifikuese të pseudoanonimizuara, adresat e IP, gjurmuesit e faqeve web, apo të ngjashme.[54] Ndërsa në kategorinë e të dhënave personale sensitive janë përfshirë të dhënat mbi origjinën etnike ose racore, mendimet politike, besimet fetare apo filozofike, anëtarësi sindikale, të dhënat mbi shëndetin, të dhënat mbi jetën seksuale dhe orientimin seksual, të dhënat gjenetike dhe përpunimi biometrik i të dhënave vetëm për qëllim të identifikimit të një individi. Për përpunimin e të dhënave të kategorive të veçanta Rregullorja ka një kujdes të shtuar, pasi ka përcaktuar në mënyrë të pavarur rastet kur lejohet përpunimi i tyre, përkundër regjimit të përgjithshëm të zbatueshëm për të gjitha të dhënat e tjera personale. Rregullorja zbatohet në rastet e përpunimit të të dhënave personale, koncept i cili sërish ka një përkufizim tejet të gjerë, duke përfshirë një sërë procesesh, si mbledhja, ruajtja, shpërndarja, fshirja, arkivimi etj.

6.2. Parimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale

Rregullorja paraqet një përzierje të parimeve dhe rregullimeve të detajuara dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale. Parimet mbi të cilat lejohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale janë: parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës,[55] parimi i qëllimit të përcaktuar,[56] parimi i minimizimit të të dhënave[57], parimi i të dhënave të sakta, dhe kur është e nevojshme të përditësuara,[58] parimi i ruajtjes së kufizuar[59], dhe parimi i integritetit dhe konfidencialitetit.[60]

51 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
52 Neni 1, GDPR
53 Neni 4(1), GDPR
54 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
55 Neni 5(1)(a), GDPR
56 Neni 5(1)(b), GDPR. Shih gjithashtu edhe nenin 89(1).
57 Neni 5(1)(c), GDPR.
58 Neni 5 (1)(d), GDPR
59 Neni 5(1)(e), GDPR.
60 Neni 5(1)(f), GDPR

6.3. Kushtet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale

Rregullorja ka përcaktuar gjashtë shkaqe të ligjshme për përpunimin e të dhënave personale: (1) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave për një ose disa qëllime, (2) përpunimi është i nevojshëm për realizimin e një kontrate në të cilën subjekti është palë, ose për të marrë masat e nevojshme para lidhjes së kontratës, (3) përpunimi është pjesë e detyrimeve ligjore për kontrolluesin, (4) përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetësore të subjektit të të dhënave personale ose të një individi tjetër, (5) përpunimi është i nevojshëm për realizimin e një detyre në interes publik ose ushtrimin e një pushteti që i është dhënë kontrolluesit, (6) përpunimi është i nevojshëm për qëllime të interesave të ligjshme të kontrolluesit ose të një pale të tretë.[61]

6.4. Të drejtat e subjekteve

Në raport me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, Rregullorja ka shfrytëzuar të drejtat e origjinuara nga direktiva, por të sjella në një version të përforcuar tashmë, duke i përcaktuar në mënyrë më të detajuar si dhe duke njohur të drejta shtesë.

Ndaj, rregullorja ka afirmuar edhe njëherë të drejtën për akses në të dhënat personale e cila buron nga Karta Europiane e të Drejtave Themelore.[62] Por, përveç njohjes së të drejtës për të patur akses në të dhënat personale, Rregullorja parashikon edhe të drejtën e subjektit të të dhënave për të marrë konfirmimin nga kontrolluesi nëse të dhënat po përpunohen, për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave që i nënshtrohen këtyre proceseve, subjekteve tek të cilët këto të dhëna mund të përhapen, periudhën për të cilën këto të dhëna do të ruhen, të drejtën për të marrë një kopje të të dhënave të tij/saj personale, etj.[63]

Të drejtat e parashikuara në Rregullore janë pasuruar përmes njohjes së një kontrolli më të madh mbi të dhënat personale për subjektet e të dhënave, pasi ata mund të shfrytëzojnë transferueshmërinë (portabilitetin) e të dhënave të tij tek një tjetër kontrollues, sipas zgjedhjes dhe vlerësimit të tij.[64]

Një tjetër, risi e Rregullores lidhet me njohjen e së drejtës së subjektit të të dhënave për fshirjen e të dhënave të tij apo siç është konsoliduar edhe nga praktika e GjDBE, e drejta për t'u harruar, në raste të caktuara si për shembull kur të dhënat nuk janë më të rëndësishme për qëllimin për të cilin ato u mblodhën, ose kur subjekti tërheq pëlqimin mbi përpunimin e të dhënave të tij, kur të dhënat janë përpunuar në mënyrë të paligjshme, etj.[65]

6.5. Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve

Detyrimet që rëndojnë mbi kontrolluesin dhe përpunuesin janë qartësuar nga Rregullorja duke marrë në konsideratë problematikat që kishin lindur nga zbatimi në praktikë i Direktivës. Së pari, kontrolluesi është i detyruar të zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar dhe për të qenë i aftë të provojë se përpunimi i të dhënave personale është realizuar në përputhje me kërkesat e Rregullores. Këto masa duhet të rishihen dhe përditësohen sa herë është e nevojshme.[66] Pra, barra e provës për të provuar

61 Neni 6(1), GDPR.
62 Neni 8(2), Karta Europiane e të Drejtave Themelore.
63 Neni 15(1), GDPR.
64 Neni 20, GDPR.
65 Neni 17, GDPR.
66 Neni 24, GDPR.

para autoriteteve përputhshmërinë e veprimtarisë së tij me kërkesat e rregullores bie mbi kontrolluesin.

Rregullorja ka plotësuar kuadrin e detyrimeve për kontrolluesin dhe përpunuesin me detyrimin për hartimin dhe zbatimin e politikave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale[67], detyrimin për transparencë ndaj subjekteve të të dhënave personale,[68] detyrimin për të integruar në projektimin teknik të masave për përpunimin e të dhënave personale, "privatësinë me projektim" (privacy by design) dhe "privatësinë e paracaktuar" (privacy by default),[69] detyrimin për mbajtjen e rekordeve të sakta, të ngjashme me pasqyrat financiare, lidhur me veprimtarinë përpunuese të të dhënave personale,[70] krijimi i strukturave të posaçme brenda kontrolluesit që të mbulojë të dhënat personale, Oficeri i të Dhënave Personale (ODP). Këtë detyrim e kanë kryesisht autoritetet publike ose kontrolluesit të cilët kanë pjesë të veprimtarisë së tyre kryesore përpunimin e të dhënave personale[71],etj.

B. Kuadri Rregullator në Këshillin e Europës (KiE)

1. Konventa për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale

Nga ana tjetër edhe KiE ka patur një vëmendje të shtuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Përveç parashikimit në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut[72], mbrojtja e të dhënave personale është përforcuar edhe përmes akteve të tjera të cilat kanë si objekt kryesor mbrojtjen e të dhënave personale. Këtu mund të përmendim, Konventën për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (e Njohur edhe si Konventa 108),[73] së bashku me protokollet e saj. Konventa përbënte një akt me rëndësi për dy arsye: së pari, sepse pati një shtrirje shumë të gjerë (ishte e hapur për nënshkrim nga shtete anëtare ose jo të Këshillit të Europës) duke synuar kështu krijimin e një standardi me bazë sa më të gjerë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe së dyti, pasi ishte akti i parë ndërkombëtar që synonte të mbronte individët nga abuzimi përmes përpunimit të të dhënave të tyre personale si dhe të krijonte një regjim për transferimin e këtyre të dhënave. Konventa 108 zbatohet për të gjitha përpunimet e të dhënave personale, që kryhen si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik, si për shembull përpunimet që kryejnë autoritetet gjyqësore dhe ato të policisë si nga sektori publik ashtu edhe ai privat. Në të njëjtën linjë me parashikimin e Rregullores, Konventa 108 ka gjithashtu një qëllim të dyfishtë: a) mbrojtjen e të dhënave personale nga përpunimi i paligjshëm si dhe b) qarkullimin ndërkufitar të të dhënave personale. Për shkak të zhvillimit të ndjeshëm teknologjik Konventa është modernizuar dhe një protokoll i ri i përgjigjet nevojave për t'iu përshtatur zhvillimit teknologjik (e njohur edhe si Konventa 108+).[74] Duke qenë se Konventa bën një rregullim në nivel parimesh, Komiteti i Ministrave ka miratuar rekomandime me funksion detajimin e parimeve konventore.

67 Neni 24(2), GDPR
68 Neni 12, GDPR.
69 Neni 25, GDPR.
70 Neni 30, GDPR
71 Nenet 37-39, GDPR.
72 Neni 8, i KEDNj (https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=basictexts&c)
73 Konventa për Mbrojtjen e Personave Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, Këshilli i Evropës, STCE nr. 108, 1981. https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=108
74 Amending protocol to the Convention for the Protection of Individuals with Regard to the Processing of Personal Data, adopted by the Committee of Ministers at its 128th Session in Elsinore on 18 May 2018.

2. Praktika e GjEDNj për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Përpos Konventës një rol me rëndësi në konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale, ka luajtur edhe praktika e konsiderueshme e GjEDNj. Veçanërisht i ndjeshëm ka qenë roli i GjEDNj në balancimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave të tjera si për shembull liria e shprehjes.

Një nga çështjet që ka qenë objekt shqyrtimi në të dyja gjykatat (GjDBE dhe GjEDNj) është Satakunnan Markkinapörssi Oy And Satamedia Oy V. Finland në të cilën, GjDBE nuk u shpreh nëse veprimtaria e gazetarëve në fjalë (përpunimi i të dhënave me origjinë publike dhe krijimi i një database elektronike që mund të aksesohej përmes mesazheve telefonike) do të çmohej nga gjykatat vendase nëse përbënte thjesht aktivitet gazetaresk apo jo.[75] Ndërsa, GjEDNj vlerësoi se kufizimi që i bënë gjykatat vendase kësaj veprimtarie (pas vendimmarrjes së GjDBE gjykatat vendase çmuan se kjo veprimtari përbënte cënim të të dhënave personale) ishte shprehje e balancës që vetë shteti brenda margjinave të lejuara kishte përcaktuar mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Rrjedhimisht, nuk përbënte shkelje të lirisë së shprehjes.[76]

75 C-73/07, Tietosuojavaltuutettu kundër Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy, 16 dhjetor 2008, parag. 56, 61 dhe 62

76 Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy V. Finland, Nr. Aplikimi nr. 931/13, pg. 198 dhe 199

KREU II

A. Legjislacioni Shqiptar mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në Shqipëri mbrojtja e të dhënave personale, ka gjithashtu një origjinë kushtetuese, madje është e drejtë autonome. Neni 35 i Kushtetutës jo vetëm njeh të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, por njëherësh garanton edhe disa nga të drejtat themelore të subjektit të të dhënave personale. Më konkretisht, neni 35 përcakton të drejtën e subjektit për të lejuar mbledhjen e të dhënave vetëm përmes pëlqimit të dhënë prej tij, të drejtën për t'u njohur me të dhënat që janë mbledhur për të, të drejtën për të kërkuar ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.[77]

Përveç kornizës kushtetuese, mbrojtja e të dhënave personale është plotësuar përmes ratifikimit të Konventës 108 dhe protokolleve ndryshuese të saj.[78] Aktualisht, është nënshkruar (në datë 28 janar 2022 nga Shqipëria) edhe protokolli ndryshues i konventës 108, i njohur si Konventa e Modernizuar 108+[79] i cili, së fundi, është ratifikuar në Parlament.[80]

1. Ligji "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nevoja për përafrim

Aktet e përmendur më sipër bëjnë një rregullim me qasje parimore, ndaj për të rregulluar teknikalitetet dhe modalitetet e nevojshme kjo kornizë është plotësuar nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen e të dhënave personale, përmes miratimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Ky ligj, është miratuar në kohën që në Bashkimin Europian ka qenë në fuqi Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 94/46/EC, ndaj ligji është hartuar nën modelin e Direktivës. Qartazi, për shkak të miratimit të një regjimi tërësisht të ri në Bashkimin Europian për mbrojtjen e të dhënave personale, ky ligj nuk është i përafruar me Rregulloren e Mbrojtjes së Përgjithshme të të Dhënave Personale.

Në vijim, do të analizohet në mënyrë më të detajuar nevoja për përafrim, duke i vlerësuar këto akte në një perspektivë krahasuese lidhur me përputhshmërinë e ligjit me standardin e ri të vendosur nga Rregullorja. Nevoja për përafrim vjen në fakt, jo vetëm si përgjigje ndaj rrjedhjeve masive të të dhënave të kohëve të fundit, por edhe si një kërkesë e përsëritur nga Bashkimi Europian për të harmonizuar këtë pjesë të legjislacionit. Në Progres Raportin për Shqipërinë 2020, theksohet se duhet përafruar legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680.[81] Në raportin e vitit 2021, vlerësohen përpjekjet për realizimin e përafrimit me legjislacionin Europian në këtë drejtim nisur edhe nga përvoja e rrjedhjes së të dhënave personale me karakter sensitiv që përfshinin preferencat politike të individëve, ndaj në këtë drejtim kërkohet përditësimi i nivelit të sigurisë dhe kufizimi

77 Neni 35, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: *"Askush nuk mund të detyrohet, përveç se kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. 4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligji"*

78 Ligj Nr.9288, date 7.10.2004, indryshuar

79 https://www.idp.al/2022/01/28/28-janar-dita-e-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale-2/.

80 Ligj Nr. 49/2022 "Për Ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje mepërpunimin automatik të të dhënave personale".

81 Commission Staff Working Document, SWD(2020) 354 final, Albania 2020 Report, 6.10.2020, f. 30

i aksesit dhe përdorimi i të dhënave personale të ruajtura në databazat shtetërore.[82]

Nevoja për përafrimin e legjislacionit, lind edhe për shkak të një standardi thuajse global që vendos Rregullorja në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Ky standard është i nevojshëm në kuadër të transferimit të të dhënave personale si nevojë për zhvillimin ekonomik, gjithashtu edhe në kuadër të parimit të ekstraterritorialitetit që i jep Rregullores efekt edhe përtej kufijve gjeografikë të BE-së nëse të dhënat e individëve brenda Bashkimit përpunohen nga kontrollues me seli jashtë BE-së. Ndaj, në këtë aspekt, për njohjen e detyrimeve përkatëse nga kontrolluesit është e nevojshme që të krijohet një kuadër ligjor i ngjashëm dhe që vjen në të njëjtën linjë me detyrimet që përcakton Rregullorja.

2. Akte të tjera me rëndësi në Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Përpos ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", edhe ligje të tjera kanë si objekt të tyre mbrojtjen e të dhënave personale, ndonëse në një fushë më specifike veprimtarie. Këtu mund të përmendim, ligjin "Për komunikimet elektronike"[83], në të cilin, mes të tjerash, përcaktohen edhe rregullat për ruajtjen e konfidencialitetit në komunikimet elektronike. Me fjalë të tjera këto rregulla zbatohen për gjithë informacionin që japin përdoruesit e rrjeteve të komunikimit publik, për ta mbrojtur nga gjurmuesit (cookies) ose edhe për viruset të cilët përbëjnë një mënyrë për cënimin e sferës private të përdoruesve të këtyre komunikimeve. Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, në neni 123(6) [84] në të cilin përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave personale të përdoruesve, nuk është plotësisht i harmonizuar me Direktivën e Privacy. Kjo pasi, fusha e zbatimit të nenit 5(3) të Direktivës së mësipërme është më e gjerë dhe i referohet edhe mënyrave të tjera të aksesit në të dhënat personale të përdoruesve (edhe mjeteve të jashtme përmes të cilave ruhet informacioni si CD, CD-ROM, USB etj)[85], përveç përdorimit të rrjeteve të komunikimit elektronik. Përpunimi i të dhënave, sipas përcaktimit të nenit në fjalë, lejohet, kur përdoruesi ose pajtimtari ka dhënë pëlqimin, pasi është i informuar qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme për qëllimin e përpunimit. Sa i përket mënyrës së marrjes së pëlqimit referencë bëhet në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Pavarësisht, mungesës së harmonizimit, çfarë konstatohet në praktikë, edhe në gjendjen aktuale, vërehet një mungesë e theksuar e zbatimit të kësaj dispozite.

Për bazat e të dhënave shtetërore ka një rregullim të posaçëm[86], por ky ligj nuk ka asnjë rregullim konkret për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrjedhimisht referencë për të gjitha aspektet lidhur me përpunimin e këtyre të dhënave do të bëhet në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Kjo do të thotë, që të njëjtat standarde dhe kritere ligjore të LMDP do të shërbejnë për të mbrojtur individët nga veprimet e paligjshme në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale nga autoritetet publike.

Madje, edhe VKM nr. 1147, datë 9.12.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'Portali Unik Qeveritar E-Albania' dhe për miratimin e rregullave 'Për mënyrën e funksionimit të Pikës së vetme të Kontaktit'" në të cilin administrohen një gamë e gjerë e të dhënave personale me karakter të përgjithshëm si dhe sensitive, përcakton shkurtimisht vetëm detyrimin për kontrolluesit, që të dokumentojnë masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale,

82 Commission Staff Working Document Albania 2021 Report, SWD(2021) 289 final 2021, f 27, 28
83 Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike", i ndryshuar
84 Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike", i ndryshuar
85 E. Kosta, Peeking into the Cookie Jar: the European Approach Towards the Regulation of Cookies, International Journal of Law and Information Technology (2013) 21(4), f. 380-406.
86 Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave Shtetërore".

përpos detyrimeve të përgjithshme që burojnë nga ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale".[87] Kjo VKM duhet të kishte trajtuar me kujdes dhe me vëmendje të shtuar aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale nga Portali Unik Qeveritar duke qenë edhe portali në të cilin të gjithë shtetasin detyrohen që të japin të dhëna personale.

3. Pajtueshmëria e Ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" me Standardin e Rregullores.

Ligji "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" është miratuar në 2008 dhe është ndryshuar dy herë, përmes ligjit nr. 48/2012 dhe ligjit 120/2014 (referuar në vijim edhe si LMDP). LMDP ka në fokus dy subjekte kryesore: subjektin e të dhënave personale dhe kontrolluesit (dhe përpunuesit). Qëllimi i normave të përfshira në të synon mbrojtjen e të drejtave të subjekteve nga përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale si dhe lejimin, brenda kushteve të përcaktuara, i përpunimit të tyre. Ligji ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale[88]. Në vija të përgjithshme, ligji përcakton rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale, kriteret për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, transferimin e të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve, Komisionerin, duke përcaktuar edhe kompetencat e tij si dhe pjesën e sanksioneve që zbatohet në rast mospërmbushje të detyrimeve ligjore. Përpos ligjit, një instrument i rëndësishëm në plotësimin e kuadrit për mbrojtjen e të dhënave kanë dhënë edhe udhëzimet e nxjerra nga Komisioneri, i cili në përputhje me kompetencat e dhëna nga ligji, ka konkretizuar përmes udhëzimeve rregullat për sektorë specifikë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Midis të cilëve duhet të veçohen: Udhëzimi nr. 47 "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha", Udhëzimi nr. 31 "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike", Udhëzimi nr. 49 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Shëndetësore" etj. Por, konstatohet se mungon një udhëzim për qasjen e subjekteve zgjedhore ndaj të dhënave personale.[89] Duke marrë shkas edhe nga rrjedhja masive e të dhënave gjatë fushatës zgjedhore, do të ishte me vend që Komisioneri përmes një udhëzimi të përcaktonte qartë të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në këtë proces. Ky udhëzim shihet me rëndësi themelore pasi të dhënat personale në kontekstin elektoral kanë një ndjeshmëri të shtuar jo vetëm për individët, por për funksionimin tërësor të demokracisë. Kjo veçanërisht për të rikthyer besimin e publikut tek proceset demokratike.[90]

Në vijim, analiza e përputhshmërisë së LMDP me Rregulloren do të realizohet duke u ndalur në disa nga aspektet kryesore siç janë: fusha e zbatimit, të drejtat e subjekteve, detyrimet e kontrolluesve dhe zbatimi i dispozitave të ligjit.

3.1. Fusha e zbatimit

Sa i përket fushës së zbatimit lëndor, ligji ka përcaktuar se normat synojnë përpunimin e të dhënave personale, plotësisht apo pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike, si dhe përpunimin me mjete të tjera të

87 Neni 24, VKM nr. 1147, datë 9.12.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'Portali Unik Qeveritar E-Albania' dhe për miratimin e rregullave 'Për mënyrën e funksionimit të Pikës së vetme të Kontaktit'.

88 Neni 1, LMDP

89 Përveç një shembull zbatimi sipas Udhëzimit 35.

90 Commission Guidance on the Application of Union Data Protection Law in the Electoral Context. Instrument i cili nxit së tepërmi nga skandali i përpunimit të paligjshëm të të dhënave nga Cambrdige Analytica, e cila krijoi micro-targeting.

të dhënave personale, që mbahen në një sistem arkivimi apo kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit.[91] Në përcaktimin e kuptimit të të dhënave personale, ligji, duke ndjekur modelin e direktivës, ka një përkufizim më të cunguar. Për këtë arsye, duke qenë se Rregullorja ka sjellë zgjerimin e kategorive të të dhënave personale, veçanërisht atyre sensitive, është me vend që edhe ligji ynë të reflektojë këtë ndryshim. Kështu Rregullorja shton në përkufizimin e të dhënave personale edhe të dhëna që lidhen me veprimtarinë elektronike si të dhënat e vendndodhjes ose një identifikues online si dhe zgjeron kategorinë e të dhënave të veçanta (të njohura si të dhëna sensitive) duke përfshirë të dhënat biometrike apo gjenetike për qëllim të identifikuar në mënyrë unike një individ si dhe të dhënat lidhur me orientimin seksual të individëve.[92]

Lidhur me zbatimin territorial, ligji përcakton se përveçse zbatohet për kontrollues të vendosur në Shqipëri, misionet konsullore apo diplomatike të Shtetit shqiptar, zbatohet edhe për kontrollues që nuk janë të vendosur në Shqipëri, por e ushtrojnë veprimtarinë përmes mjeteve të vendosura në Shqipëri.[93] Nga mënyra se si është formuluar kjo dispozitë nuk duket se është e harmonizuar me Rregulloren, ndaj nisur nga standardi i krijuar nga Rregullorja është e rëndësishme që të përcaktohet edhe zbatimi i ligjit në fjalë, për veprimtari që realizohen jashtë territorit të shtetit shqiptar, por që lidhen me përpunimin e të dhënave të individëve brenda Shqipërisë. Për shembull, sipas Rregullores kontrolluesit që gjurmojnë faqet web të vizituara nga individët në Bashkimin Europian, do të jenë subjekt i Rregullores, pavarësisht nëse nuk kanë seli brenda Bashkimit.

Në këtë aspekt, ligji duhet të ndjekë modelin e Rregullores dhe të ofrojë mbrojtje më të plotë për të drejtat e subjekteve të të dhënave personale. Sipas standardit të Rregullores, shtrirja e efektit të ligjit ndaj kontrolluesve ose përpunuesve që nuk janë të vendosur në Shqipëri, duhet të lejohet në dy rrethana: a) kur veprimtaria përpunuese lidhet me ofrimin e mallrave ose shërbimeve, (me ose pa kundërshpërblim) tek subjektet e të dhënave në Shqipëri dhe b) kur monitorohet sjellja e personave brenda territorit të Shqipërisë.[94]

Për këtë arsye rekomandohet, që sa i përket fushës së zbatimit lëndor dhe territorial, ligji të përditësohet sipas përcaktimeve të Rregullores, për të mbrojtur më mirë të drejtat e subjekteve të të dhënave, duke sjellë një përkufizim më të gjerë të të dhënave personale, si dhe duke shtrirë efektin për kontrollues edhe përtej territorit të Republikës së Shqipërisë për veprimtari të cilat dëmtojnë interesat e individëve që veprojnë brenda territorit shqiptar.

3.2. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave sipas ligjit tonë për mbrojtjen e të dhënave personale, bëhet në raste të mirëpërcaktuara sipas nenit 6 të LMDP. Baza ligjore që lejon përpunimin e të dhënave, njeh si shkaqe: 1. Pëlqimi i subjektit të të dhënave, 2. Kur përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, 3. Për mbrojtjen e interesit jetik të subjektit të të dhënave, 4. Për përmbushjen e një detyrimi ligjor për kontrolluesit, 5. Për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik të kontrolluesit, 6. Kur interesi i kontrolluesit prevalon ndaj interesit të subjektit të të dhënave.[95]

Në Rregullore përcaktohen të njëjtat shkaqe të cilat legjitimojnë përpunimin e të dhënave personale,

91 Neni 4(1), LMDP
92 Neni 4(1) dhe neni 9(1), GDPR.
93 Neni 4(2), LMDP
94 Cf. neni 3, GDPR.
95 Neni 6(1), LMDP

por janë përcaktuar kërkesa të reja substanciale dhe procedurale lidhur me disa nga shkaqet e përmendura më sipër, të cilat nuk gjejnë reflektim në ligjin tonë.

Së pari, mbi pëlqimin, për të gjitha kategoritë e të dhënave personale, LMDP nuk ka kërkesa specifike mbi kriteret që duhet të përmbushë miratimi/pëlqimi që të konsiderohet i vlefshëm, përveç përkufizimit të pëlqimit dhe nevojës për ta paraqitur si një deklaratë me shkrim, dhe informimit të subjektit mbi nevojën e përpunimit[96]. Në këtë drejtim Rregulloja ka përcaktuar disa nga kushtet për pëlqim të vlefshëm siç janë: revokueshmëria[97], duhet të jepet lirisht, specifik, i informuar dhe i qartë.[98]

Kriteret e përcaktuara më sipër janë të rëndësishme në funksion të garantimit të të drejtave të subjekteve pasi, dhënia lirisht e pëlqimit përjashton mundësinë e pranimit të detyrueshëm të gjurmuesve ose refuzimin e shërbimit (opsionin take-it-or-leave-it [prano ose refuzo] për gjurmuesit online). Po ashtu, nevoja e subjektit për të dhënë një pëlqim të informuar dhe specifik, ndalon përdorimin e kërkesave për pëlqim që janë të paqarta dhe nuk tregojnë drejtpërdrejt qëllimin e përpunimit. Për shembull kërkesa për përpunimin e të dhënave "për qëllime tregtare" nuk është e mjaftueshme dhe nuk plotëson, sipas kuptimit të Rregullores kushtet për vlefshmërinë e pëlqimit.[99]

Përpos këtyre kushteve për vlefshmërinë e pëlqimit, Rregullorja përcakton kufizime të tjera për mbrojtjen e fëmijëve në kontekstin e shërbimeve online, të cilët duhet të jenë së paku 16 vjeç. Për më tepër, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, ka marrë një vëmendje të shtuar në Rregullore, pasi në mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve, mund të prevalojë edhe mbi interesin e ligjshëm të kontrolluesit[100].

Në frymën e këtyre risive, LMDP për t'u përafruar me Rregulloren duhet të përcaktojë kushtet për vlefshmërinë e pëlqimit si dhe të forcojë mbrojtjen e të dhënave personale të të miturve.

Një nga rastet e tjera të lejimit të përpunimit të të dhënave lidhet me interesin e ligjshëm të kontrolluesit. Megjithatë, ky lejim duhet të balancohet me interesin e subjektit të të dhënave personale. Në fakt, edhe LMDP ka një parashikim të tillë dhe kërkon balancimin e interesit të kontrolluesit me të drejtat themelore të subjektit të të dhënave. Por, ky parashikim është i pamjaftueshëm për të kufizuar abuzimet eventuale nga ana e kontrolluesve. Për këtë arsye, duke ndjekur të njëjtën linjë me Rregulloren, duhet të përcaktohen kërkesa të tjera mbi këtë shkak. Si për shembull, njoftimi në mënyrë eksplicite nga ana e kontrolluesit të interesit të ligjshëm si dhe mbrojtja e të drejtave të të miturve.[101]

3.3. Të drejtat e subjekteve të të dhënave

Në thelb, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të njohura nga LMDP janë pak a shumë të njëjta me regjimin e të drejtave që përcakton Rregullorja. Megjithatë, kjo e fundit zhvilloi më tej disa të drejta dhe prezantoi disa të tjera, rruga për të cilën ishte hapur nga jurisprudenca e GjDBE.

Kështu, LMDP përcakton, duke u bazuar në disa nga të drejtat që vetë Kushtetuta i njeh subjektit të të

96 Neni 3 (24), LMDP
97 Neni 7(3), GDPR. Sipas rregullores revokimi i pëlqimit duhet të jetë po aq i lehtë sa edhe dhënia e tij.
98 Neni 4(11), GDPR.
99 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
100 Neni 6(1), (f), GDPR, dhe neni 8 GDPR.
101 Neni 13(1)(d) dhe neni 6(1)(f), GDPR.

dhënave personale, se ky i fundit ka të drejtë për akses[102], të drejtën, për bllokim, korrigjim dhe fshirje,[103] e drejta për të kundërshtuar[104], e drejta për të kërkuar ndërhyrje njerëzore në vendimmarrjen automatike[105], si dhe e drejta për t'u ankuar.[106]

Rregullorja, jo vetëm njeh dhe afirmon këto të drejta, por i zhvillon edhe më tej së pari, duke i detajuar për të krijuar më shumë garanci për subjektet e të dhënave, si dhe duke prezantuar disa të drejta të tjera për t'i dhënë subjektit të të dhënave më shumë kontroll, siç janë e drejta për "t'u harruar" [107] si dhe mundësia për të shfrytëzuar portabilitetin e të dhënave[108]. Gjithashtu, Rregullorja ka detajuar ndjeshëm të drejtën e subjektit të të dhënave për t'u informuar në një gjuhë të qartë, te thjeshtë, në mënyrë koncize dhe transparente mbi kontrolluesin, identitetin ose kontaktet e tij, mënyrën e kontaktit të oficerit të të dhënave personale, qëllimin e përpunimit të të dhënave etj.[109] **Për t'u përafruar me Rregulloren, LMDP duhet të zgjerojë dhe detajojë të drejtat e subjekteve në frymën e Rregullores, duke parashikuar edhe të drejtën për "t'u harruar" apo portabilitetin e të dhënave.**

3.4. Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve

Një nga shtyllat mbi të cilat ligji mbështet mbrojtjen e të dhënave personale lidhet me përcaktimin e një kuadri detyrimesh për kontrolluesit dhe përpunuesit. Paketa e detyrimeve që kontrolluesit kanë sipas LMDP përfshin: detyrimin për informim,[110] detyrimin për korrigjim ose fshirje,[111] detyrimin për të njoftuar Komisionerin në rastin e përpunimit të të dhënave personale[112], si dhe së fundi një nga detyrimet më të rëndësishme lidhet me marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale[113] dhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave.[114] Këto detyrime mundësojnë mbrojtjen e të dhënave personale, por nuk garantojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme. Rrjedhje t ë të dhënave edhe me natyrë sensitive, diktojnë nevojën për shtim të përgjegjësive dhe detyrimeve për kontrolluesin.

Në fakt, Rregullorja i ka paraprirë kësaj nevoje pasi jo vetëm që ka afirmuar të njëjtat detyrime për kontrolluesin, por e ka zgjeruar gamën e detyrimeve të tij dhe duke zhvendosur rolin mbikëqyrës të autoriteteve shtetërore (kupto autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale) tek vet kontrolluesi.

3.4.1. Paketa e Detyrimeve për Kontrolluesit në Raport me Standardin e Rregullores

Një nga risitë e Rregullores në drejtim të shtimit të detyrimeve ndaj kontrolluesve lidhet me parashikimin e detyrimit të kontrolluesve për përgjegjshmëri (accountability principle). Sipas këtij detyrimi, barra e provës për të provuar respektimin e standardeve të Rregullores bie mbi kontrolluesit. Ky i fundit, jo vetëm duhet

102 Neni 12, LMDP
103 Neni 12, LMDP
104 Neni 15, LMDP
105 Neni 14, LMDP
106 Nenet 16 dhe 17, LMDP
107 Neni 17, GDPR.
108 Neni 20, GDPR.
109 Neni 13(1), GDPR
110 Neni 18, LMDP
111 Neni 19, LMDP
112 Neni 21, LMDP
113 Neni 27, LMDP
114 Neni 28, LMDP

të zbatojë kërkesat e Rregullores, por edhe të jetë i aftë të tregojë që i ka përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga Rregullorja. Ligji ynë, qartësisht njeh detyrimin e kontrolluesve për zbatimin e kërkesave të tij në përpunimet automatike ose me mjete të tjera,[115] por në asnjë rast nuk kërkon shprehimisht që kontrolluesi të tregojë e provojë respektimin e kërkesave të ligjit, përveç rasteve kur Komisioneri ose edhe gjykata mund ta kërkojnë diçka të tillë. Sipas Rregullores, kontrolluesit janë të detyruar të provojnë përputhshmëri, ndër të tjera, edhe mbi: a) marrjen e miratimit (kur kërkohet), sipas Nenit 7(1), b) refuzimin e kërkesës së subjektit të të dhënave për ushtrimin e së drejtës për akses ose korrigjimin e të dhënave (neni 11(2) dhe neni 12(5)), c) mosrespektimi i së drejtës së subjektit të të dhënave për kundërshtimin e përpunimit (neni 21(1)), d) ofrimin e garancive dhe marrjen e masave teknike dhe organizative për sigurinë e përpunimit të të dhënave.[116]

Ndaj, në këtë drejtim është e nevojshme që edhe ligji të ndjekë të njëjtin regjim sa i përket njohjes së detyrimit për kontrolluesit për të qenë të përgjegjshëm dhe për të ngarkuar mbi ta barrën e provës për përputhshmërinë me të gjitha kërkesat e ligjit, dhe jo vetëm detyrimi për të dokumentuar masat tekniko-organizative sipas nenit 27(2/1) të LMDP.

Në këtë kontekst, Rregullorja ka përcaktuar detyrimin e kontrolluesve për të dokumentuar në mënyrë të qartë të gjithë veprimtarinë përpunuese. Në fakt, aktualisht, LMDP kërkon që paraprakisht veprimtaritë përpunuese të njoftohen tek Komisioneri. Megjithatë, kjo qasje nuk e përmbush qëllimin për të cilin është parashikuar, pasi nën mbikëqyrjen e Komisionerit janë një numër i madh kontrolluesish ndaj dhe kompetenca për të shqyrtuar të gjitha njoftimet e paraqitura mund të duket jorealiste.[117] Kjo ishte arsyeja që Rregullorja ndryshoi qasje në këtë drejtim, duke e evituar procedurën e njoftimit, dhe duke ngarkuar kontrolluesit që të mbajnë të dhëna të ngjashme me pasqyrat financiare për të gjitha veprimtaritë përpunuese.[118]

Një tjetër, detyrim i shtuar prej Rregullores[119], që nuk gjen pasqyrim në kuadrin rregullues aktual, lidhet me detyrimin e rregulluesit për të hartuar politikat për mbrojtjen e të dhënave personale, detyrim që synon që kontrolluesi ta ketë të qartë politikën që do ndjekë në raport me të dhënat personale që mbledh. Aktualisht, në ligjin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale, mungon një detyrim i kontrolluesve për hartimin e politikave të privatësisë.

Një nga risitë që solli Rregullorja në drejtim të detyrimeve të kontrolluesve ishte detyrimi për të inkorporuar mbrojtjen në projektimin teknik të shërbimeve përmes mbrojtjes së të dhënave "me projektim" dhe "mbrojtjes së paracaktuar".[120] Sipas këtyre detyrimeve, kontrolluesit duhet që të përshtatin infrastrukturën teknologjike duke ofruar opsionet që garantojnë mbrojtjen maksimale të të dhënave personale. Të dyja qasjet synojnë që të minimizojnë ekspozimin e të dhënave personale të subjekteve. Në termat e Rregullores, ky është një detyrim i cili bie mbi kontrolluesin. Aktualisht, edhe një detyrim i tillë nuk ka gjetur reflektim në LMDP.

Megjithatë, ndoshta një nga detyrimet më të mëdha që do të duhet të ndryshojnë tërësisht qasjen e kontrolluesve nga procesit të mbrojtjes së të dhënave personale, lidhet me krijimin e Oficerit të të

115 Neni 5(2), LMDP.
116 Douwe Korff and Marie Georges, The DPO Handbook Guidance for data protection officers in the public and quasi-public sectors on how to ensure compliance with the European Union General Data Protection Regulation, korrik 2019, f113-114.
117 Nenet 21-25, LMDP
118 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
119 Neni 24(2), GDPR.
120 Neni 25(1), GDPR.

Dhënave Personale (ODP).[121] Në fakt, autoritetet shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk mund ta realizojnë plotësisht qëllimin e tyre, veçanërisht në kushtet e veprimtarive përpunuese të të dhënave personale gjithmonë e në zgjerim. Për këtë arsye, zgjidhja që Rregullorja i dha këtij problemi ishte përmes krijimit të një strukture të re, plotësisht të pavarur me funksionin e mbikëqyrjes së veprimtarisë përpunuese të kontrolluesit/përpunuesit në mënyrë që kjo veprimtari të realizohet në pajtim me kërkesat e kuadrit rregullues në fuqi, i.e. Rregullores. Thënë ndryshe, ODP do të jenë sytë dhe veshët e Autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale, mbi kontrolluesit/përpunuesit. Roli i ODP është më rëndësi për ushtrimin e një kontrolli të brendshëm mbi pajtueshmërinë me kërkesat e ligjit përkundër kontrollit të jashtëm që ushtron autoriteti kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale. Tashmë, autoriteti ka një kontakt të drejtpërdrejtë të njohur që përfaqëson kontrolluesin në raport me mbrojtjen e të dhënave personale dhe një instrument ndihmës në funksion të kontrollit të zbatimit të normave ligjore[122]. Në të njëjtën kohë, ODP do të shërbejë edhe si monitorues i vlerësimit të ndikimit të të dhënave personale dhe të mbikëqyrë performancën e tij.[123]

Në këtë drejtim, është e nevojshme që edhe legjislacioni ynë mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përcaktojë një strukturë të tillë tek kontrolluesit për të arritur në një nivel më të lartë zbatimi të normave për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky detyrim i ri për kontrolluesin do të kërkojë staf të trajnuar mbi ligjin si dhe hartimin e manualeve në ndihmë të ODP-ve.

Një tjetër detyrim i përcaktuar në Rregullore, lidhet me hartimin e Vlerësimit të Ndikimit për Mbrojtjen e të Dhënave në rast të përpunimit të të dhënave, që mbartin rrezik të lartë në lidhje me të drejtat dhe liritë e individëve. Hartimi i vlerësimit të ndikimit kërkohet veçanërisht sipas Rregullores në rast të: a) vlerësimit sistemik dhe të zgjeruar të aspekteve personale që bazohet në përpunimin e automatizuar apo profilizimin që çon në vendimmarrje që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme individët ose që prodhojnë pasoja ligjore për ta; b) përpunimi në masë të madhe i të dhënave personale të kategorive të veçanta (të dhënat sensitive); c) monitorimi sistematik i një zone të aksesueshme publikisht, në masë të madhe.[124] Vlerësimi i ndikimit duhet të adresojë mënyrën dhe arsyen e përpunimit të të dhënave , nevojën dhe proporcionalitetin e përpunimit, si dhe masat e propozuara për të adresuar rrezikun potencial etj.[125]

Në LMDP mungon një parashikim i tillë, ndaj për të arritur nivelin e pajtueshmërisë me Rregulloren, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të parashikojë një detyrim të tillë për kontrolluesit në mënyrë që të adresojë siç duhet rreziqet që lindin nga veprimtari përpunuese që kanë efekt tek një numër i madh individësh, apo kur përpunohen të dhëna sensitive. Në paketën e detyrimeve të kontrolluesit duhet të shtohet edhe detyrimi që, në rastet e përcaktuara nga Rregullorja të hartohet vlerësimi i ndikimit.

Një tjetër detyrim i përcaktuar nga Rregullorja lidhet me detyrimin për implementimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative që i përgjigjet nivelit të përshtatshëm të rrezikut potencial, si pseudonimizimi dhe enkriptimi i të dhënave personale, mundësia për të siguruar

konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të sistemeve të përpunimit, mundësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale në

121 Nenet 37-39, GDPR

122 Douwe Korff and Marie Georges, The DPO Handbook Guidance for Data Protection Officers in the Public and Quasi-Public Sectors on Hoë to Ensure Compliance ëith the European Union General Data Protection Regulation, korrik 2019, f 120.

123 Neni 39, GDPR.

124 Neni 35(3), GDPR.

125 Neni 35(7), GDPR.

kohë të shkurtër, në rastet e incidenteve fizike ose teknike etj.[126] Aktualisht, LMDP ka një parashikim të ngjashëm ne nenin 27, që kërkon marrjen e masave tekniko-organizative nga ana e kontrolluesit, megjithatë, Rregullorja e ka sjellë në një format të përditësuar. Nga pikëpamja substanciale, nuk ka ndryshim, por për të qenë në të njëjtën linjë me Rregulloren, duhet përshtatur, sipas frymës së saj, duke identifikuar si kërkesa kryesore të këtyre masave konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të sistemit të përpunimit të të dhënave personale. Qartazi, implementimi i këtyre masave kërkon kosto shtesë për kontrolluesit, por sigurisht që kushton më pak zbatimi i ligjit se sa moszbatimi i tij.

Më tej, Rregullorja përcakton se kontrolluesit, kanë një detyrim të dyfishtë për të njoftuar rastet e rrjedhjes së të dhënave.[127] Kjo do të thotë që rastet e rrjedhjes së të dhënave personale që çojnë në rrezikimin e të drejtave dhe lirive themelore duhet të njoftohen pa vonesë, dhe kur është e përshtatshme jo më vonë se 72 orë pas marrjes dijeni të faktit. Përveç njoftimit të autoritetit, Rregullorja përcakton edhe detyrimin për njoftimin e subjekteve të të dhënave në rast se rrjedhja do të përbëjë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individëve.

Ky detyrim mungon në LMDP, ndaj është e nevojshme që në funksion të mbrojtjes së të drejtave të subjekteve të të dhënave të përcaktohet detyrimi për njoftim në rast rrjedhjeje të të dhënave. Ky detyrim, sikurse i përcaktuar në Rregullore, duhet të jetë dy planësh, duke përcaktuar edhe detyrimin për njoftim të subjekteve të të dhënave, kur rrjedhja e të dhënave mund të kërcënojë të drejtat dhe liritë e tyre.

Së fundi, rregullorja përmbyll paketën e detyrimeve për kontrolluesit me detyrimin për bashkëpunim dhe për konsultim. Detyrimi për konsultim, lind vetëm në rastet e përpunimit të të dhënave që mund të shkaktojnë rrezik të lartë për të drejtat e individëve, identifikuar ky rrezik sipas vlerësimit të ndikimit.[128] Ndërsa detyrimi për bashkëpunim rëndon si për kontrolluesit dhe përpunuesit, të cilët, sipas kërkesës së autoritetit, iu drejtohet në përmbushje të detyrave të tij.[129]

Detyrimi për konsultim paraprak nuk ka gjetur hapësirë në ligjin aktual të mbrojtjes së të dhënave personale, ndaj, duhet të pasqyrohet në LMDP. Ndërsa detyrimi për bashkëpunim, është një detyrim i njohur edhe nga LMDP, dhe i drejtohet si institucioneve publike dhe atyre private, në mënyrë që KDIMDP të mund të ushtrojë të funksionet e përcaktuara ligjërisht.[130]

3.5. Kuadri Institucional

3.5.1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KDIMDP (referuar në vijim edhe si Komisioneri) është autoriteti i caktuar sipas LMDP për të mbikëqyrur zbatimin e LMDP. Në ligj, Komisionerit i janë njohur disa të drejta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si: a) kryerja e hetimit administrativ si dhe e drejta për të patur akses në përpunimet e të dhënave personale si dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm për ushtrimin e detyrave; b) urdhërimi i fshirjes, bllokimit, shkatërrimit ose pezullimit të përpunimit të paligjshëm të të dhënave; c) dhënia e udhëzimeve përpara realizimit të përpunimit dhe të sigurohet për publikimin e tyre.[131]

126 Neni 32 (1), GDPR.
127 Nenet 33 dhe 34, GDPR.
128 Neni 36, GDPR.
129 Neni 31, GDPR.
130 Neni 32, LMDP
131 Neni 30(1), LMDP

Për të siguruar zbatimin e dispozitave të ligjit, Komisionerit i është e njohur e drejta për të dhënë rekomandime[132] si dhe në rastet e moszbatimit të tyre ose në rastet e shkeljeve serioze e të përsëritura të denoncojë publikisht dhe të raportojë çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Funksioni i Komisionerit është tejet i rëndësishëm për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj edhe ligji është kujdesur që të përcaktojë elementë pavarësie duke parashikuar një mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje,[133] duke përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së tij[134], duke identifikuar qartësisht rastet e përfundimit të mandatit[135] si dhe duke i njohur pavarësinë buxhetore që mund të origjinojë, përveç buxhetit të shtetit edhe nga donatorë, që nuk kanë konflikte interesi.[136]

Ndonëse me garanci të tilla, sërish siç kanë evidentuar edhe progres raportet dhe raportet periodike vjetore të hartuara nga Komisioneri, ky i fundit nuk ka patur kapacitet të plotë sa i përket burimeve njerëzore[137]. Një nga mungesat e evidentuara dhe që luan një rol me rëndësi veçanërisht në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është mungesa e specialistëve IT. [138] Në fakt, mungesa e stafit është evidentuar si një mangësi në burimet njerëzore të Komisionerit edhe nga raporti vjetor i vitit 2021.[139]

Edhe në Bashkimin Europian, autoritetet kanë qenë shpesh pa stafin dhe burimet e nevojshme dhe shpesh herë, nuk kanë gëzuar pavarësinë e nevojshme.[140] Fakt i provuar edhe nga GJDBE, që disa shtete nuk kanë ruajtur mjaftueshmërisht pavarësinë e autoriteteve.[141] Për këtë arsye, Rregullorja, ka synuar forcimin e rolit të autoriteteve në drejtim të veprimtarisë së tyre mbikëqyrëse. Rregullorja i ka përcaktuar autoriteteve pushtet investigativ, korrigjues dhe pushtet për dhënie autorizimesh dhe veprimtari këshillimore.

Për të forcuar edhe më tej pozitën e Komisionerit, ligji duhet të saktësojë dhe zgjerojë në frymën e Rregullores kompetencat e Komisionerit. Në këtë drejtim, duhet të njihen ligjërisht si detyra të Komisionerit për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe kuptimin mbi rreziqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat lidhur me përpunimin, me fokus të veçantë veprimtaritë drejtuar fëmijëve, të rrisë ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe përpunuesve mbi detyrimet që lindin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, të mbikëqyrë zhvillime të cilat mund të kenë ndikim në mbrojtjen e të dhënave personale, të inkurajojë hartimin e kodeve të sjelljes, etj.

Në drejtim të kompetencave investigative, Komisionerit duhet t'i njihet pushteti për të dhënë paralajmërime drejtuar kontrolluesve dhe përpunuesve që do të përfshihen në procese përpunuese që paraqesin rrezikun për cenimin e të drejtave të subjekteve që mbrohen nga Rregullorja, mundësia për të qortuar shkelësit e normave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të urdhërojë kontrolluesit dhe përpunuesit për të respektuar detyrimet që burojnë nga ligji, si dhe të urdhërojë kontrolluesit/përpunuesit që të njoftojnë subjektet e të dhënave në rast rrjedhjeje të të dhënave personale.

Një tjetër, kompetencë, në drejtim të forcimit të pozitës së Komisionerit, lidhet me të drejtën për të nisur

132 Neni 31, LMDP
133 Neni 33, LMDP
134 Neni 35, LMDP
135 Neni 36, LMDP
136 Neni 38, LMDP.
137 Albania Progress Report, 2021, f. 28.
138 Intervista me zj. Besa Tauzi, Drejtoreshë e Kabitetit të Komisionerit
139 Raporti Vjetor 2021, Komisoineri i së Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, f. 47.
140 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
141 Shih C-288/12 Comission v Hungary ECLI:EU:C:2014:237, 8 Prill 2014.

procese gjyqësore për shkelje të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, kompetencë që mungon aktualisht.

3.5.2. Zbatimi i ligjit

Sipas LMDP autoriteti për mbikëqyrjen e respektimit të dispozitave të ligjit, është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe të Drejtën e Informimit. Për të bërë efektiv zbatimin e normave të ligjit, është parashikuar një sistem sanksionesh që varion në vlera të arsyeshme prej 10 000 lekë deri në 1 000 000 lekë. Vlera e gjobës dy-fishohet për personat juridikë. Gjobat vendosen nga Komisioneri varësisht nga lloji i detyrimit të shkelur.

Si alternativë e investimit të Komisionerit dhe ndjekjes së rrugës administrative për t'u ankuar mbi rrjedhjen e të dhënave personale, ligji njeh gjithashtu edhe mundësinë e ndjekjes gjyqësisht të rastit duke u ankuar, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile, në gjykatë. Në të vërtetë, dispozita është formuluar në mënyrë të paqartë, ndaj duhet kuptuar se pala e dëmtuar mund t'i drejtohet gjykatës drejtpërdrejt, pa qenë i detyruar të ezaurojë ankimin tek shkelësi. Ankimi tek shkelësi i parashikuar nga neni 16(1), mundëson zgjidhjen e rastit me mirëkuptim, pa investuar gjykatën, por nuk përbën kusht të domosdoshëm për ngritjen e padisë përkatëse. [142] **Duke qenë se dispozita lë vend për dykuptimësi, duhet qartësuar në LMDP se cilat janë mënyrat e ankimit dhe mjetet në dispozicion të subjektit të të dhënave personale. Lidhur me këto mundësi të subjektit të të dhënave personale Rregullorja është më e qartë dhe parashikon dy mundësi për mbrojtjen e subjekteve të të dhënave, si ankimi tek Autoriteti përkatës dhe drejtpërdrejt në gjykatë,** nëse vlerëson që të drejtat e tij që burojnë nga rregullorja janë cënuar nga veprimtaria e kontrolluesit dhe/ose përpunuesit.[143]

Në Bashkimin Europian, Rregullorja solli një ndryshim edhe të regjimit të zbatimit, pasi u njoh mundësia e ngritjes së padive kolektive si dhe ndryshim rrënjësor në regjimin e gjobave. Direktiva pararendëse karakterizohej nga sanksionet joefektive[144], ndaj Rregullorja ndryshoi qasje duke synuar zbatimin efektiv të dispozitave të saj. Sistemi i ri i sanksioneve administrative, reflekton një regjim të ngjashëm me sanksionet e zbatueshme në të drejtën e konkurrencës në mënyrë që Rregullorja të ofronte mbrojtje reale për të drejtat e subjekteve. Për këtë arsye, për shkelje jo shumë të rënda, gjobat mund të variojnë deri në 10 000 000 Euro ose nëse subjekti është një ndërmarrje, gjoba do të llogaritet si 2% mbi xhiron totale vjetore globale të vitit pararendës[145] dhe për shkelje më serioze këto sanksione dyfishohen.

Gjithashtu, duhet njohur mundësia e ngritjes së padive kolektive e konfirmuar së fundmi edhe nga GJDBE, në çështjen C-319/20 në të cilën gjykata njeh mundësinë Shteteve Anëtare për lejimin e shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve për paraqiten e padive përfaqësuese (representative actions) [146] kundër shkeljes së të dhënave personale edhe pa autorizim (prokurë) nga subjektet e dëmtuara, pra në mënyrë të pavarur, kundër palës përgjegjëse për shkeljen dhe cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Miratimi i projektligjit "Për paditë kolektive" mund të ndihmojë në zbatimin e këtyre instrumenteve edhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

142 Neni 16, LMDP.
143 Neni 79, GDPR
144 Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: What it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
145 Neni 83(4) dhe (5)
146 Janë padi të cilat ngrihen nga një organizatë në emër të një paditësave

Për këtë arsye, sugjerohet që regjimi i sanksioneve sipas LMDP duhet përshtatur sipas frymës së Rregullores. Ndoshta, do të duhet të rishikohet niveli i zhvillimit ekonomik të vendit, por gjithsesi trendi i gjobave duhet të ndjekë atë të Rregullores.

Gjithashtu, për një mbrojtje sa më të plotë të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe për të lehtësuar aksesin e tyre në drejtësi, në rastet e rrjedhjeve masive të të dhënave, duhet njohur mundësia për të shfrytëzuar paditë përfaqësuese (representative actions) për të mbrojtur interesat e subjekteve të të dhënave. Në këtë drejtim, do të ndihmojë miratimi i projektligjit "Për paditë kolektive".

3.6. Sfidat në zbatimin e ligjit

3.6.1. Sfidat në nivel institucional dhe zbatimin praktik të Rregullores

Rregullorja është ende një instrument i ri që ka vendosur një standard të mirë, së paku teorikisht, për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, pavarësisht kohës së shkurtër për vlerësimin e plotë të efekteve të saj, në BE ky instrument është vlerësuar si instrument i suksesshëm për arritjen e qëllimeve kryesore të saj: 1. Mbrojtja e të dhënave personale të individëve si dhe 2. rregullimin e qarkullimit të të dhënave personale brenda BE-së.[147] Disa nga përfundimet kryesore që kanë rezultuar nga vlerësimi i Rregullores dy vjet pas hyrjes së saj në fuqi, lidhen kryesisht me aspektin institucional të autoriteteve të shteteve anëtare që kanë kompetencën për mbrojtjen e të dhënave personale. Lidhur me autoritetet, është konstatuar se kanë nevojë për burime, njerëzore, teknike dhe financiare për realizimin e efektiv të detyrave të tyre[148]. Ndaj, në mënyrë të vazhdueshme Komisioni ka theksuar detyrimin e Shteteve Anëtare për të siguruar burimet e nevojshme të Autoriteteve shtetërore për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Rregullores.

Përpos kuadrit institucional, jo pa qëllim Rregullorja përbën një përzierje interesante mes parimeve dhe rregullimeve konkrete që të veprojnë si një instrument që evoluon dhe rregullon edhe rastet e

zhvillimeve teknologjike të cilat nuk janë adresuar specifikisht në variantin aktual. Sfidat me të cilat mund të përballet rregullorja në këtë drejtim lidhen me sasitë e mëdha të të dhënave që përpunohen (njohur edhe si big data), inteligjencën artificiale, algoritmet, teknologjinë blockchain etj.[149]

Një tjetër sfidë me të cilën mund të përballet Rregullorja është fragmentizimi nga legjislacionet e brendshme, të cilat duhet të hartohen në mënyrë thuajse të njëjtë për të kontribuar në uniformitetin e zbatimit dhe interpretimit të rregullores.

Nisur nga fakti që rregullorja është një akt i ri, është vlerësuar e nevojshme që Bordi Europian i mbrojtjes së të Dhënave dhe autoritetet shtetërore të japin udhëzime dhe sqarime për kontrolluesit dhe përpunuesit.[150]

147 Communication From the Commission to the Parliament and the Council, Data protection as a Pillar of citizens' empowerment and the EU's Approach to the digital transition- two years of application of the General Data Protection Regulation, SWD(2020)115 final, f.4.

148 Communication From the Commission to the Parliament and the Council, Data protection as a Pillar of citizens' empoëerment and the EU's Approach to the digital transition- two years of application of the General Data Protection Regulation, SWD (2020)115 final, f.6.

149 Council position and findings on the application on the application of the General data Protection Regulation, Brussels, 15 janar 2020, 14994/2/19, f.7.

150 Council position and findings on the application on the application of the General data Protection Regulation, Brussels, 15 janar 2020, 14994/2/19, f.6.

3.6.2. Sfidat në zbatimin e LMDP (edhe pas përafrimit)

Në vendin tonë, sfidat aktuale lidhen kryesisht me rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave personale, drejtuar kontrolluesve dhe përpunuesve të këtyre të dhënave si dhe drejtuar qytetarëve. Plotësimi i nevojave për burime njerëzore dhe teknike e financiare është një tjetër sfidë që lidhet me zbatimin dhe ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse të Komisionerit.

Ndryshimet ligjore do të sjellin përmirësim në drejtim të qartësimit të kompetencave të Komisionerit si dhe rritjen e kontrollit të subjekteve mbi të drejtat e tyre si dhe shtimin e përgjegjësive dhe detyrimeve ndaj kontrolluesve. Ndryshimet e reja ligjore, do të kërkojnë më shumë staf për Komisionerin dhe njohje të mirë të detyrave dhe kompetencave të reja të këtij institucioni. Gjithashtu, një sfidë me të cilën do të përballet (ndoshta) edhe ligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale, lidhet me zhvillimin teknologjik dhe ndryshimet që sjell inteligjenca artificiale apo teknologjitë block chain. Për këtë arsye, kërkohet një vëmendje e shtuar prej Komisionerit për të ndjekur këto zhvillime dhe për të vlerësuar ndikimin që kanë në mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III

Efikasiteti i hetimit administrativ dhe penal të rrjedhjeve masive të të dhënave personale të zgjedhësve, pagave të punonjësve dhe pronarëve të automjeteve

1. Hetimi Administrativ i KDIMDP-së

1.1 Ankesat e qytetarëve

Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.9887 për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë. Neni 16/2 parashikon se në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

a. Databaza e zgjedhësve

Nga informacioni që KShH ka siguruar, vërehet se Zyra e Komisionerit ka marrë 81 ankesa gjatë periudhes Prill — Gusht 2021, të cilat lidhen me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve. Pavarësisht se është kërkuar informacion për datën e secilës prej ankesave, kjo e dhënë nuk është vendosur në dispozicion, çka kufizon vlerësimin nëse këto ankesa janë përcjellë para ose pas fillimit me iniciativë të hetimit administrativ nga Komisioneri.

Gjysma e këtyre ankesave (49.4%) janë paraqitur ndaj subjektit zgjedhor "Partia Socialiste" dhe në një shumicë dërrmuese, por më pak se gjysma (38.3%), i atribuohen Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Të dhënat janë tregues i perceptimit të ankuesve ndaj përgjegjësve të kësaj databaze. Në një minorancë, subjektet janë ankuar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, portalit të lajmeve Lapsi.al dhe kandidatëve për deputetë.



b. Databaza e pagave dhe automjeteve

Në lidhje me përhapjen e paligjshme të kategorisë së të dhënave personale për "nëpunës/punonjës" në sektorin publik dhe privat dhe përhapjen e paligjshme të kategorisë së të dhënave personale për "pronarë automjetesh", pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar 47 ankesa, prej të cilave 22 ndaj AKSHI-t dhe 25 ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Pavarësisht se edhe për këto ankesa është kërkuar informacion për datën e secilës prej tyre, kjo e dhënë nuk është vendosur në dispozicion, çka kufizon sërisht vlerësimin nga KShH, nëse këto ankesa janë përcjellë para vendimmarrjes për fillimin me inisiativë të hetimit administrativ nga Komisioneri.



1.2 Fillimi i çështjes me inisiativë

Bazuar në nenin 30, pika 1, gërma "a", të ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), KDIMDP kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes.

Duke qenë se parashikimet lidhur me hetimin administrativ që kryen Komisioneri në fushën e të dhënave personale janë të përgjithshme, rregullat, parimet dhe procedurat që udhëheqin hetimin administrativ të çdo organi publik, përfshi Zyrën e Komisionerit, parashikohen në ligjin nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative". Kodi është një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar, ndaj dispozitat e tij kanë epërsi ndaj dispozitave të ligjeve që janë miratuar me shumicë të thjeshtë. Vlen të theksohet se referenca në Kodin e Procedurave Administrative është realizuar nga vetë zyra e Komisionerit në kuadër të hetimeve administrative që ka nisur për rrjedhjen e të dhënave personale me databazat e qarkulluara masivisht gjatë vitit 2021.

Parimi i hetimit kryesisht (ose me nismën e vetë organit publik) udhëheq seksionin e hetimit administrativ, duke u parashikuar në nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas këtij parimi, organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Sipas pikës 2 të këtij neni, organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

a. Databaza e zgjedhësve

Sipas shkresës së Komisionerit me nr.793/1, dt.22.04.2022, kthim përgjigje, drejtuar KShH-së si dhe kopjeve të urdhërave të vëna në dispozicion, referohet se institucioni ka filluar hetimet administrative me nismën e tij (ex-officio) me objekt "Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve". Ky hetim, sipas Zyrës së Komisionerit ka filluar sapo është njohur në media me publikimin e lajmit për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale për 910 mijë shtetas/zgjedhës. Hetimi administrativ rezulton se ka nisur pranë disa kontrolluesve, për të cilët, KShH është njohur edhe me urdhërat përkatës të hetimit nga Komisioneri, si vijon:

1. Ndaj subjektit "Lapsi.Al SHPK", hetimi administrativ ka nisur bazuar në urdhrin nr. 45, datë 19.04.2021.
2. Ndaj subjektit "DPGJC", hetimi administrativ ka nisur bazuar në urdhrin nr. 46, datë 19.04.2021.
3. Ndaj subjektit "AKSHI", hetimi administrativ ka nisur bazuar në urdhrin nr. 47, datë 19.04.2021.
4. Ndaj subjektit "DPT", hetimi administrativ ka nisur bazuar në urdhrin nr. 53, datë 29.04.2021.
5. Ndaj subjektit "Partia Socialiste", hetimi administrativ ka nisur bazuar në urdhrin nr. 57, datë 05.05.2021.

Tërheq vëmendjen fakti se edhe pse data e publikimit të lajmit në median online daton në 11 Prill, cikli i parë i hetimeve administrative ka nisur 8 ditë me vonesë, përkatësisht në dt.19 Prill 2021, duke filluar një një raport jo konseguent nga pikëpamja kronologjike ndaj subjekteve të kontrolluara.

Zyra e Komisionerit, në dt.19 Prill ka nxjerrë tre urdhëra të veçantë për kryerjen e hetimit administrativ, ndaj tre kontrolluesve, përkatësisht ndaj kontrolluesit "Lapsi.al", kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" dhe kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit". Sa i takon hetimit administrativ të urdhëruar ndaj kontrolluesit që gëzon cilësinë e subjekti mediatik, "Lapsi.al", vërehet se Komisioneri nuk ka patur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së për rëndësinë që ka mbrojtja e burimeve gazetareske, në funksion të lirisë së shtypit në një shoqëri demokratike. Një vendimmarrje që mund të sjellë zbulimin e burimit gazetaresk vlerësohet nga GJEDNJ se mund të krijojë premisa për tkurrjen e lirisë së shtypit dhe medias së lirë[151].

Tetëmbëdhjetë ditë më vonë, Zyra e Komisionerit ka nxjerrë urdhërin për realizimin e hetimit administrativ ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ndërkohë që rreth 24 ditë më vonë , ky urdhër ka përfshirë kontrolluesin e fundit, subjektin "PS".

Është e paqartë se përse subjektit zgjedhor ndaj të cilit rëndojnë dyshimet e bëra publike në media, "PS", renditet e fundit në radhën e kontrolluesve për tu hetuar administrativisht, prej Zyrës së Komisionerit. Ky konstatim vlen gjithashtu edhe për faktin se përfaqësues të subjektit deklaruan në një hark të shkurtër kohor, se administrojnë një databazë, të cilën e kanë krijuar prej vitesh të tëra organizimi, duke kontaktuar zgjedhësit derë më derë[152]. Në një situatë të tillë, urgjenca e verifikimit të kësaj rrjedhje masive të të dhënash diktonte nevojën e menjëhershme për të kryer verifikimet pranë këtij subjekti zgjedhor si dhe enteve publike që janë në kontakt me informacione të ngjashme me ato që databaza përmbante (si numrat personalë, vendbanimet, vendet e punës, etj). Kjo urgjencë diktohej gjithashtu nga nevoja për sigurimin e menjëhershëm të provave në sistemet kompjuterike të këtyre

151 https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Journalistic_sources_ENG.pdf

152 https://lapsi.al/2021/04/11/alibia-e-taulant-balles-per-pergjimin-qe-ps-u-ben-te-dhenave-personale-te-qytetareve/ https://lapsi.al/2021/04/13/rama-pranon-patronazhistet-kemi-vite-qe-i-kemi-shperndare-ne-terren/

subjekteve, me qëllim që ato të mos manipuloheshin apo dëmtoheshin.

b. Databaza e pagave dhe automjeteve

Në ndryshim nga fillimi i hetimit kryesisht për databazën e zgjedhësve, fillimi i procedimit administrativ për databazën e pagave ka filluar menjëherë pas publikimit. Kjo vërtetohet nga urdhëri i Komisionerit nr.203, dt.22.12.2021, me anë të të cilit urdhërohet hetimi administrativ ndaj kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve".

Sa i takon databazës për pronarët e automjeteve, fillimi i hetimit të parë administrativ daton në 28 Dhjetor, ose ndryshe 4 ditë pas publikimit të lajmit dhe është urdhëruar të realizohet pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor".

Me vonesë të konsiderueshme, Komisioneri ka filluar hetimin administrativ për këto dy databaza ndaj subjektit "AKSHI", përkatësisht në dt.25 Shkurt 2022 ose rreth 2 muaj me vonesë nga data e publikimit të lajmit për ekzistencën e tyre.

Vlen të theksohet se, si për databazën e pagave dhe atë të automjeteve, Zyra e Komisionerit nuk ka urdhëruar hetim administrativ pranë subjekteve mediatike që kanë bërë publike lajmin për ekzistencën e tyre. Në këtë drejtim, mund të ketë ndikuar pozitivisht edhe vendimmarrja e ndërmjetme e GJEDNJ-së në favor të aplikantëve që administrojnë portalin mediatik "Lapsi.al".

1.3 Objekti i Hetimit Administrativ

Rrjedhjen masive të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit e cilëson në shkresën "Kthim Përgjigje" drejtuar KShH-së, si "*personal data breach*" (referuar terminologjisë ligjore ndërkombëtare), e cila është hetuar administrativisht në tre çështje me këto objekte:

a. Përhapja e paligjshme e të dhënave për kategorinë shtetas/zgjedhës:
b. Përhapja e paligjshme e të dhënave për kategorinë "nëpunës/punonjës" në sektorin publik dhe privat;
c. Përhapja e paligjshme e të dhënave për kategorinë "pronarë automjetesh".

Objekti i këtyre tre hetimeve administrative përkon dhe ka filluar në mënyrë kronologjike gjatë vitit 2021, pas publikimit të lajmit për ekzistencën e tre databazave.

1.4 Mjetet e kërkimit të provës dhe efikasiteti i hetimit administrativ ndaj subjekteve të kontrolluara

Sikurse është theksuar më herët, në Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" është parashikuar kompetenca e Komisionerit në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale për të kryer hetim administrativ dhe patur të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe të drejtën për të mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes.

Në funksion të hetimit administrativ, neni 80 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon kuptimin dhe mjetet e kërkimit të provës. Sipas pikës 1 të këtij neni, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.

Në pikën 2 të këtij neni, Kodi i Procedurave Administrative zgjeron më tej konceptin e mjeteve të kërkimit të provës në dispozicion të organit publik, duke bërë referencë tek dispozitat e ligjit për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, të cilat zbatohen, për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

Neni 86 i Kodit të Procedurave Administrative i jep gjithashtu garancinë procedurale organit publik për të siguruar provat, kur vëren se rrezikohet marrja e një prove, dhe nëse prej tyre varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj [153]. Për shkak të rëndësisë që ka marrja e provës në kohë, në pikën 2 të këtij neni, parashikohet garancia për sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative.

Në analizë të dokumentacionit të përcjellë nga Komisioneri për sa i takon hetimit administrativ për këto tre baza të dhënash, vërehet se në urdhrat e hetimit pranë kontrolluesve nuk përcaktojnë qartësisht dhe plotësisht, elementët e parashikuar në nenin 77, pika 2 të Kodit të Procedurës Administrative. Konkretisht, ky nen kërkon që organi publik të përcaktojë në mënyrë të pavarur llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit, ndërkohë që në urdhërat e Komisionerit vërehet se :

- është parashikuar caktimi i grupit të inspektimit, të cilët autorizohen në kryerjen e veprimeve procedurale për zhvillimin e kontrollit, duke zbatuar kërkesat ligjore për këtë qëllim.
- është përcaktuar qëllimi i hetimit, në përputhje me nenin 77, pika 2, për të verifikuar lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve.
- Urdhërat e hetimit nuk japin orientime për veprimet procedurale që do të kryhen nga inspektorët apo mjetet e kërkimit të provës që do të zbatohen, dhe deri ku do të shtrihen hetimet konkrete për secilin kontrollor.
- Urdhërat janë standardë në përmbajtje dhe nuk mbajnë në konsideratë natyrën e veprimtarisë të secilit kontrollues, sektorin që përfaqëson subjekti (publik apo privat), të dhënat që administrohen apo mund të administrohen prej tij, dhe specifika të tjera të kontrolluesve.

Invidualizimi i veprimtarisë hetimore do të ishte i domosdoshëm pasi duhej vlerësuar nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes, e cila përcaktohet që në nisje të hetimit administrativ (neni 77, pika 2 e Kodit).

1.4.1 Analizë e thelluar e relacionit të Zyrës së Komisionerit për hetimin administrativ të databazës së zgjedhësve

Komisioneri ka referuar në përgjigjen e tij se gjetjet e evidentuara për hetimet administrative të databazës së parë, janë trajtuar në Relacionin e Hetimit Administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, me nr.prot 1399, dt.19.08.2021, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Zyrës

153 Kur kjo provë ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj. Sigurimi i provës osesiç njihet ndryshe marrja më parë e saj mund të bëhet nga organi publik, kryesisht apo me kërkesën e justifikuar tëpalës

së Komisionerit[154].

Në frymën e një qasje kritike konstruktive, analiza sistematike e bazuar në standartet ligjore, e relacionit të hetimit administrativ të zyrës së Komisionerit, shfaq këto mangësi:

- Hetimi rezulton të jetë zhvilluar pjesërisht dhe në mënyrë të cekët, ndërkohë që Zyra e Komisionerit mund të kishte marrë masa të tjera të nevojshme për të kërkuar një larmishmëri më të gjerë provash që bëjnë të mundur në zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin konkret të përgjegjësisë së kontrolluesve.
- Kërkimi i informacionit ndaj subjekteve të hetuara, përkatësisht DPT dhe PS, është realizuar me vonesë, përkatësisht 20 dhe 40 ditë nga fillimi i hetimit administrativ ndaj tyre. Kjo vonesë ka dobësuar hetimin administrativ në kohë të arsyeshme dhe me efiçiencë, dhe mund të ketë ndikuar në tjetërsimin apo fshehjen e provave të nevojshme, për të cilat Zyra e Komisionerit nuk ka kërkuar sigurimin e tyre që në krye të hetimit administrativ (sikurse mund të ishin serverat apo burime të tjera të provës).
- Relacioni nuk pasqyron veprimet konkrete procedurale që janë ndërmarrë nga grupi i inspektimit në kontrollin pranë subjekteve, ndërkohë që vëmendje e shtuar i është dedikuar referimit dhe interpretimit të zgjeruar të ligjit për të dhënat personale dhe udhëzimeve të mëparshme të Komisionerit.
- Gjatë hetimit, të zhvilluar pranë subjekteve, Komisioneri ka paraqitur një listë me pyetje dhe kërkesa në lidhje me veprimtaritë përpunuese të të dhënave personale nga secili subjekt i kontrolluar. Me përjashtim të DPGJC-së, 3 kontrolluesit e tjerë kanë treguar një nivel të ulët bashkëpunimi në dhënien e informacionit dhe pranimin e përgjegjësive. Tërheq vëmendjen fakti që ky informacion nuk i është nënshtruar nga zyra e Komisionerit, ballafaqimit me informacione të tjera që mund të ishin marrë gjatë hetimit administrativ, çka vendos në pikëpyetje mungesën e aksesit të inspektorëve në sistemin kompjuterik dhe atë të serverave të subjekteve të kontrolluara.
- Zyra e Komisionerit nuk ka reflektuar një qasje pro-aktive në dhënien e sanksioneve administrative me gjobë për cënim të nenit 2 të ligjit nr.9887/2008 ndaj subjekteve që i janë nënshtruar kontrollit administrativ dhe që nuk kanë bashkëpunuar sa duhet për vendosjen në dispozicion të informacionit. Në fakt, sanksion administrativ është dhënë vetëm ndaj DPT-së, 4 muaj pasi ka filluar hetimi administrativ, ndërkohë që në një situatë të tillë reagimi mund të kishte qenë i menjëhershëm pas mungesës së informacionit dhe aksesit në sistemet kompjuterike për secilin nga subjektet e kontrolluara.
- Pavarësisht se të gjithë kontrolluesit e mëdhenj kanë detyrimin të krijojnë, administrojnë e mirëmbajnë Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), ky sistem ka rezultuar i munguar në thuajse të gjitha institucionet e administratës shtetërore që janë hetuar administrativisht nga AKSHI. Këto të dhëna janë reflektuar edhe në raportet vjetore të KDIMDP pranë Kuvendit për vitin 2021. Por pavarësisht nga kjo, ky sinjalizim i KDIMDP-së nuk i shërbeu parandalimit të ngjarjes.
- Në përfundim të hetimit administrativ ndaj tre subjekteve (kontrolluesve publikë), zyra e KDIMDP arrin në konkluzione hipotetike, se nuk përjashtohet mundësia që të dhënat e databazës së patronazhistëve të jenë marrë nga baza e të dhënave që kontrollohen dhe/ose përpunohen prej këtyre institucioneve apo subjekteve të kontraktuara/nënkontraktuara prej tyre. Këto konkluzione nuk i shërbejnë interesit publik dhe as përgjegjësisë së institucioneve, ndërkohë që evidentojnë rishtazi domosdoshmërinë për të thelluar hetimin administrativ dhe ezauruar të gjitha mjetet e kërkimit të provave konform ligjit nr.9887/2008 dhe Kodit të Procedurave Administrative.

154 https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/09/Relacion_hetimi_administrative_per_perhapjen_e_paligjshme_te_te_dhenave_personale_t e_shtetasve.pdf

i. Hetimi Administrativ pranë DPGJC-së

Nga verifikimet që ka kryer pranë DPGJC-së, Zyra e Komisionerit konstaton se 30% e databazës së zgjedhësve përbëhet nga të dhëna që origjinarisht DPGJC iua transmeton subjekteve zgjedhore sipas nenit 60 të Kodit Zgjedhor[155]. Të njëjtët përbërës zgjedhorë nga të dhënat që përpunon DPGJC, mund të aksesohen nga shoqëria koncesionare ALEAT, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) si dhe AKSHI.

Tërheq vëmendjen fakti se në referencë të udhëzimit të përbashkët nr.463, dt.10.12.2020, të Komisionerit dhe Ministrit të Brendshëm, rezulton se janë 36 kontrollues të tjerë, të cilët kanë akses në këto të dhëna, sipas të drejtave dhe detyrimeve ligjore përkatëse. Referuar regjistrit të shërbimeve të bazave të të dhënave ofrues-konsumues, të administruar nga AKSHI, rezulton se janë 47 institucione publike/private që kanë akses në Regjistrim Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).

Një problematikë shqetësuese që zyra e Komisionerit e ka konstatuar që në vitin 2019 ndaj kontrollorit DPGJC dhe më vonë, në dt.9 Prill 2021 (dy ditë para publikimit të databazës) i është drejtuar AKSHI-t, DPGJC-së dhe DPPSH-së, ka të bëjë me kërkesën për të bllokuar dhe filluar procedimin ligjor për personat/subjektet që qëndrojnë pas faqes publike të internetit https://gjendjacivile.bogspot.com/p/falas.html.

Në këtë faqe interneti ka vijuar publikimi i të dhënave personale që merren nga RKGJC, i përditësuar deri në vitin 2008. Me rekomandimin nr.26 të vitit 2019, Zyra e Komisionerit lë një sërë detyrash për zbatim ndaj DPGJC-së si dhe ka kërkuar nga AKEP po në të njëjtin vit bllokimin e faqes së internetit[156].

Zyra e Komisionerit vëren se për një pjesë të shtetasve, të dhënat e të cilëve janë përpunuar në Databazën e Zgjedhësve, ato rezultojnë të aksesueshme në mënyrë të paligjshme edhe në faqen e mësipërme të internetit. **Në funksion të parimit të transparencës dhe llogaridhënies para publikut, ky i fundit duhet të informohej se përse nga Prilli i vitit 2019 dhe dy vite më vonë, rekomandimet e Zyrës së Komisionerit nuk janë zbatuar? A mund të ishte parandaluar një rrjedhje masive potenciale, nga këto burime nëse do të ishte zbatuar parimi i** përgjegjësisë administrative**, konform sanksioneve që parashikohen në ligjin në fuqi për të dhënat personale?**

Zyrat e Komisionerit referon se pranë DPGJC-së janë kryer veprime procedurale që përfshijnë konstatimet në vend dhe shqyrtimin e bazës ligjore dhe akteve të brendshme. Ky shpjegim është i pamjaftueshëm në kuptim të alternativave të mjeteve të kërkimit të provave, sikurse parashikohet në nenin 80 të Kodit të Procedurave Administrative. Prova të tilla mund të ishin siguruar nga deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët, dokumentet, përfshi këtu ato të siguruara me mjete fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, etj.

DPGJC referon se në nenin 60 të Kodit Zgjedhor, parashikohet vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe/ose partive politike. Ky dokumentacion mund të vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike, e cila mundësohet në formë të tillë që lejon kërkime dhe krahasime të kryqëzuara. Por pavarësisht nga argumentimi ligjor i DPGJC-së, vërehet se në relacionin e Komisionerit nuk qartësohet se në cilat data janë vendosur listat/ekstraktet në dispozicion ndaj subjektit zgjedhor, mbi të cilin rëndojnë dyshimet e publikuara në media dhe a përkojnë këto të dhëna, me databazën e zgjedhësve dhe databazën që subjekti PS ka siguruar në serverin dhe sistemet

155 Të dhënat personale (përbërësit zgjedhorë) që DPGJC transmeton tek subjektet zgjedhore janë konkretisht emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri personal dhe shtetësia.

156 Shih faqen 18 të Relacionit të Hetimit Administrativ të Zyrës së Komisionerit

e teknologjisë së informacionit të tij.

DPGJC referon se numërohen 590 përdorues aktiv që kanë akses në ndërfaqen grafike të përdoruesit të sistemit të gjendjes civile. Përdoruesit në nivel baze të dhënash, me të drejta leximi/përditësimi, ndër të tjerash garantojnë kopje back up (përditësimit) të bazës së të dhënave, duke i ruajtur në pajisjet e dedikuara të back-up. Në relacion nuk qartësohet nëse inspektorët kanë kryer verifikime në pajisjet e dedikuara të përditësimit dhe nëse rezulton që të ketë patur transferime të kopjeve të back-up tek persona apo pajisje të paautorizuara.

Pyetjes së zyrës së Komisionerit për të listuar palët e treta tek të cilat përhapen të dhënat personale, DPGJC i ka kthyer përgjigje duke cituar udhëzimin nr.463, dt.10.12.2020[157], sipas të cilit rezultojnë se janë 36 kontrollues që aksesojnë të dhëna nga RKGJC . Platforma qeveritare e ndërveprimit që menaxhohet nga AKSHI bën të mundur shkëmbimin e të dhënave me palët e treta, për të shmangur përhapjen e të dhënave personale prej tyre. Vlen të përmendet se në relacion, Zyra e Komisionerit, nuk argumenton mungesën e shtrirjes së hetimeve administrative edhe ndaj këtyre 36 kontrolluesve, çka do të kontribuonte për hetime sa më gjithëpërfshirëse për zbardhjen e ngjarjes.

Gjithashtu, në relacion thuhet se ka një përputhshmëri të ulët të kategorive të të dhënave që përpunon ky kontrollues (DPGJC) në raport me ato që pasqyrohen në Databazën e Zgjedhësve, dhe ky përbën një nga treguesit që e bën të pamundur të provohet nëse kjo databazë është populluar me të dhënat e RKGJC-së. Megjithatë, fakti që rreth 30% e të dhënave të RKGJC (ose 6 nga 20 të dhëna) janë pjesë Databazës së zgjedhësve, përbën një nivel të mjaftueshëm që nuk mund të përjashtojë përgjegjësinë e DPGJC-së apo kontrolluesve që kanë akses në këto të dhëna, për rrjedhjen e tyre. Tërheq vëmendjen fakti se, në këtë konkluzion, zyra e Komisionerit bazohet edhe tek konstatimet në vend të grupit të inspektorëve, të cilat nuk citohen qoftë në mënyrë të përmbledhur se në ç'drejtim kanë konsistuar dhe të dhënat që janë përftuar prej tyre.

ii. Hetimi Administrativ pranë DPT-së

Në relacion thuhet se Zyra e Komisionerit ka ushtruar hetim administrativ pranë DPT, pranë të cilit, grupi i kontrollit ka kërkuar informacione dhe sqarime në lidhje me proceset përpunuese, kategoritë e të dhënave, subjekteve të të dhënave, etj.

Nga data 19 Prill, që përkon me fillimin e hetimit administrativ nga Zyra e Komisionerit pranë DPT-së, informacioni prej këtij të fundit është vendosur në dispozicion 21 ditë më vonë në rrugë elektronike. Kjo vonesë dobëson hetimin administrativ në kohë të arsyeshme dhe me efiçencë. Për më tepër, edhe përse ka marrë një kohë relativisht të gjatë, shqetësues është fakti se DPGJC nuk është treguar aspak bashkëpunues në dhënien e informacionit, si dhe ka mohuar rolin e saj si "kontrollues" për të dhënat.

Pjesë e informacionit të munguar nga DPT që mund të ndihmonte hetimin administrativ, është ai lidhur me loget dhe gjurmushmërinë e logeve për akseset në sistem. DPT referon se *"Loget, gjurmueshmeria e logeve për akseset në sisteme duhet të kërkohen rast pas rasti sipas objektit të hetimit dhe do të vihen në dispozicion në rast se nuk janë informacion i klasifikuar "sekret shtetëror", i cili vihet në dispozicion vetëm pas plotësimit të të gjithë kritereve të legjislacionit në fuqi.";*

Shqetësues është fakti se, DPT nuk ka njohur atributin e Komisionerit sipas ligjit nr. 9887/2008, neni 31/1, gërma "ç", për t'u njohur dhe për të patur akses në informacionin dhe dokumentet, objekt

157 I përbashkët i KDIMDP-së dhe Ministrit të Brendshëm.

ankimi, sipas ligjit për të drejtën e **informimit apo që lidhen me** çështjen **në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara "sekret shtetëror".**

Detyrimi që institucionet publike dhe private të bashkëpunojnë me Komisionerin, është parashikuar shprehimisht në nenin 32 të ligjit nr.9887/2008, ku në pikën 2 parashikohet se Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.

Pavarësisht se DPT ka reflektuar që në 20 ditët e para të hetimit administrativ një qasje jo bashkëpunuese, Komisioneri ka vendosur ta gjobisë në vlerën 1,000,000 Lek të reja, në dt.23 Gusht, pra 3 muaj e gjysëm, më vonë[158]**.** Në një çështje që mbart një interes të lartë publik, kur detyrimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nuk njihen, nuk pranohen apo respektohen nga një institucion publik si DPT dhe kur qasja mosbashkëpunuese reflektohet që në fillim të procedurës së hetimit administrativ, sanksioni duhej dhënë në një kohë sa më të arsyeshme, në funksion të parimit të përgjegjësisë para ligjit dhe efikasitetit të hetimit administrativ. Në vlerësimin tonë, Komisioneri mund të ndërmerrte hapat ligjorë të përshkallëzuar dhe proporcionalë, për të patur akses në këtë informacion, në një kohë sa më të shpejtë dhe në zbatim të sanksioneve ligjore në rast mosbashkëpunimi.

Problematikat lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që zhvillon DPT, janë konstatuar nga KDIMDP në një inspektim të 5 muajve më parë që nuk ka të bëjë me objektin e hetimit administrativ të databazës së zgjedhësve. Kjo problematikë është pasqyruar në raportin vjetor drejtuar Kuvendit më dt. 8 Shkurt 2021 dhe ka të bëjë me mungesën e një kuadri rregullator specifik të DPT në këtë fushë, mungesën e proceseve të monitorimit të standardizuara dhe periodike për ruajtjen e integritetin e të dhënave, etj. Megjithatë, tërheq vëmendjen fakti se këto konstatime kanë ngelur vetëm në kuadrin e rekomandimeve ndaj DPT-së, ndërkohë që nuk janë dhënë sanksione konform nenit 39 të ligjit nr.9887/2008. Sjellim në vëmendje se sipas pika 1, gërma "dh" të këtij neni, ndaj kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, jepet dënim me gjobë nga 10 000 deri në 150 000 lekë, e cila dyfishohet në rast se është kryer nga persona juridikë.

iii. Hetimi Administrativ pranë AKSHI-t

Edhe për këtë subjekt, në relacion thuhet se Zyra e Komisionerit ka ushtruar hetim administrativ në kuadër të të cilit, grupi i kontrollit ka kërkuar informacione dhe sqarime në lidhje me proceset përpunuese, kategoritë e të dhënave, subjekteve të të dhënave, etj.

Përveç nevojës për të individualizuar hetimin administrativ në raport me kompetencat specifike të AKSHI-t, kemi mendimin se objekti i hetimit mund të ishte më i drejtpërdrejtë, për të verifikuar nëse ka patur transferime të dhënash nga sistemet kompjuterike të AKSHI-t ndaj personave/subjekteve dhe pajisjeve të paautorizuara, a mundësohet ky transferim nga sistemi kompjuterik dhe ai i sigurisë që administrohet nga AKSHI, kur është bërë kontrolli i fundit për respektimin e rregullave të sigurisë, etj.

Në përgjigjet e dhëna, AKSHI reflekton një qasje jo të mirë bashkëpunuese për dhënien e informacionit ndaj zyrës së Komisionerit, duke mohuar gjithashtu rolin e tij kontrollues dhe përpunues për të dhënat.

158 Shih vendimin nr.807/4, dt.23.08.2021, publikuar në këtë link https://www.idp.al/wp- content/uploads/2021/08/vendimi_nr_41_dmdp_2021.pdf

Gjithashtu, AKSHI referon se nuk përhap të dhëna pasi nuk ka akses në to. Në lidhje me kërkesën e zyrës së Komisionerit për të venë në dispozicion listën e institucioneve për të cilat ky subjekt ofron asistencë teknike dhe kategorinë e të dhënave që aksesohen prej secili prej tyre, AKSHi nuk disponon qartazi me përgjigje konkrete.

Tërheq vëmendjen fakti që një pjesë e përgjigjeve që shmangin dhënien e informacionit nga AKSHI janë të njëjta me përgjigjet e DPT-së, duke reflektuar pikëpyetje për ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit midis këtyre dy institucioneve, gjatë hetimit administrativ të KDIMDP-së. Kështu, përballë pyetjes së KDIMDP lidhur me kontratat me mirëmbajtësit e sistemeve, AKSHI përgjigjet njësoj si DPT, se ato duhet të kërkohen rast pas rasti, sipas objektit të hetimit.

Në pjesën e konstatimeve, KDIMDP referon se hetimi administrativ pranë AKSHI-t është realizuar bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion nga ky kontrollues, si dhe në përgjigjet e tij lidhur me kërkesat/pyetjet e parashtruara në kuadër të planit të hetimit. Ky konstatim evidenton se inspektorët e KDIMDP nuk kanë patur akses në serverat, sistemet kompjuterike, të arkivimit dhe ato të sigurisë që AKSHI administron, ndërkohë që ky është institucioni kyç që menaxhon platformën qeveritare të ndërveprimit[159].

Për të kundërshtuar qasjen mospranuese të AKSHI-t si kontrollues, përpunues dhe jo aksesues i të dhënave, KDIMDP rendit dhe argumenton në mënyrë të detajuar kompetencat e këtij subjekti sipas VKM nr.673. Ndër to është edhe ajo e mundësimit të shkëmbimit të të dhënave të sistemeve elektronike, me anë të platformës qeveritare të ndërveprimit, në përputhje me kushtet e sigurisë.

Zyra e Komisionerit pranon se përgjigjet e AKSHI-t në lidhje me cilësinë e tij si kontrollues/përpunues, si dhe aksesin në të dhëna, rezultojnë jo shteruese dhe nuk ndihmojnë në procesin e hetimit administrativ. Ky konstatim vlen edhe për mosadresimin e kërkesave të parashtruara në disa pika të planit të hetimit. Gjithashtu, KDIMDP konstaton se AKSHI, në cilësinë e bashkëkontrolluesit të të dhënave është e detyruar të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale[160]. Por pavarësisht nga ky konstatim, përgjigjet e munguara apo të cunguara të AKSHI-t ndaj kërkesave të KDIMDP, nuk kanë qenë të mjaftueshme për këtë të fundit, për dhënien e dënimit administrativ për cënim të nenit 32 të ligjit nr.9887/2008. Kjo qasje për mos aplikimin e sanksioneve, reflekton një standart jo të njëjtë të KDIMDP në raport me subjektin e hetuar në kuadër të së njëjtës çështje, DPT-në.

Bazuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, të gjithë kontrolluesit e mëdhenj (përfshi dhe AKSHI-n) kanë detyrimin të krijojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë SMSI-të për mbrojtjen e të dhënave personale. Thuajse në të gjithë institucionet e administratës shtetërore, përfshi edhe AKSHI-n, të cilat janë inspektuar në bazë të urdhërit të dt.09.11.2020 nga ana e Zyrës së Komisionerit, ka rezultuar mungesa e ekzistencës së SMSI-ve. Problematika është reflektuar në raportin vjetor të KDIMDP për vitin 2020, para Kuvendit. Ndër të tjerash, është vërejtur se AKSHI nuk ka në strukturën organizative një funksion të pavarur për të monitoruar dhe përmirësuar, në mënyrë të vazhdueshme këtë sistem, e cila do të luante një rol të rëndësishëm në sigurinë e informacionit dhe efikasitetit të SMSI-së.

Në përfundim të relacionit[161], Zyra e Komisionerit nuk përjashton mundësinë që Baza e të Dhënave të jetë populluar nga të dhënat, të cilat kontrollohen dhe/ose përpunohen nga institucionet objekt të këtij hetimi apo të kontraktuara/nënkontraktuara prej tyre. KDIMDP vëren se rrjedhja mund të jetë rezultat i mungesës së masave të sigurisë nga subjektet që kanë të drejtë t'i aksesojnë këto të dhëna, ose nga vetë

159 Shih faqen 14 dhe 26 të Relacionit.
160 Shih faqen 30 të Relacionit.
161 Shih fq.34 të Relacionit

institucionet ku këto të dhëna përbëjnë të dhëna parësore dhe/ose dytësore të bazave shtetërore të krijuara sipas legjislacionit në fuqi. Ky konkluzion hipotetik ndaj AKSHI-t dhe subjektet e tjera në sektorin publik, reflekton mungesën e një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm, konform ligjit nr.9887/2008 dhe Kodit të Procedurave Administrative.

iv. Hetimi administrativ pranë subjektit "Partia Socialiste" (PS)

Lajmi për ekzistencën e databazës është bërë publik në dt.11 Prill, por hetimi administrativ ndaj subjektit zgjedhor si i dyshuar për krijimin e saj ka filluar rreth një muaj me vonesë, në dt. 5 Maj 2021. Përveçse i vonuar në fillimin e hetimeve, i vonuar ka qenë edhe reagimi i subjektit për vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar gjatë inspektimit në terren nga grupi i inspektorëve të KDIMDP-së, përkatësisht në dt.14 Qershor ose dy muaj pas publikimit të lajmit. Është e paqartë në përmbajtje të relacionit, se përse ky informacion është marrë me kaq vonesë dhe nëse ka patur vizita të mëparshme inspektuese në terren, dhe konkretisht pranë cilave zyrave të subjektit zgjedhor janë realizuar ato.

Databaza e Patronazhistëve për Bashkinë e Tiranës diktonte nevojën që inspektimi të shtrihej në të gjitha zyrat e subjektit zgjedhor të lokalizuara në këtë Bashki.

Për më tepër, edhe përse ka marrë një kohë relativisht të gjatë marrja e informacionit, subjekti zgjedhor nuk është treguar plotësisht bashkëpunues në ofrimin e tij. Sikurse thuhet në relacion, kontrolluesi në fjalë nuk disponoi me informacion konkret se cilat janë masat e sigurisë fizike dhe teknike të sistemeve të vetëadministruara, kontratat dhe raportet me mirëmbajtësit e sistemeve, si garantohen të drejtat e subjekteve të të dhënave, a janë paraqitur kërkesa nga subjektet e të dhënave për fshirjen e të dhënave personale, si dhe plotësimi i detyrimeve në cilësinë e kontrolluesit[162]. Pavarësisht nga kjo, përgjigjet e munguara apo të pjesshme të subjektit ndaj kërkesave të KDIMDP, nuk kanë qenë të mjaftueshme për aplikimin e dënimit administrativ, për cënim të nenit 32 të ligjit nr.9887/2008.

Referuar deklarimeve të përfaqësuesve të subjektit, konstatimeve në vend nga inspektorët e KDIMDP-së, si dhe të dhënave të ndërfaqes online të listës së zgjedhësve që administron PS, rezulton se ky kontrollues disponon dy kategori bazash të dhënash, përkatësisht të anëtarëve të partisë dhe të dhënat e listës së zgjedhësve.

Në relacionin e KDIMDP-së nuk jepet asnjë informacion se cilat janë mjetet e kërkimit të provës që janë zbatuar për marrjen e të dhënave gjatë vizitës së inspektorëve pranë këtij subjekti. Relacioni nuk paraqet informacion nëse grupi i inspektorëve ka aksesuar fillimisht inventarin e pajisjeve që janë në pronësi dhe administrim të subjektit zgjedhor, duke ngritur pikëpyetje për mos realizimin e verifikimeve në pajisjet kompjuterike që mund të shërbejnë për përpunimin e të dhënave personale. KDIMDP evidenton në relacion se serveri në të cilin është vendosur baza e të dhënave, të cilat aksesohen nëpërmjet web ndërfaqes online, është e instaluar lokalisht, në selinë e kontrolluesit, por mungon informacioni nëse ky server i është nënshtruar inspektimit apo verifikimeve, dhe konstatimet në vend të inspektorëve lidhur me të.

Në relacion thuhet se përfaqësuesit e subjektit zgjedhor deklarojnë se kategoritë e të dhënave të zgjedhësve janë të dhënat e marra nga KQZ, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të PS, të atashuar pranë këtij institucioni[163]. Megjithatë, është e paqartë se kur janë marrë këto të dhëna për herë të fundit, a korrespondojnë nga pikëpamja e saktësisë ajo kategori të dhënash që janë pjesë e RKGJC-së me databazën

162 Shih faqen 36 të Relacionit.
163 Shih faqen 38 të Relacionit

e administruar nga subjekti zgjedhor? Saktësimi i datës/ave së marrjes së listave të zgjedhësve dhe kryqëzimi/ ballafaqimi i informacionit në mënyrë të plotë dhe jo vetëm në prizmin e kategorisë që përputhet, do t'i shërbente hetimit administrativ të gjithëanshëm, për të vërtetuar ose përjashtuar pretendimin e subjektit se të dhënat janë marrë nga RKGJC.

Dy kategori të dhënash që janë të shtuara (të ndryshme nga ato të RKGJC-së) janë numri i telefonit dhe të dhënat për preferencën politike (census), të cilat sipas subjektit zgjedhor janë shtuar nga patronazhuesi. Këto të dhëna, sipas subjektit janë mbledhur nga sistemi patronazhues, referuar udhëzimit të brendshëm datë 11 Janar 2021, që përkon nga pikëpamja kohore, 3 muaj para publikimit të lajmit për databazën. Sistemi i patronazhuesve është i përbërë nga anëtarët dhe simpatizantët e partisë, të cilëve ju është vendosur në dispozicion lista e zgjedhësve dhe detyra e tyre është të përmbyllin censusin (të evidentojnë partinë politike që ka në preferencë zgjedhësi dhe të mbajnë kontakt me zgjedhësit në patronazh, deri në përfundimin e votimit).

Nga përmbajtja e relacionit të KDIMDP-së, lindin paqartësi për funksionimin e sistemit patronazhist, ndër të tjerash në këto drejtime:

- në çformë janë marrë, transferuar, administruar dhe përpunuar kontaktet dhe preferencat e zgjedhësve,
- a kanë dhënë zgjedhësit e kontaktuar nga patronazhisti miratim për transferimin dhe përpunimin e këtyre të dhënave, si është dokumentuar pëlqimi i tyre,
- si është organizuar procedura për hedhjen, administrimin dhe përpunimin e tyre në bazën e të dhënave të subjektit zgjedhor, kush janë përgjegjësit etj.

Në vijim, në relacion shpjegohet se faqja zyrtare e subjektit ka mundësuar një mekanizëm që *apriori* mbledh të dhëna personale pa pëlqimin e shprehur të individit të të dhënave (referuar rubrikës "rekomando shokun tënd"), por ky konstatim nuk hedh dritë mbi mekanizmin patronazhues sa i takon kontaktit patronazhues - zgjedhës, siç evidentohet edhe më lart dhe nëse respektohen kërkesat e ligjit nr.9887/2008 në marrjen, transferimin dhe përpunimin e të dhënave.

Fokusi i hetimit të Komisionerit është zgjeruar tej objektit pasi janë analizuar në relacion jo vetëm të dhënat e marra me sistemin patronazhues për zgjedhësit, por edhe të dhënat për anëtarët e subjektit zgjedhor. Në relacionin e Komisionerit bëhet një krahasim midis formularit të anëtarësisë dhe databazës së zgjedhësve të qarkulluar me aplikacionin 'whatsapp', ndërkohë që objekti kryesor i hetimit duhet të ishte si janë siguruar të dhënat e zgjedhësve të marra me anë të sistemit të patronazhistëve.

Gjithashtu vërehet se Komisioneri nuk ka bërë verifikime të plota për 81 ankesat e qytetarëve të përcjella pranë tij, nëse të dhënat e tyre personale dhe sensitive figuronin në sistemin kompjuterik të PS-së, të siguruara me sistemin patronazhist. Verifikime të tilla mund të zgjeroheshin përtej kategorisë së ankuesve, duke u shtrirë mbi një kampion të caktuar të zgjedhësve që janë nën mbikqyrjen e patronazhistëve, referuar të dhënave që subjekti ka në administrim (nëse ato janë vendosur në dispozicion të Komisionerit).

KDMIDP nuk përjashton mundësinë që Baza e të Dhënave të jetë krijuar dhe përdorur nga nivele lokale organizimi politiko-zgjedhor dhe/ose organizime apo struktura të kandidatëve të veçantë (apo subjekteve të kontraktuar/nënkontraktuar prej tyre), në kundërshtim edhe me vetë rregullat e brendshme të organizimit të këtij Kontrolluesi[164]. Ky konkluzion i KDIMDP-së mbështetet në fakte jo të plota,

164 Fq.40 e relacionit.

të cilat kemi mendimin se duhet të ishin hetuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Kjo tezë nuk është bindëse në sytë e opinionit publik dhe mbart elementë subjektivizmi të njëanshëm që minimizojnë përgjegjësinë e vetë subjektit politik si një organizatë e madhe politike.

Në mungesë të një hetimi të plotë dhe gjithëpërfshirës, gjithashtu mbart në syrin e një vëzhguesi të jashtëm elementë subjektivizmi konstatimi se, "mosekzistenca e një baze të dhënash, të ngjashme me Bazën e të Dhënave, në asnjë territor tjetër të organizimit politik të PSSH në vend, përjashton këtë kontrollues nga dyshimi për autorësinë në krijimin dhe administrimin e Bazës së të Dhënave". Është e paqartë nëse ky konkluzion ka dalë nga verifikimet e kryera në çdo njësi territoriale ku subjekti ka zyrat e tij, apo bazohet vetëm në thëniet e përfaqësuesve të subjektit.

Në relacion konstatohet më tej se PS, si subjekt i madh përpunues, nuk ka krijuar sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashikohet nga Udhëzimi nr. 47 të Komisionerit[165].

v. Konkluzionet dhe vështirësitë e referuara gjatë hetimeve

Komisioneri vlerëson se faktet dhe rrethanat e hetimit administrativ nuk krijojnë kushtet për të evidentuar dhe provuar, në terma dhe hapa konkretë hetimorë, krijimin dhe përdorimin e Bazës së të Dhënave nga asnjë subjekt hetimi administrativ.

Në konkluzionet dhe rekomandimet e pasqyruara në faqen 42 të relacionit, Komisioneri evidenton kompleksitetin jashtëzakonisht të madh të çështjes objekt hetimi, përhapjen e Bazës së të Dhënave në një numër tashmë të papërcaktuar marrësish, si dhe mungesën e burimeve dhe kapaciteteve të mjaftueshme teknike dhe atyre njerëzore, për të adresuar një cënim të dhënash (data breach) të këtyre përmasave, e cila nuk e bën të mundur identifikimin e burimit të krijimit, administrimit dhe përhapjes së Bazës së të Dhënave.

Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, vlente të përmendej në relacion se cilat janë burimet (në kuptimin njerëzor dhe teknik) që ka patur në dispozicion Komisioneri për kryerjen e hetimit administrativ, a ekzistonin mundësitë objektive për të kapërcyer vështirësitë duke kontraktuar ekspertë të jashtëm dhe pajisjet e nevojshme teknike për të bërë të mundur hetimin administrativ, në mënyrë sa më të plotë, të gjithëanshme dhe objektive.

Kemi mendimin se para një emergjence të tillë të rrjedhjes dhe shkëmbimit masiv të të dhenave personale dhe sensitive, KDIMDP duhet të vlerësonte me vëmendjen e duhur të gjitha zgjidhjet e mundshme, përfshi këtu edhe kërkesën për t'ju drejtuar Kuvendit për nevojat e lidhura me buxhetin e Komisionerit që do të mundësonin aplikimin e këtyre zgjidhjeve.

Në përgjigjen zyrtare drejtuar KShH-së, KDIMDP evidenton si vështirësi, bashkërendimin jo efikas me Prokurorinë, në vijimin me hapa të shpejtë të hetimit administrativ. Sipas KDIMDP-së, provat, ku përfshihen dhe serverat apo kompjuterat pranë kontrolluesve të vendosur nën hetim administrativ nga ana e Komisionerit, janë vendosur më parë në sekuestro nga ana e Prokurorisë. Lidhur me këtë çështje, KShH vëren se këto të dhëna janë kontradiktore në raport me ato të referuara nga ana e prokurorisë, sipas të cilës, vendimi për sekuestrim rezulton të jetë dhënë jo për databazën e zgjedhësve por në kuadër të hetimit penal për databazën e pagave. Sipas prokurorisë janë sekuestruar kompjuterat me posedues shtetasit A.A dhe E.Q si dhe hark disku i sekuestruar ndaj shtetasit K.S.

165 Fq.42 e relacionit

Megjithatë, vlen të evidentohet se prokuroria e posaçme nuk ka dhënë informacion për hetimet penale të kryera prej saj dhe nëse ka patur sekuestro ndaj kompjuterave apo serverave të 4 subjekteve të hetuara administrativisht nga Komisioneri (DPGJC, DPT, AKSHI dhe PS).

Është e paqartë nëse midis organit të prokurorisë dhe KDIMDP-së ka patur korrespondencë apo ura komunikimi, në funksion të hetimit që ato kryejnë si dhe hapat e sugjeruar për kapërcimin e saj. **Në** çdo **rast, mungesa e aksesit në rrjetet dhe sistemet kompjuterike, të arkivimit apo të serverave të katër subjekteve nuk mund të justifikohet me faktin që prokuroria ka vendosur sekuestro, pasi së pari, në relacionin administrativ, duhej të evidentohej se cilët prej këtyre pajisjeve apo të dhëna kompjuterike ishin sekuestruar, nëse sekuestro ka qenë me afat, dhe a pengonte ky fakt, mungesë verifikimesh dhe aksesin që KDIMDP mund të realizonte në ato pajisje apo sisteme kompjuterike që nuk kanë qenë në sekuestro të prokurorisë.** Një mënyrë tjetër për të shmangur këtë pengesë para se të merrej vendimi përfundimtar, ishte të pezullohej procedimi administrativ deri në rënien e shkakut që krijonte pengesë për organin përgjegjës (KDIMDP)[166].

1.5 Kohëzgjatja e hetimeve

Ligji nr.9887/2008 për mbrojtjen e të dhënave personale nuk parashikon afate për procedimin administrativ që kryhet nga KDIMDP për çështjet në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në mungesë të parashikimeve, referenca ligjore për afatet bëhet në nenin 49 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit, procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe kohore prej 3-muajsh[167].

Sipas shkresës së Komisionerit kohëzgjatja e procedimit administrativ me inisiativë lidhur me përhapjen e paligjshme për kategorinë e të dhënave shtetas/zgjedhës, ka zgjatur rreth 4 muaj, duke marrë si afat fundor datat e publikimeve të rekomandimeve për kontrolluesit e hetuar[168].

Sa i përket procesit të hetimit administrativ mbi përhapjen e paligjshme të kategorisë së të dhënave për "nëpunës/punonjës" në sektorin publik dhe privat dhe pronarë automjetesh, sikurse e përmendëm më sipër, hetimi ka qenë në proces gjatë kohës që është **bërë kjo analizë. Rrjedhimisht** çdo zhvillim i mëtejshëm lidhur me ecurinë e kësaj ngjarje nuk është përfshirë në analizën e **pasqyruar në këtë dokument**.

1.6 Rekomandimet e Komisionerit ndaj subjekteve të hetuara administrativisht

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.9887/2008, Komisioneri, në rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale por përbëjnë kundërvajtje administrative, vendos dënim me gjobë që varion nga 10,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, në raport me detyrimin ligjor që është shkelur nga kontrolluesi ose përpunuesi. Kur kundravajtja në sferën e të dhënave personale kryehet nga personat juridikë, ata dënohen me dyfishin e gjobës sipas shkeljeve dhe masës së

166 Sipas nenit 23 të Kodit të Procedurave Administrative, në qoftë se vendimi përfundimtar në një procedim administrativ varet nga marrja e një vendimi paraprak, i cili është në kompetencën e një organi tjetër administrativ apo të gjykatës, organi që ka kompetencë për marrjen e vendimit përfundimtar e pezullon procedimin përkatës, deri kur organi tjetër administrativ ose gjykata e kanë marrë vendimin paraprak. Përjashtimi nga ky rregull lejohet vetem në rastet kur mosmarrja e menjëhershme e vendimit i shkakton dëm të pariparueshëm të drejtave themelorekushtetuese të palëve.

167 Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta ose kur imponohet nga situata të veçanta. Nërastin e situatave të veçanta, procedimi administrativ përfundon 3 muaj pas ndërprerjes së situatës së veçantë.

168 Lidhur me hetimet administrative në kuadër të ankesave të qytetarëve, ato të cilat kanë pasur subjekt kontrolluesite hetimeve me inisiativë i janë bashkuar atyre, ndërsa hetimit kundrejt partisë politike Bindja Demokratike ka zgjaturpothuajse një muaj.

gjobës, të parashikuar në pikën 1 të nenit 39.

Deri në dt.11 Prill 2022 që korrespondon me përgjigjen zyrtare që Komisioneri i ka drejtuar KShH-së, rezulton se është mbyllur hetimi administrativ lidhur me databazën për ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve. Në kuadër të këtij hetimi, Komisioneri ka konstatuar kundravajtje administrative me pasojë dhënien e sanksionit me gjobë në masën 1,000, 000 lekë ndaj kontrolluesit DPT për shkakun ligjor të mosbashkëpunimit. Komisioneri e ka vlerësuar qëndrimin e DPT në kundërshtim me nenet 30, 32 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative pasi përgjigjet e saj ishin jo të plota dhe të pasakta[169].

Për të gjitha subjektet e hetuara, Komisioneri e ka gjetur të pamundur të provohet se Baza e të Dhënave është populluar me të dhënat e administruara nga këta kontrollues.

Komisioneri konkludon se pavarësisht ndërmarrjes së hapave ligjorë-proceduralë për zbulimin e burimit dhe krijuesit të Bazës së të Dhënave, Zyra e Komisionerit nuk ka gjetur të provuar asnjë nga ankesat drejtuar kontrolluesve përkatës, pasi referuar në Pjesën 1 të këtij Relacioni, ka rezultuar e pamundur të vërtetohet lidhja e kontrolluesve në fjalë dhe Bazës së të Dhënave. Përjashtim bën subjekti mediatik Lapsi. al, për të cilin KDIMDP nuk ka mundur të realizojë veprime hetimore, qoftë në terren, qoftë nëpërmjet korrespondencës shkresore[170].

Rekomandimet që janë dhënë ndaj subjekteve në përfundim të procedimit administrativ për databazën e zgjedhësve vërehet se:

- kanë një natyrë të përgjithshme,
- nuk parashikojnë afate brenda të cilave duhet të përmbushen
- do të ishin të përshtatshme në kuadër të një inspektimi tematik dhe jo në një çështje të tillë ku prioritar ishte identifikimi i përgjegjësive të rrjedhjes së të dhënave personale dhe sensitive, apo përpunimit të paautorizuar prej tyre nga subjekti përkatës zgjedhor.

Rekomandimet e përcjella shtrihen në disa drejtime dhe konsistojnë në drejtim të aspekteve të lidhura me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, sa i takon politikave dhe procedurave të mjaftueshme në menaxhimin e aktiviteteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, ngritjen dhe menaxhimin e SMSI-ve, etj.

2. Hetimi Penal i Prokurorisë së Posaçme dhe asaj të juridiksionit të zakonshëm

2.1 Denoncimet

Bazuar në nenin 283 pika 1 të Kodit të Procedures Penale, çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë.

169 Vendimin nr. 41, dt 23.08.2021i KDIMDP
Sipas shkresës kthim pergjigje të Komisionerit, vendimi ndaj kontrolluesit DPT, është kundështuar pranë GjykatësAdministrative së Shkallës së Parë Tiranë nga ana e kontrolluesit. Gjykata vendosi kthimin e kërkesë padise pa veprim për arsye procedurale. Për këtë arsye, DPT e ka ankimuar atë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Çështja vijon të jetë ende në proces.

170 Shih faqen 50 të relacionit

a) Databaza e 910,000 zgjedhësve

Subjekti Zgjedhor "Partia Demokratike" ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndaj disa funksionarëve shtetëror lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 328 "Korrupsioni aktiv në zgjedhje"[171] dhe neni 122 "Përhapja e sekreteve vetjake"[172], të Kodit Penal. Kallëzimi penal është regjistruar nga kjo prokurori në datë 14.04.2021 me nr.100 pa asnjë emër (ose autor të dyshuar) të regjistruar.[173] Objekti i kallëzimit është për publikimin databazës me të dhënat personale në prag të zgjedhjeve të 25 prillit 2021, përkatësisht të 910 mijë votuesve të Tiranës, ku tregoheshin numrit i telefonit, numri i kartës së identitetit, numri i qendrës së votimit, vendi i punës dhe përshkrimi i përkatësisë politike.

b) Databaza e pagave dhe automjeteve

Lidhur me databazën e pagave dhe të automjeteve, nga informacioni zyrtar i vendosur në dispozicion të KShH-së rezulton se nuk ka patur kallëzime penale nga qytetarët apo subjekte të tjera.

2.2 Hetimi ex-officio (me nismën e vetë prokurorisë)

Bazuar në nenet 281, 282 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale, Prokurori merr dijeni për kryerjen e një vepre penale ose me iniciativën e vet, ose nga nëpunësit publikë, ose nga personeli mjekësor ose nga vetë shtetasit.

a) Databaza e zgjedhësve

Bazuar në informacionin e marë nga media, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar kryesisht procedimin penal nr.95 në datë 13.04.2021 lidhur me rrjedhjen masive të të dhënave personale dhe sensitive të shtetasve shqiptarë për databazën e zgjedhësve, sa i takon veprës penale të parashikuar në nenin 122 të Kodit Penal "Përhapja e Sekreteve Vetjake" pa asnjë emër të regjistruar (ose autor të dyshuar).

b) Databaza e pagave

Në bazë të informacionit të ofruar me shkresën kthim përgjigje drejtuar KShH-së nga Prokuroria e juridiksionit të zakonshëm, e Rrethit Gjyqësor Tiranë[174], kjo e fundit ka regjstruar kryesisht procedimin penal nr.9428 në datë 12.12.2021 për veprat penale "Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike","Ndërhyrje

171 Sipas kësaj dispozite, ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

172 Përhapja e një sekreti që i përket jetës private të një personi nga ai që e siguron atë për shkak të detyrësose të profesionit, kur detyrohet të mos e përhapë pa qenë i autorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Po kjo vepër, e kryer me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një persontjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

173 Referuar shkresës nr. 2990/1 Prot datë 15.04.2022 "Kthim përgjigje" nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

174 Shkresa me nr.prot 5471/1 Prot/ S.M datë 14.04.2022

në sistemet kompjuterike" dhe "Shpërdorim i detyrës" parashikuar nga nenet 293/b[175], 293/c[176] dhe 248[177] të Kodit Penal. Objekti i hetimit lidhet me databazën e pagave të qarkulluar në rrjetet sociale ne datë 22.12.2021, e cila reflekton pagat e muajit Janar të vitit 2021, të punonjësve te punësuar ne institucionet shtetërore dhe sektorin privat. Këto te dhëna janë shpërndarë fillimisht nëpërmjet aplikacionit "whatsapp" dhe pastaj janë publikuar dhe në media, duke u bërë lehtësisht të aksesueshme nga çdo shtetas.

2.3 Vendimmarrjet e prokurorisë për fillimin apo mosfillimit të hetimeve

Hetimi penal fillon zyrtarisht në momentin kur çështja regjistrohet në prokurorinë përkatëse. Në bazë të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, pas regjistrimit të kallëzimit penal, prokurori ka 15 ditë kohë për të vendosur nëse do të fillojë procedimin penal ose jo.

a) Databaza e zgjedhësve

Referuar informacionit të marrë nga Prokuroria e Posaçme[178], kjo prokurori pas regjistrimit kryesisht të procedimit penal nr.95 datë 13.04.2021 dhe kallëzimit të bërë nga subjekti zgjedhor "PD" nr.100 datë 14.04.2021, ka bërë bashkimin e tyre në një të vetme, më nr.51, dt. 14.04.2021. Pas bashkimit të procedimeve, kjo prokurori ka nisur hetimin lidhur me veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka filluar gjithashtu të hetojë këtë çështje e cila i , ka kaluar për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme, pas pesë muajsh hetime[179]. Më datë 26.10.2021 është regjistruar procedimin penal nr. 7681, për veprën penale "Hyrja e paautorizuar kompjuterike", parashikuar nga neni 192/b[180] i Kodi Penal, pa emër të regjistruar (ose autor të dyshuar).

b) Databaza e pagave

Me regjistrimin e procedimit penal nr.9428 në datën 22.12.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur hetimet kryesisht për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" e kryer në bashkëpunim,

175 Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.Kur kjo vepër kryhet në të dhënat kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

176 Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara për të cenuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

177 Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave tëtjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

178 Me anë të shkresës me nr.prot 1990/1 datë 15.04.2022,

179 Nga informacioni i ofruar me shkresën zyrtare me nr. 6708/1 Prot/ M.XH datë 11.05.2022 "Kthim përgjigje",

180 Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë tëtij, nëpërmjet cenimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga trederi në dhjetë vjet.

parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal, dhe te veprës penale "Korrupsioni pasiv ne sektorin privat" parashikuar nga neni 164/b[181] i K. Penal.[182]

2.4 Të pandehurit

a) Databaza e zgjedhësve

Kallëzimet penale të regjistruara për databazën e zgjedhësve pranë Prokurorisë së Posaçme, në bazë të informacionit të dhënë zyrtarisht, rezulton se nuk kanë pasur emra të regjistruar personash nën cilësinë e të pandehurve.

b) Databaza e pagave

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për hetimin e databazës së pagave, rezulton se në cilësinë e të pandehurve janë marrë 4 shtetas, dy prej të cilëve punonjës në sektorin publik (AKSHI) dhe dy të tjerë në sektorin privat (kompani) si vijon:

- E.Q, specialiste IT pranë AKSHI-t,
- A.A, specialist IT pranë AKSHI,
- K.S, punonjës menaxher pranë kompanisë "Smart Collection" dhe
- E.I, drejtor i përgjithshëm në kompaninë "Credit 2 ALL".

Këta shtetas janë akuzuar për veprat penale "Shpërdorim i detyrës" i kryer në bashkëpunim dhe "Korrupsion pasiv në sektorin privat". Me kërkesë të prokurorisë, të pandehurit janë hetuar me masë sigurimi të vendosur nga Gjykata e Tiranës.

2.5 Kohëzgjatja e hetimeve penale

Kodit i Procedurës Penale parashikon në nenin 323 të tij se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b", të nenit 75/a të këtij Kodi.

Në nenin 234 të këtij Kodi, pikat 1 dhe 2, parashikohet se prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tej afatit 2- vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm

181 Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtimme detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

182 Shkresa me nr. 5471/1 Prot/ S.M datë 14.04.2022 "Kthim përgjigje" nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë drejtuar KShH-së.

me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.

a) Databaza e zgjedhësve

Prokuroria e Posaçme ka hetuar lidhur me veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, që i referohet çështjes së databazës së patronazhistëve për një afat 5 mujor[183]. Më datë 30.09.2021 kjo prokurori ka pushuar hetimet duke shpallur moskompetencën dhe ka transferuar për kompetencë hetimin e kësaj çështje, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë[184]. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në informacionin e përcjellë deri në fund të muajit Prill të këtij viti (2022) është shprehur se hetimet ishin akoma në proces.

Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga fillimi, përveç se hetimet penale nuk kanë përfunduar, nuk ka asnjë person që të jetë marrë në cilësinë e të pandehurit lidhur me këtë ngjarje të paprecedentë në vendin tonë.

b) Databaza e pagave

Në datë 09.05.2022, me një njoftim në faqen zyrtare të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë[185] është komunikuar përfundimi i hetimit të filluar në 22.12.2021, lidhur me publikimin e pagave të punonjësve. Siç rezulton nga data e fillimit dhe përfundimit të hetimeve, kohëzagjatja e këtij hetimi penal rezulton 5 muaj.

Hetimi është kryer në një afat relativisht të arsyeshëm për sa i takon kompleksitetit të çështjes dhe është mbyllur më shpejt në raport me hetimin penal të databazës së zgjedhësve, edhe pse ky i fundit është regjistruar prej më shumë se gjysëm viti më herët në kohë.

2.6 Efikasiteti i hetimeve penale

a) Databaza e zgjedhësve

Nga informacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet shkresave kthim-përgjigje, Prokuroria e Posaçme ka zhvilluar fillimisht hetimet penale, sa i përket çështjes së databazës së zgjedhësve. Ky është i vetmi informacion i dhënë lidhur me hetimin e kësaj prokurorie.

Vlen të nënvizohet se pavarësisht se ndaj Prokurorisë së Posaçme janë kërkuar kopje të vendimmarrjeve të fillimit të procedimit penal dhe pushimit të tij për databazën e zgjedhësve si dhe për ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të çështjeve prej Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, ky informacion nuk është vendosur në dispozicion. KShH ka vendosur në lëvizje Zyrën e KDIMDP-së, por pavarësisht kërkesës së këtij të fundit drejtuar dy prokurorive, informacioni dhe dokumentacioni nuk është vendosur sërisht në dispozicion.

Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Posaçme, ka referuar për më tepër informacion në Prokurorinë Pranë Gjykatës se Shkalles se Parë Tiranë por nuk i është përgjigjur çështjeve të ngritura që janë në kompetencën lëndore të saj. Në fokus të veçantë të kërkesës për informacion ka qenë nëse Prokuroria e Posaçme ka

183 Nga data e regjistrimit të kallëzimtit penal (14.04.2021) deri në datën e shpalljes së moskopmetencës hetimet rezulton se kanë zgjatur për një periudhë kohore 5 mujore.

184 Shkresë nr. 2990/3 Prot datë 10.05.2022 "Kthim përgjigje", Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimittë Organizuar.

185 https://www.pp.gov.al/Tirane/Media/Prokuroria_prane_Gjykates_se_Shkalles_se_Pare_Tirane_perfundon_hetimet_per_procedimin_penal_nr_9428_te_vitit_2021_me_objekt_hetimi_publikimin_ne_rrjetet_sociale_ne_date_22_12_2021_nepermjet_aplikacionit_WhatsApp_te_listes_se_pagave_Janar_2021

hetuar funksionarët e nivelit të lartë të institucioneve, prej të cilave dyshohet se kanë rrjedhur këto të dhëna (AKSHI, Ministria e Ekonimisë dhe Financave), si paraqitet bashkëpunimi mes prokurorive dhe organeve të tjera ligjzbatuese dhe publike në funksion të hetimeve, nëse ka patur vështirësi në marrjen dhe grumbullimin e provave, etj.

Sikurse e ka nënvizuar edhe në Raportin vjetor të të drejtave të njeriut për vitin 2021[186], KShH vlerëson se hetimi i Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me kompetencën lëndore dhe rrethin e subjekteve, duhej të shtrihej edhe ndaj zyrtarëve të lartë publikë të institucioneve shtetërore, për shkak të përgjegjësive që kanë këto institucione për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave me të cilat janë në kontakt, dhe prej të cilave dyshohet se mund të ketë ardhur rrjedhja. Ky informacion me interes të lartë publik, edhe pse çështja penale është pushuar nga Prokuroria e Posaçme, nuk është bërë ende publik dhe shmanget dhënia e tij në dokumentin kthim-përgjigje drejtuar KShH-së.

Lidhur me ecurinë e hetimit të kësaj çështje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas shpalljes së moskompetencës ngs SPAK, vërehet se mungon gjithashtu informacioni, me arsyetimin se përbën sekret hetimor.

b) Databaza e pagave

Nga njoftimi zyrtar për përfundimin e hetimeve penale lidhur me këtë çështje, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer hetimet ndaj 2 punonjësve të AKSHI-t lidhur me akuzat për "Shpërdorim detyre", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe për 2 të pandehurit e tjerë, punonjës në sektorin privat lidhur me veprën penale "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike".

Veprimet procedurale për hetimin e databazës së pagave janë zhvilluar në mënyrë dinamike dhe afate të shpejta, pasi që në fillim të hetimit (1 ditë pas publikimit të lajmit) prokuroria ka nxjerrë tre urdhra, në datë 23.12.2021 ku ka urdhëruar mbajtësin (administratorin) ose kontrolluesin, e të dhënave kompjuterike të AKSHI-t, të DPT-së dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në sistemin kompjuterik e konkretisht të të gjitha logeve që kanë loguar në sistemin e të dhënave për pagat Janar 2021. Urdhrat janë ekzekutuar nga policia gjyqësore me proces verbalet përkatës të datës 23.12.2021.

Nga aktet hetimore, referuar procesverbalit të këqyrjes se e-mailit te punës të specialistes së IT në DPT me iniciale E.Q, janë konstatuar se të dhënat e kërkuara dhe të publikuara objekt hetimi, janë dërguar nga e-maili i saj i punës, në e-mailin e punës se shtetasit me iniciale A.A, specialist në AKSHI. Konkretisht, të dhënat janë dërguar në 6 komunikime të shtrira në harkun kohor të një viti, gjatë periudhës Tetor 2020 – Tetor 2021, si vijon:

- Në datë 21.10.2020 janë dërguar listë pagesat e muajit shtator 2020.
- Në datë 25.11.2020 janë dërguar listë pagesat e muajit tetor 2020.
- Ne datë 25.01.2021 janë dërguar listë pagesat e dhjetor 2020.
- Ne datë 24.02.2021 janë dërguar listë pagesat e janarit 2021.
- Në datë 29.04.2021 janë dërguar listë pagesat e muajit mars 2021
- Dhe në datë 22.10.2021 janë dërguar listë pagesat e muajit shtator 2021.

186 Raporti-Vjetor-per-te-Drejtat-dhe-Lirite-e-Njeriut_2021_KShH-_Final.pdf (ahc.org.al)

Këto te dhëna rezulton se janë dërguar nga adresa zyrtare e punës së specialistes së AKSHI-t në adresën elektronike të kolegut të saj, punonjës po në AKSHI, me iniciale A.A. Këto dosje elektronike të dhënash, siç rezulton nga këqyrja janë dërguar në programin We transfer.

Ne kuadër të këtij procedimi penal, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar kryerjen e ekspertimit te kompjuterëve të sekuestruar me posedues dy specialistët e AKSHI-t (E.Q dhe A.A) si dhe hard disk i sekuestruar ndaj shtetasit me iniciale K.S.

Referuar akteve të ekspertimit të urdhëruar nga organi i prokurorisë[187] rezulton se në të tre kompjuterat janë konstatuar dhe rikuperuar disa skedarë dokumentash në formatin "Excel" të titulluara '21.10.Listpagesat Total.xlsx' dhe 'Rrogat Janar 2021.xlsx'. Këto skedarë përmbanin të dhënat e kërkuara në vendimin e ekspertimit, ku në tabelat e formatit "excel" gjendeshin pagat e shtetasve të ndryshëm, si dhe në kokat e kollonave gjendeshin disa emërtime si:

- Numri personal,
- Emri, mbiemri,
- Periudha,
- Is Albanian,
- NIPT,
- Subjekti,
- Kategoria dhe tipi i biznesit.
- RetunDate,
- DRT,
- Daysworked,
- Paga bruto,
- Paga kontribute, kontributet shoqerore, kontribute punëdhënësi, kontribute punëmarrësi, kontribute suplementare, kontribute shëndetësore,
- TAP,
- Profesioni.

Në lidhje me përmbajtjen e tyre, këto skedarë megjithëse kanë ndryshime sa i përket formatimit të renditjes së emrave dhe numrit të kolonave, nga ballafaqimi dhe testimi i disa emrave rezulton përputhje e plotë e të dhënave në kolona të ndryshme.

Në referencë të këtij fakti të rezultuar nga hetimi penal, vlen të përmendet se ky ballafaqim dhe testim i disa emrave, mund të kryhej (por efektivisht nuk është realizuar) edhe gjatë inspektimit të kryer nga Komisioneri, në kuadër të hetimit administrativ për databazën e parë të zgjedhësve. Ndaj, në kuadër të këtyre hetimeve, koordinimi i përbashkët i punës, pa cënuar kompetencat e secilit institucion do të ishte i domosdoshëm.

Gjithashtu në hard disk-un objekt ekspertimi[188], që i përket shtetasit me iniciale K.S, përveç dokumentave që përmbajnë fjalët e vëna në dispozicion në vendimin e ekspertimit, u konstatua edhe një numër i

187 Me nr.259 Prot, nr.256 Prot dhe nr.255 Prot datë 22.02.2022.
188 Akti i ekspertimit nr.259.Prot datë 22.02.2022.

konsiderueshëm dokumentash të tjerë me të dhëna bankare për klientë të ndryshëm[189]. Është e paqartë se si janë siguruar këto të dhëna dhe nëse ka patur nga prokuroria referim për hetimin administrativ të subjekteve (kontrollues në sektorin bankar apo më gjerë) që janë në kontakt me këto të dhëna.

2.7 Vendimmarrjet e Prokurorisë

Deri në dt.9 Maj 2022, është mundësuar prej Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimeve të saj[190] të përcillet kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj katër të pandehurve:

1.7.1 E.Q, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimit te detyrës", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal.

1.7.2 A.A, akuzuar për kryerjen e veprës penale te "Shpërdorimit te detyrês" kryer në bashkepunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i K.Penal, "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

1.7.3 K.S, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsionit aktiv i personave qe ushtrojnë funksione publike", "Korrupsioni pasiv ne sektorin privat" parashikuar nga nenet 244 dhe 164/b të Kodit Penal.

1.7.4 E.I, akuzuar për kryerjen e veprave penale "Korrupsionit aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Korrupsion pasiv në sektorin privat" parashikuar nga nenet 244 dhe 164/b të Kodit Penal.

Referuar nenit 75/a, gërma "a"[191] dhe nenit 80, pika 1[192] të Kodit të Procedurës Penale, tërheq vëmendjen fakti se dy prej këtyre veprave penale janë në kompetencë lëndore Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Rrjedhimisht, për hetimin e tyre, kompetenca lëndore është e Prokurorisë së Posaçme[193] dhe jo e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këto dy akuza penale hetohen dhe gjykohen nga institucionet e specializuara në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pasi kanë të bëjnë me "Korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike"[194] dhe ""Korrupsionit aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike"[195]. Është e paqartë se në ç'kushte dhe rrethana e rrjedhimisht edhe bazë ligjore, janë hetuar këta shtetas nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vepra penale që janë në kompetencën lëndore të SPAK-ut dhe GJKKO-së.

189 https://shqiptarja.com//uploads/ckeditor/62840c6b88a45CamScanner%2005-16-2022%2023.14%20(1)_001.pdf
190 https://shqiptarja.com//uploads/ckeditor/62840c6b88a45CamScanner%2005-16-2022%2023.14%20(1)_001.pdf
191 Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; … …
192 Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe procedimet e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. … …
193 Neni 8 i ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" parashikon se Kompetenca lëndore parësore parësore e GJKKO-ve parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji.
194 parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal
195 parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal

KREU VI

Rekomandime

Për ta përshtatur kuadrin rregullues vendas me standardin e Rregullores, si dhe për të adresuar disa nga problematikat e konstatuara nga rrjedhjet e vazhdueshme masive të të dhënave personale, rekomandohen ndryshime në kuadrin tonë ligjor, si vijon:

1. Një përkufizim më i gjerë i të dhënave personale, si dhe parashikimi i efektit ekstraterritorial të ligjit (pra, përtej territorit të Republikës së Shqipërisë) edhe për veprimtari të cilat dëmtojnë interesat e individëve që veprojnë brenda territorit tonë.
2. Forcimi i të drejtave ekzistuese të subjekteve të të dhënave personale si dhe zgjerimi i të drejtave sipas frymës së Rregullores, në mënyrë që subjektet të kenë më shumë kontroll në administrimin e të dhënave të tyre personale. Përveç konsolidimit të të drejtave ekzistuese, paketa e të drejtave të subjekteve duhet të zgjerohet edhe përmes njohjes së "të drejtës për t'u harruar" si dhe mundësia për portabilitetin e të dhënave.
3. Zgjerim i detyrimeve të kontrolluesve/përpunuesve përmes zgjerimit të detyrimeve ekzistuese dhe parashikimet të detyrimeve shtesë. Këta të fundit duhet të jenë më të përgjegjshëm ndaj subjekteve të të dhënave personale si dhe duhet të kenë detyrimin për të provuar përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me kërkesat e ligjit.
4. Parashikimi në ligj i strukturës së specializuar me detyrë respektimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së kontrolluesit me kërkesat e ligjit. Ky funksion do të luhet nga Oficeri i të Dhënave Personale (ODP) i cili do të sjellë rritje të vëmendjes së kontrolluesit ndaj mbrojtjes së të dhënave personale. Ky detyrim i ri për kontrolluesin do të kërkojë staf të trajnuar mbi ligjin si dhe hartimin e manualeve në ndihmë të ODP-ve.
5. Të përcaktohet qartë detyrimi i kontrolluesve për të njoftuar rrjedhjet masive të të dhënave, jo vetëm tek Komisioneri, por edhe tek subjektet e të dhënave, nëse rrjedhja mund të ndikojë tek të drejtat e tyre. Ky njoftim duhet të realizohet menjëherë sapo kontrolluesi vjen në dijeni të rrjedhjes së këtyre të dhënave.
6. Forcimi i pozitës së Komisionerit, duke konsoliduar pavarësinë e tij si dhe duke njohur ligjërisht si detyra të Komisionerit rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe kuptimin mbi rreziqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat lidhur me përpunimin, me fokus të veçantë veprimtaritë drejtuar fëmijëve, të rrisë ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe përpunuesve mbi detyrimet që lindin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, të mbikëqyrë zhvillime të cilat mund të kenë ndikim në mbrojtjen e të dhënave personale, të inkurajojë hartimin e kodeve të sjelljes, etj.
7. Përshtatja e nevojave të Komisionerit sipas ndryshimeve në kuadrin e kompetencave të tij, duke i siguruar rritje të kapaciteteve njerëzore, teknike dhe financiare.
8. Ndryshimi i regjimit të gjobave duke rritur nivelin e tyre e për ta bërë me efektiv, sigurisht ndoshta duke e përshtatur edhe me zhvillimin ekonomik të vendit.
9. Saktësimi i mjeteve juridike në dispozicion të subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të drejtave të tyre (ankimi tek Komisioneri si dhe ankimi drejtpërdrejtë në gjykatë).
10. Për një mbrojtje sa më të plotë të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe për të lehtësuar aksesin e tyre në drejtësi, veçanërisht në rastet e rrjedhjeve masive të të dhënave, rekomandohet që ligji të njohë mundësinë për paraqitjen e padive përfaqësuese (representative actions) edhe pa një prokurë të dhënë nga subjektet e cënuara. Në këtë drejtim, do të ndihmojë miratimi i projektligjit "Për paditë kolektive".
11. Në zbatimin praktik të dispozitave, duhet që Komisioneri të ushtrojë kontroll më efektiv të rekomandimeve të tij drejtuar kontrolluesve duke vendosur sanksione domethënëse në rast mosrespektimi me faj të udhëzimeve të lëna nga Komisioneri.

12. Hartimi i një udhëzimi për mbrojtjen e të dhënave gjatë fushatës elektorale (sipas Udhëzuesit të Komisionit) [196] duke përcaktuar detyrat e qarta që kanë secili prej aktorëve, duke nisur që nga partitë politike, kandidatët apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që mund të jenë në rolin e kontrolluesit si dhe palë të treta që mund të kontraktohen prej tyre që mund të jenë bashkëkontrollues ose përpunues.
13. Harmonizimi i mbrojtjes së të dhënave personale me lirinë e shprehjes, duke përcaktuar qartë se në cilat raste mbizotëron njëra ose tjetra. Ky balancim duhet bërë me ligj dhe duke respektuar thelbin e këtyre të drejtave themelore, të jetë proporcionale dhe e nevojshme.
14. Përditësimi edhe të pjesëve të tjera ligjore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale si "Ligji për Komunikimet elektronike" i cili nuk është i përditësuar plotësisht me direktivën që është në fuqi si dhe të kërkohet zbatim i plotë i këtyre dispozitave.

196 Mbi Zbatimin e legjislacionit të Bashkimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kontekstin Elektoral

BIBLIOGRAFIA

Legjislacion

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji Nr. 8417, date 21.10.1998, i ndryshuar.
- Kodi Penal i RSH
- Kodi i Procedurës Penale i RSH
- Kodi i Procedurave Administrative
- Ligj nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
- Ligj nr.9288, date 7.10.2004, Për Ratifikimin e Konventës "Për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale", i ndryshuar.
- Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike", i ndryshuar Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore
- VKM nr. 1147, datë 9.12.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'Portali Unik Qeveritar E-Albania' dhe për miratimin e rregullave 'Për mënyrën e funksionimit të Pikës së vetme të Kontaktit'

Akte Ndërkombëtare dhe Legjislacioni i BE-së

- Karta Europiane e të Drejtave Themelore, 2012/C 326/02, botuar në OJ C 326, 26.10.2012.
- Konventa për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, Këshilli i Evropës, STCE nr. 108, 1981. https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty- detail&treatynum=108
- Protokolli Ndryshues i Konventës për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, Miratuar nga Komiteti i Ministrave, 18 Maj 2018.
- Rregullorja (EU) 2016/679 (General Data Protection Regulation) botuar në OJ L 119, 04.05.2016.
- Rregullorja (EU) 2018/1725 e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2018 mbi Mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Institucionet e Bashkimit, organet, zyrat, agjencitë dhe livizjen e lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Rregulloren (EC) Nr 45/2001 dhe Vendimin nr. 1247/2002/EC
- Rregullorja (EC) 45/2001 Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 18 Dhjetorit 2001 mbi Mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Institucionet dhe organet e Komunitetit, dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave,
- Direktiva (EU) 2016/680 e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 mbi mbrojtjen e individëve nga përpunimi i të dhënave persoanve nga autoritetet kompetente për qëllim të parandalimit, hetimit, zbulimit, ose ndjekjes së veprave penale ose për ekzekutimin e dënimeve penale dhe mbi qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.
- Direktiva 2002/58/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 korrik 2002 lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva për privatësinë dhe komunikimet elektronike), e ndryshuar.
- Udhëzimi i Komisionit për Zbatimin e Ligjit të Bashkimit për Mbrojtjen e të Dhënave në Kontekstin Zgjedhor.

Raporte të BE-së, organizatave ndërkombëtare ose të njohura ndërkombëtarisht

- file:///C:/Users/user/Downloads/Albania-Report-2021%20(6).pdf
- ALBANIA 2021 HUMAN RIGHTS REPORT (DASH)
- https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf
- Amnesty International Report on Human Rights
- https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022
- Komunikimi i Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin, Mbrojtja e të dhënave si shtyllë e fuqizimit të qytetarëve dhe Qasja e BE-së ndaj tranzicionit digjital - dy vjet aplikim të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, SËD(2020)115 përfundimtar.
- Qëndrimi dhe gjetjet e Këshillit për aplikimin për zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, Bruksel, 15 janar 2020, 14994/2/19
- Raporti Vjetor 2021, Komisoineri i së Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale,
- Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, SWD(2020) 354 final, Raporti i Shqipërisë 2020, 6.10.2020.
- Raporti i Dokumentit të Punës të Stafit të Komisionit, Shqipëri 2021, SËD(2021) 289 përfundimtar 2021.
- Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Opinion 6/2015, Një hap i mëtejshëm drejt mbrojtjes gjithëpërfshirëse të të dhënave të BE-së, 28 Tetor 2015

Doktrinë

- S. Rodota, "Data Protection as fundamental Right", in S. Gutëirth et al, (Eds) Reinventing Data Protection?, Springer 2009.
- Th. Streinz, The Evolution of European Data Law, published in P. Craig dhe G. de Burca (eds), The Evolution of EU Laë, Oxford university Press, 2021, f. 902-936
- Ch. Kuner, et al, The Eu General Data Protection Regulation: A Commentary, Oxford University Press, 2021
- T. Mulder, Health Apps, their Privacy Policies and the GDPR, European Journal of Laë and Technology, Vol 10, no.1, 2019.
- Ch. J., Hoofnagle et al, The European Union General Data Protection Regulation: what it is and what it means, Information and Communications Technology Law, 2019, Vol 28, No.1, 65-98.
- E. Kosta, Peeking Into the Cookie Jar: the European Approach Toëards the Regulation of Cookies, International Journal of Laë and Information Technology (2013) 21(4)
- Douwe Korff and Marie Georges, The DPO Handbook Guidance for data protection officers in the public and quasi-public sectors on how to ensure compliance with the European Union General Data Protection Regulation, korrik 2019

Jurisprudencë

- Google Spain SL and Google Inc. v Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) and Mario Costeja González, Case C-131/12 ECLI:EU:C:2014:317.
- Maximillian Schrems v Data Protection Commissioner C-362/14, ECLI: EU:C:2015:650.
- Comission v Hungary C-288/12 ECLI:EU:C:2014:237, 8 Prill 2014
- Meta Platforms Ireland Limited, formerly Facebook Ireland Limited,v Bundesverband der Verbraucherzentralen und Verbraucherverbände – Verbraucherzentrale Bundesverband e.V. C-319/20, ECLI:EU:C:2022:322.

- C-73/07, Tietosuojavaltuutettu kundër Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy, 16 dhjetor 2008, parag. 56, 61 dhe 62
- GjEDNj-Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy V. Finland, Nr. Aplikimi nr. 931/13

Burime nga Media

Ekskluzive/ Si na monitoron Rilindja nr e telefonit, nr ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues të Tiranës – Lapsi.al

https://lapsi.al/2021/12/22/superskandali-dalin-sheshit-emer-per-emer-rrogat-e-mbi-600-mije-shqiptareve/

https://news-31.com/news/thellohet-sandali-publikohet-databaza-me-targat-e-makinave-i22293

https://lapsi.al/2021/04/11/alibia-e-taulant-balles-per-pergjimin-qe-ps-u-ben-te-dhenave-personale-te- qytetareve/

https://lapsi.al/2021/04/13/rama-pranon-patronazhistet-kemi-vite-qe-i-kemi-shperndare-ne-terren/

COURT-7003525-v2-20204_21_LE2_2a_R39_Granted_Only.pdf (reporter.al)

https://a2news.com/2022/01/07/skandali-i-publikimit-te-pagave-4-te-arrestuar-prokuroria-zbardh-skemen-do-ti-shkohet-deri-ne-fund-cdolloj-subjekti-te-perfshire/

https://shqiptarja.com//uploads/ckeditor/62840c6b88a45CamScanner%2005-16-2022%2023.14%20(1)_001.pdf